



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

RAPORTI VJETOR
2017

PËRMBAJTJA

FJALA PËRSHËNDETËSE E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV.....	5
HYRJE.....	7
ARRITJET KRYESORE TË AUTORITETIT	9
KRONOLOGJIA E NGJARJEVE ME TË RËNDËSISHME NË VITIN 2017	16
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE	20
BORDI I AUTORITETIT	20
PËRMBLEDHJE E ECURISË SË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJE.....	23
Kapitulli 1. MBROJTJA E KONSUMATORIT	25
1.1 Mbrojtja e Konsumatorit dhe Investitorit.....	25
1.2 Edukimi Financiar	27
1.3 Strategjia e Edukimit.....	27
I. MBIKËQYRJA E INTEGRUAR E TREGJEVE FINANCIARE JOBANKARE.....	30
Kapitulli 2. Mbikëqyrja e Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve të Investimeve	30
2.1 Tregu i Fondeve të Investimeve	30
2.1.1 Struktura e Tregut.....	30
2.1.2 Pozicioni Financiar dhe Mbikëqyrja e Tregut.....	30
2.1.3. Inspektime të Përbashkëta për Mbikëqyrje të Konsoliduar të Tregjeve Financiare.....	36
2.2 Tregu i Kapitaleve.....	36
2.3 Aktiviteti i Licencimit.....	40
2.4 Qeverisja	41
2.5 Inspektime Pranë Shoqërive që Kryejnë Veprimtarinë e Agjentit të Lidhur.....	43
2.6 Zbatueshmëria dhe Kuadri Ligjor e Rregullativ	43
2.6.1 Kuadri Ligjor e Rregullativ	43
2.1.1 Masat Korrigjuese dhe Administrative	44

Kapitulli 3. Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve.....	46
3.1 Struktura e Tregut të Sigurimeve	46
3.2 Pozicioni Financiar	51
3.3 Inspektimi në shoqëritë e sigurimeve sipas mbikëqyrjes me fokus rrezikun	60
3.4 Provigjonet Teknike	62
3.5 Mbikëqyrja e Grupeve	69
3.6 Qeverisja e Shoqërive të Sigurimit.....	70
3.7 Aktiviteti Licencues	71
3.8 Ndërmjetësit në Sigurime	73
3.9 Byroja Shqiptare e Sigurimeve (BSHS)	75
3.10 Fondi i Kompensimit	77
3.11. Masat e Marra për Stabilizimin e Tregut të Sigurimit të Detyrueshëm.....	79
3.12 Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik.....	83
3.13 Zbatueshmëria dhe Kuadri Ligjor e Rregullativ	84
3.13.1 Kuadri Ligjor e Rregullativ	84
3.13.2 Masat korrigjuese dhe administrative	87
Kapitulli 4. Mbikëqyrja e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare	90
4.1 Struktura e Tregut.....	90
4.2 Pozicioni Financiar	93
Disa tregues nga vendet e rajonit	98
4.3 Mbikëqyrja dhe Analiza e Rreziqeve të Tregut	99
4.4. Kuadri Ligjor dhe Rregullativ	100
Kapitulli 5. Bashkëpunimi institucional dhe projektet	102
5.1. Bashkëpunimi me institucionet e vendit	102
5.2 Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar	103
5.3 Proceset integruese për tregjet nën mbikëqyrje	108
5.4 Procesi i Vlerësimit në kuadrin e <i>MONEYVAL</i>	111

5.5	Projekte	112
II.	ORGANIZIMI INSTITUCIONAL I AMF-së	115
II.1	Kuadri ligjor dhe rregullator i AMF-së.....	115
II.2	Politika e Burimeve Njerëzore.....	116
II.3	Sistemet e Teknologjisë së informacionit	120
II.4	Auditi i Brendshëm.....	121
II.5	Transparenca dhe marrëdhëniet me publikun	121
III.	SFIDAT E AUTORITETIT	125
	Prioritete, Strategji të Autoritetit	125
IV.	Struktura Organizative e AMF-së	130

FJALA PËRSHËNDETËSE E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

I nderuar Lexues,

Është kënaqësi për mua të prezantoj përpara jush, në emër të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, punën dhe rezultatet e Autoritetit gjatë vitit 2017.

Viti 2017 ka qenë një vit arritjesh të mëdha për ekonominë dhe për sistemin shqiptar financiar jobankar. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dha kontributin e tij në përmirësimin e zhvillimit ekonomik e financiar. Ky kontribut u materializua nëpërmjet:

- Zhvillimit të mëtejshëm të tregut të investimeve i cili mbetet tregu më i madh për t'u mbikëqyrur nga pikëpamja e aktiveve. Pësia e këtij tregu për vitin 2017 në tregjet financiare të mbikëqyrura nga AMF, arriti në rreth 69.2 %;
- Zgjerimit të tregut të sigurimeve me 5.37%, më shumë se një vit më parë. Megjithatë tregu i sigurimeve vijoi të jetë i orientuar drejt sigurimit të detyrueshëm, ku raporti ndërmjet sigurimeve të detyrueshme dhe atyre vullnetare rezultoi përkatësisht 61.5% dhe 38.5%;
- Rritjes dhe nxitjes së mëtejshme të numrit të anëtarëve në tregun e fondeve të pensioneve private vullnetare, i cili në fund të vitit 2017 rezultoi me 20,947 anëtarë, duke shënuar një rritje prej 21% krahasuar me fundin e vitit 2016;
- Forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve të institucionit në rolin mbikëqyrës; përmirësimit të mëtejshëm të kapaciteteve inspektuese dhe audituese me fokus rrezikun dhe hartimit të një plani të qartë për kryerjen e këtyre inspektimeve në të gjitha shoqëritë e sigurimeve;
- Mbrojtjes të konsumatorit dhe investitorit, si një ndër objektivat primare të veprimtarisë rregullatore dhe mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, nëpërmjet: shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave të konsumatorëve dhe investitorëve; (ii) monitorimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi lidhur me detyrimin për informim të publikut si dhe afatet e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim; (iii) rritjes së edukimit financiar për publikun; si dhe (iv) ofrimit të asistencës konsumatorit duke i dhënë informacion dhe sqarime sipas kërkesave.

Veprimtaria e Autoritetit gjatë vitit 2017 u fokusua gjithashtu në hartimin e një strategjie 5-vjeçare (2018-2022) me synim zhvillimin e AMF-së dhe Tregjeve nën Mbikëqyrje, duke paraqitur një vizion të qëndrueshëm të tregjeve financiare jobankare nëpërmjet forcimit të kuadrit ligjor dhe rregullator.

Gjatë vitit 2017, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të arritur qëllimet e tij ka ndjekur modelet e partnerëve ndërkombëtarë. Për këtë arsye, bashkëpunimi me institucionet e tjera ka

patur një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe ruajtjen e stabilitetit të qëndrueshëm financiar në vend.

Bashkëpunimi i rregullatorëve të ndryshëm ekonomikë dhe financiarë është konsideruar mjaft i rëndësishëm për ecurinë e tregjeve financiare. Në funksion të këtij bashkëpunimi edhe gjatë vitit 2017 janë thelluar marrëdhëniet me institucionet më të rëndësishme financiare në vend apo institucione e grupe të tjera interesi, veprimtaria e të cilëve lidhet direkt ose indirekt me aktivitetin mbikëqyrës apo rregullator.

Për të garantuar një mbikëqyrje efektive dhe të kujdesshme Autoriteti ka punuar me vendosmëri për të përmbushur përgjegjësitë e tij përsa i përket përmirësimit të kuadrit ligjor me një cilësi më të lartë dhe forcimit të mbikëqyrjes së tregut në përgjithësi me një orientim drejt mbikëqyrjes me bazë rreziku, në tre sektorët nën mbikëqyrje të AMF-së.

Duke u mbështetur në arritjet e vitit 2017, Autoriteti do të vazhdojë të konsolidojë pozicionin e tij si një autoritet mbikëqyrës me efikasitet të plotë duke i dhënë përparësi përmbushjes së rolit të tij mbikëqyrës nëpërmjet konvergencës së praktikave më të mira mbikëqyrëse dhe rregullatorë ndërkombëtare.

Ky raport ofron një pasqyrë të detajuar të tregjeve financiare, dhe do t'ju njohë më hollësisht me punën e Autoritetit gjatë vitit 2017 dhe kontributin e tij në stabilitetin financiar të vendit. Besoj që ky raport të jetë i dobishëm, me interes dhe të përcjellë informacionin e kërkuar nga lexuesi.

Me respekt,

Ervin Koçi

Drejtore i Përgjithshëm Ekzekutiv

HYRJE

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) u krijua në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si institucion juridik publik, i pavarur në ushtrimin e kompetencave të tij, që raporton në Kuvendin e Shqipërisë.

Ai licencon, rregullon dhe mbikëqyr aktivitetin e tregut të sigurimeve dhe operatorëve të tij, aktivitetin e tregut të letrave me vlerë dhe operatorëve të tij, aktivitetin e tregut të fondeve të pensioneve vullnetare dhe operatorëve të tij, si dhe veprimtari të tjera financiare jobankare.

Misioni i Autoritetit është të kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e sigurt të tregjeve financiare nën mbikëqyrje. Përmbushjen e misionit të tij, Autoriteti e ushtron me anë të funksionit rregullativ dhe mbikëqyrës. Objektivi prioritar i Autoritetit, i cili udhëheq këto dy funksione është **Mbrojtja e Interesave të Konsumatorit dhe Investitorit, si dhe Edukimi Financiar i tyre**. Në ushtrimin e funksionit rregullativ dhe mbikëqyrës, AMF udhëhiqet nga parimet dhe normat e pavarësisë, transparencës dhe integritetit. Rritja e pavarësisë institucionale dhe pavarësisë financiare, të parashikuara në Ligjin nr. 54, datë 29.05.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” synojnë forcimin e rolit mbikëqyrës dhe rregullator të AMF-së.

Objektivat kryesore të AMF-së janë nxitja dhe ruajtja e stabilitetit të sistemit financiar dhe mbikëqyrja e legjitimitetit të veprimtarive të subjekteve të mbikëqyrura. Për arritjen e objektivave të saj, AMF udhëhiqet nga parimet e transparencës, duke krijuar besim tek pjesëmarrësit e tregut financiar dhe duke mbrojtur dhe informuar konsumatorin.

Gjatë ushtrimit të kompetencave të saj, AMF ka objektiv të:

- Miratojë zbatimin e rregulloreve në përputhje me Ligjin;
- Lëshojë dhe revokojë licencat, autorizojë dhe miratojë, sipas autorizimit bazuar në rregullore;
- Inkurajojë, organizojë dhe monitorojë masat që synojnë funksionimin efektiv të tregjeve financiare;
- Inicijojë miratimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative dhe të informojë publikun mbi parimet bazë të funksionimit të tregjeve financiare jobankare;
- Miratojë rregullore që përshkruajnë kushtet, mënyrën dhe vazhdimësinë e procedurave për një proces të njëtrajtshëm mbikëqyrës brenda fushës së saj të kompetencës dhe të marrë masa të tjera dhe të kryejë detyra të tjera në përputhje me kompetencat e saj statutores;
- Informojë organe të tjera mbikëqyrëse, administrative dhe gjyqësore për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në fushën e tyre të kompetencës, në lidhje me veprimtaritë që lidhen me fushën e kompetencës së AMF-së.

Misioni ynë është arritja e krijimit të një tregu bashkëkohor dhe eficient që do të ofrojë shërbime cilësore dhe do të promovojë zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar jobankar në vend.

Përgjegjësia: AMF do të reagojë me nje plan konkret veprimi dhe me përkushtim gjithëpërfshirës drejt arritjes së misionit dhe synimeve strategjike si një autoritet mbikëqyrës për tregjet financiare jobankare.

Kompetenca: AMF do të ushtroje autoritetin e saj që të sigurojë realizimin sa më efikas të strategjisë dhe misionit në përputhje me standardet më të larta profesionale dhe me kosto racionale.

Llogaridhënia: Për realizimin e veprimtarive të saj AMF duhet të zbatojë standardet më të larta etike në komunikimin dhe bashkëpunimin me grupet e interesit në procesin e mbikëqyrjes për tregjet financiare jobankare.

Transparenca: AMF rregullisht do të publikojë informacione në lidhje me tregun si dhe shërbimet për tregjet financiare jobankare të ofruara në Republikën e Shqipërisë.

ARRITJET KRYESORE TË AUTORITETIT

- 1. Forcimi i kapaciteteve të institucionit në rolin mbikëqyrës, përmirësimi i mëtejshëm i kapaciteteve inspektuese dhe audituese, për kryerjen e inspektimeve me fokus rrezikun dhe hartimi i një plani të qartë për kryerjen e këtyre inspektimeve në të gjitha shoqëritë e sigurimeve.**

AMF gjatë vitit 2017, në funksion të forcimit të integritetit të institucionit, por edhe në drejtim të forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse ndërmori një sërë hapash si në drejtim të miratimit të një sërë rregulloresh të reja, por dhe të amendimit të atyre ekzistuese.

Kështu u miratuan dhe u rishikuan rregulloret si më poshtë:

1. “Mbi likuidimin e detyrueshëm të degës së shoqërisë së sigurimit, të një vendi të huaj dhe një vendi anëtar të BE-së”, miratuar me VB nr. 54, datë 26.05.2017;
2. “Mbi mbikëqyrjen e grupeve të sigurimit”, miratuar me VB nr. 55, datë 26.05.2017;
3. “Për transferimin e portofolit të sigurimit në lidhje me vendet anëtare”, miratuar me VB nr.56, datë 26.05.2017;
4. “Mbi llogaritjen e mbajtjes neto të mbulimit maksimal agregat të rreziqeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit”, miratuar me VB nr. 57, datë 26.05.2017;
5. “Mbi administrimin dhe rastet e ndërhyrjes në fondin e garancisë së shoqërisë së sigurimit”, miratuar me VB nr. 86, datë 3.07.2017.

Njëkohësisht gjatë kësaj periudhe u kryen inspektime me bazë rreziku në shoqëritë e sigurimeve të Jo-Jetës si Sigal, Atlantik, Insig dhe kalendari i këtyre inspektimeve do të vazhdojë dhe gjatë vitit 2018. Përmbyllja e këtij procesi ndihmon mbikëqyrjen në vlerësimin dhe analizimin e rreziqeve sipas shoqërive të sigurimit, në veprimet mbikëqyrëse që duhet të ndërmerren për nivele të caktuara rreziku, caktimin e prioriteteve gjatë procesit të mbikëqyrjes, duke rritur masën e ndërhyrjes mbikëqyrëse sipas nivelit të rrezikut.

Në lidhje me fuqizimin e kapaciteteve njerëzore, gjatë vitit u rishikua struktura e AMF-së dhe u miratua me VB nr. 69 datë 19.06.2017 në zbatim dhe të rekomandimeve të konsulentëve të projektit (SECO) “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, me qëllim krijimin e strukturave të dedikuara sipas tregjeve nën mbikëqyrje dhe në përgjigje të zhvillimeve të këtyre tregjeve. Gjatë kësaj periudhe është proceduar me rekrutimin e burimeve njerëzore. Është synuar që të zgjidhen profesioniste nga tregu financiar, të cilët përfaqësojnë integritet profesional dhe që kanë dëshirë të thellojnë më tej njohuritë e tyre dhe të përfaqësojnë Autoritetin në rolin e tij mbikëqyrës dhe rregullator.

2. Evidentimi i problematikave në lidhje me Byronë Shqiptare të Sigurimit dhe në veçanti për Fondin e Kompensimit dhe shqyrtimi e përdorimi nga Autoriteti i hapësirave ligjore për zgjidhjen e tyre në funksion të respektimit të të drejtave dhe trajtimit të barabartë të investitorëve.

Në këtë periudhë u intensifikuan në mënyrë të ndjeshme komunikimet verbale dhe shkresore me Byronë Shqiptare të Sigurimit, me qëllim evidentimin e problematikave të akumuluar në kohë dhe gjetjen e rrugëve dhe mundësive për zgjidhjen e tyre. Më poshtë, po rendisim disa ndërhyrje të AMF-së të bëra në këtë periudhë:

- a. Rishikimi i rregullores së BSHS-së “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit”. Këto ndryshime u realizuan dhe u miratuan me Vendimin nr. 153 datë 30/11/2017, ku u unifikua numri serial që personalizohet në policat e sigurimit të detyrueshëm motorik të cilat emëtohen nga Byroja Shqiptare e Sigurimit. Gjithashtu, në këtë rregullore u parashikua procesi i inventarizimit dhe i rakordimit midis shoqërive të sigurimit dhe BSHS-së, të policave të sigurimit të detyrueshëm si dhe procesi i asgjësimit të policave të pakonsumuara.
- b. Autoriteti ka punuar për ndryshime në Ligjin për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit ku synohet që krahas përmirësimeve në tërësi të këtij ligji të sigurohet dhe mirëfunksionimi i Byrosë së Sigurimit dhe administrimi i Fondit të Kompensimit. Ky draft është diskutuar me grupet e interesit dhe është në proces referimi në institucionet përkatëse.
- c. Në lidhje me Fondin e Kompensimit, puna e Autoritetit është përqendruar tek evidentimi dhe dhënia zgjidhje e problemeve të akumuluar ndër vite në Byronë Shqiptare të Sigurimit. Për këtë qëllim Autoriteti ngriti një grup pune, i cili realizoi një inspektim pranë BSHS-së, për verifikimin e dosjeve të Fondit të Kompensimit duke filluar nga viti 2002 e në vazhdim. Ky proces filloi më datë 1 korrik 2017 dhe ka zgjatur 2 muaj. Qëllimi i këtij inspektimi ishte përcaktimi i saktë i detyrimeve dhe pagesave të bëra ndër vite, duke përcaktuar saktë detyrimin në total, pagesat për çdo shoqëri sigurimi si dhe detyrimin që ka çdo shoqëri për çdo vit ushtrimor ende të pashlyer. Me përfundimin e këtij procesi, Autoriteti arriti të krijojë një pasqyrë më të qartë të dosjeve të pashlyera dhe atyre në proces përgjatë periudhës dhe miratoi në Bord, me Vendimin nr. 145 datë 20.10.2017 një shtesë në Fondin e Kompensimit të vitit 2017 në vlerën 250 milionë lekë. Vendimi i është përcjellë Byrosë Shqiptare të Sigurimit dhe Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të BSHS-së për të vepruar dhe respektuar rradhën e pagesave të dëmeve për ngjarjet deri në 31.12.2013 dhe po monitorohet në vazhdimësi nga AMF-ja.
- d. Bordi i Autoritetit në mbledhjen e muajit dhjetor 2017, me Vendimin nr. 217, datë 28.12.2017, “Mbi Fondin e Kompensimit të vitit 2018”, ka marrë në shqyrtim dhe ka

vlerësuar situatën e Fondit të Kompensimit lidhur me detyrimet e mbartura të akumuluarra ndër vite si dhe detyrimet që do të lindin gjatë vitit 2018. Në këtë vendim është urdhëruar BSHS-ja për ndjekjen e procedurës së shlyerjes të praktikave të cilat kanë përfunduar procesin e trajtimit dhe për t'i dhënë zgjidhje përfundimtare këtij problemi.

- e. Vendim tjetër i rëndësishëm që lidhet me detyrimet e Fondit të Kompensimit ndër vite, duke bërë analiza për faktorët e rritjes së vlerës së dëmeve të ndodhura objekt i këtij fondi është dhe vendimi i marrë në muajin dhjetor, për auditimin e veprimtarisë së BSHS-së, nga shoqëri audituese ndërkombëtare.
 - f. Është ndjekur dhe monitoruar në vazhdimësi procesi i zbatimit të vendimeve të Bordit për kryerjen e pagesave të Fondit të Kompensimit duke patur në prioritet praktikën me ngjarje më të hershme me synim përfundimin e pagesave të praktikave të vitit 2010 deri në fund të vitit 2017.
 - g. Autoriteti ka zhvilluar në vazhdimësi takime periodike me shoqëritë dhe me përfaqësues të Byrosë për të nxitur zbatimin e vendimeve që lidhen me pagesat e dëmeve nga Fondi i Kompensimit.
 - h. Është ndjekur në vazhdimësi dhe kryerja e pagesave të dëmeve të Fondit të Kompensimit, për ngjarjet pas datës 1 janar 2014 e në vazhdim, me qëllim që mos të përsëritet fenomeni i akumulimit të tyre. Për këtë arsye, janë zhvilluar inspektime në të gjitha shoqëritë e sigurimeve për praktikën objekt i Fondit të Kompensimit për ngjarjet e sigurimit 2014 e në vazhdim, janë verifikuar praktikën e papaguara për këto ngjarje siguri dhe është informuar Bordi në lidhje me gjetjet.
 - i. Janë rakorduar të dhënat në regjistrin elektronik të dëmeve në lidhje me dëmet objekt i Fondit të Kompensimit dhe të gjitha shoqëritë po plotësojnë versionin e përmirësuar të Regjistrit Elektronik të Dëmeve. Po vijohet me plotësimin e dosjeve të dëmeve, të Fondit të Kompensimit për ngjarjet pas 1 janarit 2014, e në vazhdim, të trajtuara nga ana e tyre.
- 3. Verifikimi (veçanërisht për brokerat) i algoritmit të serverit dhe sistemit të IT-së në lidhje me shitjet në të gjithë tregun, për TPL, Karton Jeshil dhe Polica Kufitare, për të siguruar konkurrencë të lirë dhe pa pengesa për shkak të këtij algoritmi.**

Janë kryer verifikimet e të gjitha IP-ve në sistem dhe janë mbyllur të gjitha IP-të që rezultojnë aktive dhe nuk bazoheshin në rregulloret e miratuara nga AMF. Është hequr IP-ja e brokerit nga regjistri elektronik online i sigurimit të detyrueshëm motorik, i cili tregton TPL, Karton Jeshil dhe Polica Kufitare që nga muaji nëntor 2017.

4. Marrëveshja e Shërbimit të Nivelit SLA midis Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare(AMF).

Janë kryer të gjitha veprimet për arritjen e një marrëveshjeje me AKSHI-n për instalimin e *Disaster Recovery Site* në DC-në Qeveritar. Procesi i instalimit, falë punës së vazhdueshme të stafit gjatë vitit 2017 u bë i mundur në fillim të vitit 2018. Duke shënuar kështu një arritje të rëndësishme të institucionit, pasi gjatë gjithë ekzistencës së saj, AMF nuk ka pasur *Disaster Recovery Site*.

5. Përmirësimi i kuadrit ligjor për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike dhe zbatimi i masave stabilizuese në tregun e sigurimeve dhe vendosja e standardeve të mirëpërcaktuara në lidhje me rezervat minimale, nivelin e likuiditetit, mjaftueshmërinë e kapitalit, praktikën e provigjonimit dhe sidomos përmirësimin e raportit dëme/prime.

Në fillim të muajit shtator 2017 u ngrit grupi i punës për rishikimin e Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit". Gjatë kësaj periudhe është punuar intensivisht për hartimin e draftit, i cili tashmë është gati për diskutim me institucionet e tjera përgjegjëse. Në këtë draft janë marrë parasysh të gjitha rekomandimet me qëllim stabilizimin e tregut dhe janë riparë të gjithë treguesit e tij, duke i bërë ato të krahasueshëm me nivelet e tregut të rajonit. Parashikohet që ky ligj të shkojë në Parlament dhe të kalojë për miratim.

6. Fuqizimi i rolit të AMF-së me fokus mbrojtjen e konsumatorit.

Në vitin 2017, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare fuqizoi rolin e tij në drejtim të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe investitorëve. U fuqizua roli informues i AMF-së duke komunikuar në faqen e web-it dhe në platforma të tjera komunikimi. Autoriteti, nëpërmjet shqyrtimit të ankesave, ka marrë informacion të vlefshëm për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë nga subjektet e mbikëqyrura kundrejt konsumatorit. Duke vlerësuar eksperiencat e ankimuesve, AMF ka evidentuar sjellje jokorrekte të subjekteve dhe ka ndërhyrë në kohë për të zgjidhur çështje konkrete si dhe ka marrë masat e duhura në kohë për të shmangur përsëritjen e problematikave të njëjta në të ardhmen edhe për ata konsumatorë të cilët kanë zgjedhur të mos depozitojnë ankesë në Autoritet.

Gjatë vitit 2017 përveç shqyrtimit të ankesave me qëllim zgjidhjen e tyre, Autoriteti në funksion të mbrojtjes konsumatore ka marrë edhe masa që kanë synuar rregullimin dhe disiplinimin e çështjeve të caktuara. Bazuar në vendimin e Bordit Nr. 146, datë 20.10.2017, që prej datës 1 nëntor 2017 shitja e Policave të sigurimit Kufitar bëhet nëpërmjet raportimit të tyre në kohë reale përmes regjistrit elektronik të sigurimeve të detyrueshme motorike. Kjo masë rregullative siguron standardizimin e tregut të sigurimit për shitjen e të gjitha policave të

sigurimit të detyrueshëm, si dhe eliminimin e rasteve të mosraportimit apo raportimit të pasaktë të të dhënave të policave të sigurimit të detyrueshëm.

Me vendimin Nr. 173, datë 30.11.2017 Bordi i AMF-së miratoi ndryshimin e Rregullores nr. 128, datë 06.10.2011 “Mbi procedurat dhe kërkesat shtesë për licencimin e depozitarit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”. Ndryshimet synojnë mbrojtjen e investitorit nëpërmjet qartësisë të marrëdhënies së shoqërisë administruese dhe depozitarit, duke parashikuar që detyrimet të përcaktohen qartë mes tyre e të mos i ngarkohen investitorit komisione apo tarifa që nuk rrjedhin nga marrëdhënia e tij direkte me shoqërinë administruese.

7. Fuqizimi i rolit informues dhe edukimi i publikut në lidhje me fillimin e funksionimit të tregut të titujve.

Bordi i AMF-së me vendimin nr. 128, datë 31.08.2017, miratoi strategjinë dhe planin e veprimit “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje”.

Qëllimi i strategjisë është rritja e besimit të konsumatorit/investitorit për tregjet nën mbikëqyrje, përmes rritjes së shkallës së njohurive nëpërmjet edukimit financiar, informimit, ndërgjegjësimit dhe mbrojtjes së konsumatorit/investitorit.

Ndër aktivitetet kryesore të zhvilluara nga Autoriteti gjatë vitit 2017 për vënien në zbatim të strategjisë “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje” kanë qenë nënshkrimi i Memorandumeve të Bashkëpunimit me universitetet publike dhe private në vend, zhvillimi i orëve të hapura pranë auditoreve dhe informimi pranë stendave të ngritura, zhvillimi i anketimeve për të kuptuar nivelin e njohurive dhe pjesëmarrjen në tregjet financiare që mbikëqyren nga Autoriteti, etj.

8. Ndjekja e një politike të hapur me qytetarët dhe me median. Hartimi dhe respektimi i mekanizmave informues ligjorë e publikë, në mënyrë që të inkurajohet dhe rritet besimi i konsumatorit.

Gjatë vitit 2017, AMF ka rritur prezencën në median vizive dhe të shkruar. Drejtues të lartë të Autoritetit dhe ekspertë të fushave respektive kanë marrë pjesë në programe ekonomike, janë prezantuar artikuj të ndryshëm në media, veçanërisht ato me karakter ekonomik. U ridimensionua faqja e webit të AMF-së, me qëllim aksesueshmërinë nga të gjithë aktorët e tregut dhe konsumatorët dhe lehtësimin e gjetjes së rubrikave përkatëse në të.

Risi gjatë vitit 2017 në zhvillimin e mekanizmave të komunikimit me qytetarin, përbën edhe prezencën në median sociale, nëpërmjet faqes së Facebook-ut, ku hapja dhe vënia në funksionim e kësaj faqeje shërbeu dhe do të shërbejë jo vetëm për t'i përcjellë publikut informacion mbi aktivitete apo njoftime që lidhen me veprimtarinë e Autoritetit, por nga ana tjetër dhe si një forum, ku qytetarët mund të drejtojnë pyetje e të marrin përgjigje, madje dhe të parashtrojnë ankesat e tyre.

Në kuadër të informimit të publikut, AMF ka publikuar dhe vazhdon të publikojë rregullisht çdo informacion në lidhje me shoqëritë e brokerimit që operojnë në platformat *online* me qëllim transparencën e aktivitetit të këtyre subjekteve.

9. Ridimensionimi i marrëdhënieve bashkëpunuese me partnerët ndërkombëtarë dhe institucionet homologe të rajonit.

Fuqizimi dhe bashkëpunimi me institucionet homologe të rajonit e më gjerë kanë qenë në fokus të punës së Autoritetit. Gjatë vitit janë zhvilluar një seri takimesh me autoritetet homologe nga Austria, Kosova, Italia, Maqedonia, etj. Gjithashtu dhe pjesëmarrja në aktivitetet që organizohen nga organizatat ndërkombëtare të tregjeve nën mbikëqyrje, kanë shërbyer për të fuqizuar marrëdhëniet me të gjitha autoritetet mbikëqyrëse që aderojnë në to.

Falë bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe marrëdhënies profesionale të AMF-së me organizatat në të cilat aderon, **për herë të parë Shqipëria u përzgjodh nga Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve (IOPS) si vendi organizator i një konference në nivel botëror, e cila do të zhillohet në Tiranë në vjeshtën e vitit 2019.**

Gjithashtu AMF do të organizojë gjatë këtij vitin një takim rajonal me institucionet homologe për tregjet nën mbikëqyrje.

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) në bashkëpunim me Bankën Botërore do të organizojnë **për herë të parë në Shqipëri *workshop-in* ndërkombëtar me temë “Mbikëqyrja me bazë rreziku,” nën kujdesin organizativ të AMF-së, në muajin shtator 2018.** Në këtë event parashikohet të marrin pjesë përfaqësues të autoriteteve homologe rregullatore dhe mbikëqyrëse, përfaqësues të grupeve të sigurimit dhe risigurimit, ku do të diskutohen dhe shkëmbehen eksperiencat dhe pikëpamje mbi tendencat globale të mbikëqyrjes me bazë rreziku, si dhe sfidat që lidhen me zbatimin e standardeve globale të mbikëqyrjes.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare janë zhvilluar një seri takimesh me përfaqësues të Bankës Botërore, përfaqësues të FMN-së, dhe organizmave të tjerë që kanë përfaqësitë e tyre në Shqipëri.

10. Rishikimi i rregulloreve të brendshme të funksionimit dhe strukturës organizative.

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017 u punua në drejtim të rishikimit dhe ndryshimeve të rregulloreve të organizimit, funksionimit dhe përshkrimit të detyrave dhe strukturës së AMF-së, me synim mirëfunksionimin e burimeve njerëzore dhe përcaktimin e përgjegjësisë sipas vendeve të punës. Gjithashtu në muajin nëntor u miratua në Bordin e AMF-së rregullorja e re

financiare, e cila i përgjigjet nevojave për ndryshim dhe mënyrës së re të raportimit dhe buxhetimit.

KRONOLOGJIA E NGJARJEVE ME TË RËNDËSISHME NË VITIN 2017

Gjatë vitit 2017, për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare ka patur zhvillime të rëndësishme në drejtim të mbrojtjes konsumatore, zgjidhjes përfundimtare të problematikave të akumuluarra ndër vite në lidhje me Fondin e Kompensimit, hartimit të strategjive për rritjen e besimit të konsumatorëve dhe strategjive për zhvillimin e tregjeve, modernizimit të infrastrukturës së IT-së, përmirësimit të kuadrit ligjor e rregullativ, licencimeve të reja, zbatimit të projekteve të asistencës teknike dhe projekteve të reja si dhe bashkëpunimit institucional vendas dhe ndërkombëtar.

Disa nga ngjarjet më të rëndësishme për Autoritetin gjatë vitit 2017 përmbledhen në mënyrë kronologjike në tabelën e mëposhtme:

Janar	➤ Filloi faza e dytë e Projektit: “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve”. Kjo fazë synon rishikimin e kuadrit ligjor e rregullativ të Autoritetit.
Shkurt	➤ Filloi faza e tretë e Projektit: “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve. Kjo fazë synon forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit për t’iu përgjigjur zhvillimit të tregjeve të kapitalit.
Mars	➤ Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi shkarkimin përpara afatit të Znj.Enkelelda Shehi nga detyra e anëtarit të Bordit dhe Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. ➤ Në funksion të nxitjes së zhvillimit të tregut të kapitaleve Autoriteti licenoi një shoqëri brokerimi për të vepruar njëkohësisht si agjent i lidhur për llogari të një shoqërie brokerimi jashtë vendit.
Prill	➤ Kuvendi i Shqipërisë, në seancën plenare të datës 6 prill 2017, miratoi me Vendimin nr. 37/2017 emërimin e Z. Ervin Koçi në detyrën e anëtarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, duke mbajtur njëkohësisht edhe funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv. ➤ Përfundon me sukses programi i trajnimit afatgjatë të kualifikimit profesional për aktuar të organizuar nga Autoriteti në bashkëpunim të ngushtë me Institutin dhe Fakultetin e Aktuarëve në Londër dhe pjesëmarrjen e Shoqatës Shqiptare të Aktuarëve. U shpërndanë certifikatat

	për 9 aktuarët e rinj. ➤ Nënshkruhet Memorandumi i Bashkëpunimit “Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare”, midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Bankës së Shqipërisë.
Maj	➤ Zhvillohet takimi i punës midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Autoritetit të Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA) për çështje të rëndësishme të interesit të përbashkët për tregjet e sigurimeve. ➤ AMF aplikon për pjesëmarrje në Projektin e Mikrosigurimeve “Akses në Iniciativën e Sigurimeve” (A2ii). Shqipëria u përzgjedh si një nga vendet fituese dhe pjesëmarrëse në këtë projekt.
Qershor	➤ Bordi i Autoritetit me Vendimin nr. 69, datë 19.06.2017 miratoi ndryshime të strukturës organizative të AMF-së, në zbatim edhe të rekomandimeve të konsulentëve të projektit “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, me qëllim krijimin e strukturave të dedikuara sipas tregjeve nën mbikëqyrjen e AMF-së dhe në përgjigje të zhvillimeve të këtyre tregjeve. ➤ Bordi i AMF-së, me Vendimin nr. 81, në mbledhjen e datës 19 qershor 2017 vendosi heqjen e licencës për shoqërinë “<i>Stock International Albania sh.a.</i>” ➤ Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare merr pjesë si përfaqësues në delegacionin shqiptar në seancën e 53-të Plenare të Komitetit të Ekspertëve për vlerësimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, (Moneyval) të Këshillit të Evropës. ➤ Bordi i AMF-së me Vendimin nr. 84, datë 19.06.2017, ngriti Komitetin Këshillimor për hartimin e strategjisë 5-vjeçare për zhvillimin e tregjeve financiare nën mbikëqyrje.
Korrik	➤ Bordi i AMF-së me Vendimin nr. 88, datë 03.07.2017, licenoi shoqërinë e parë me kapital privat “Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE” për ushtrimin e veprimtarisë si bursë e titujve, si domosdoshmëri për zhvillimin e tregut sekondar në Shqipëri. ➤ Në datat 10–11 korrik 2017 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi

	takime të përbashkëta pune me drejtues të lartë të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë (ISA). Qëllimi i takimit ishte forcimi më tej i bashkëpunimit mes institucioneve, për një mbikëqyrje efektive dhe dinamike të tregut të sigurimeve në të dy vendet.
Gusht	➤ Bordi i Autoritetit, me Vendimin nr. 128, datë 31.08.2017 miratoi “Strategjinë për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje 2017-2020” që ka në fokus rritjen e besimit të konsumatorit edhe nëpërmjet edukimit financiar. ➤ Bordi i Autoritetit miratoi Rregulloren nr. 130, datë 31.08.2017 “Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e detyrave”, duke përcaktuar normat e përgjithshme që rregullojnë organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e strukturës dhe detyrave kryesore të çdo njësie të Autoritetit.
Shtator	➤ Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve “Inspektimet e përbashkëta në shoqëritë e sigurimeve dhe subjektet e tjera në mbikëqyrje të AMF-së dhe shkëmbimin e informacionit”. ➤ Zhvillohet takimi në nivel të lartë bilateral midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve (ISA) të Maqedonisë për çështje të mbikëqyrjes efektive të tregut të sigurimeve.
Tetor	➤ Bordi i AMF-së, me Vendimin nr. 146, datë 20.10.2017, vendosi që raportimi dhe identifikimi i policave kufitare të shitura nga shoqëritë e sigurimit të kryhet në kohë reale nëpërmjet Regjistrit Elektronik <i>online</i> të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet e mundshme. ➤ Shoqëritë e sigurimit filluan të përdorin Regjistrin e ri Elektronik të Dëmeve, i cili së bashku me Regjistrin Elektronik <i>online</i> të shitjeve të produkteve të sigurimit të detyrueshëm motorik përbën infrastrukturën bazë për zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemit <i>Bonus-Malus</i>.
Nëntor	➤ Filloi raportimi dhe identifikimi i policave kufitare të shitura nga shoqëritë e sigurimit në kohë reale nëpërmjet Regjistrit Elektronik <i>online</i> të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik, në zbatim të Vendimit të Bordit të

	Autoritetit. ➤ Autoriteti miratoi shtesë të Fondit të Kompensimit për vitin 2017, me qëllim zgjidhjen e problematikave dhe ndjekjen e pagesave të Fondit të Kompensimit gjatë vitit 2017. ➤ Fillon projekti i mikrosigurimeve “Akses në Iniciativën e Sigurimeve” (A2ii) ➤ Fillon projekti “Përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar” me komponent “Përmirësimi i kapaciteteve të rregullatorëve financiarë në monitorimin dhe kontrollin e zbatimit më të mirë të raportimit financiar”. ➤ Bordi i Autoritetit miratoi ndryshimet në Rregulloren nr. 128, datë 06.10.2011, duke krijuar mundësinë e heqjes së komisioneve apo pagesave të ngjashme shtesë që bankat depozitare vendosnin ndaj investitorëve të fondeve të investimeve në momentin e shlyerjeve, duke eliminuar kështu këtë shpenzim shtesë për investitorin. ➤ Bordi i AMF-së me Vendimin nr. 153, datë 30.11.2017 vendosi unifikimin e numrit serial të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik të emetuara nga BSHS-ja, me anë të vendosjes shtesë, para numrit aktual serial (7 numra) të 2 numrave të fundit të vitit aktual për të cilin emetohen policat.
Dhjetor	➤ Bordi i Autoritetit miratoi Fondin e Kompensimit për vitin 2018. ➤ Bordi i Autoritetit merr vendimin për auditimin e veprimtarisë së BSHS-së nga shoqëri auditimi ndërkombëtare. ➤ AMF nënshkroi Memorandumin e Bashkëpunimit me Institutin e Statistikave (INSTAT). ➤ Organizohet <i>workshop-i</i> i parë kombëtar në Shqipëri, në kuadrin e Projektit të mikrosigurimeve “Akses në Iniciativën e Sigurimeve” (A2ii); ➤ AMF përfundoi hartimin e draftligjit të sigurimit të detyrueshëm motorik, për tu diskutuar më pas me grupet e interesit dhe referuar institucioneve përkatëse për mendim.

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI I AUTORITETIT

Në vitin 2017 Bordi i Autoritetit përbëhej nga:

Kryetar Z. Pajtim Melani

Anëtarë Z. Ervin Koçi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

 Znj. Mimoza Kaçi, Nëndrejtor Ekzekutiv

 Z. Arjan Salati, Anëtar Joekzekutiv¹

 Z. Klodion Shehu, Anëtar Joekzekutiv

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare është organi më i lartë drejtues dhe vendimmarrës. Bazuar në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" i ndryshuar, ai është një organ kolegjal i përbërë nga 5 anëtarë, dy prej të cilëve, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Nëndrejtori Ekzekutiv janë anëtarë ekzekutivë me kohë të plotë, ndërsa Kryetari i Bordit dhe dy anëtarë të tjerë janë anëtarë joekzekutivë. Anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë sipas një procedure të përcaktuar në ligj.

Kuvendi i Shqipërisë me Vendimin nr. 19/2017, datë 16 mars 2017 vendosi: “PËR SHKARKIMIN PËRPARA AFATIT TË ZONJËS ENKELEDA SHEHI NGA DETYRA E ANËTARIT TË BORDIT DHE DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE”, pas një monitorimi të vazhdueshëm nga Komisioni përgjegjës i Ekonomisë në Kuvendin e Shqipërisë mbi Vendimet e Bordit dhe performancën e Autoritetit, problematikat e evidentuara gjatë vitit 2016, si në drejtim të organizimit dhe administrimit të veprimtarisë së Autoritetit në përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave ligjore të tij, në transparencën e veprimtarisë etj., duke dëmtuar imazhin e institucionit.

Në seancën plenare të datës 6 prill 2017, Kuvendi i Shqipërisë miratoi me Vendimin nr. 37/2017, “PËR EMËRIMIN E ZOTIT ERVIN KOÇI NË DETYRËN E ANËTARIT TË BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE, QË DO TË MBAJË FUNKSIONIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV”, duke mbajtur njëkohësisht edhe funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv”.

Këto ndryshime i ka vlerësuar edhe Misioni i Bankës Botërore, në vizitën e misionit në datat 8-12 maj 2017, në të cilin citohet:

“Me largimin e Drejtorit Ekzekutiv të mëparshëm të AMF-së, ne vlerësojmë angazhimin tuaj për të inkurajuar një bashkëpunim të mirë me Bordin e AMF-së dhe funksionimin normal të

¹ Në përfundim të mandatit të Z. Arjan Salati, në seancën plenare të datës 25.01.2018, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi të emërojë Z. Idlir Gjata në detyrën e Anëtarit të Bordit të Mbikëqyrjes Financiare.

Autoritetit. Rikthimi i funksionimit normal të AMF-së dhe krijimi i një mjedisi të qendrueshëm dhe mbështetës për të tërhequr dhe mbajtur një staf të cilësisë të lartë, janë të rëndësishëm për të siguruar që AMF të ushtrojë në mënyrë efektive mandatin e saj për mbikëqyrjen e tregut që është nën përgjegjësinë e saj”.

Bordi i Autoritetit, me qëllim përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të tij, gjatë vitit 2017, ka zhvilluar 17 mbledhje dhe ka marrë 221 vendime. Vendimet me të rëndësishme të Bordit janë marre me transparence të plotë, duke u respektuar njekohesisht edhe parimi i shumicës së votave dhe fryma kolegjiale. Tabela e mëposhtme, pasqyron numrin e vendimeve të Bordit të AMF-së të ndarë sipas llojeve.

Tabelë 1: Ndarja e vendimeve të Bordit të AMF-së sipas llojit të vendimit

Llojet e vendimeve	Numër
Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e sigurimeve	113
Vendime për Bursën dhe shoqëritë që veprojnë në tregun e letrave me vlerë	18
Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e pensioneve private vullnetare dhe SIK	10
Vendime për bashkëpunimin institucional	5
Vendime për masa administrative e korrigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura	36
Vendime për kuadrin rregullues të AMF-së	39
Vendime në tërësi	221

Sikurse shihet edhe në tabelë, numri më i madh i vendimeve, vazhdon të jetë i lidhur me tregun e sigurimeve. Në krahasim me vitin e kaluar janë rritur vendimet që lidhen me masat administrative dhe korrigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura, me qëllim rregullimin e veprimtarisë së tyre, 17 më shumë se në vitin 2016. Është rritur gjithashtu numri i vendimeve për kuadrin rregullues të AMF-së me 20 vendime më shumë krahasuar me një vit më parë.

Me qëllim plotësimin apo përmirësimin e kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e tregjeve dhe të institucioneve të mbikëqyrura, Bordi i Autoritetit ka miratuar 8 rregullore të reja, si dhe ka ndryshuar ose plotësuar 14 rregullore ekzistuese.

Në veprimtarinë e Bordit për vitin 2017 vlen të theksohet

1. Vendimi nr. 88, datë 03.07.2017 për licensimin e shoqërisë së parë me kapital privat “Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE” sh.a. për ushtrimin e veprimtarisë si bursë e titujve. Vendimi i Bordit erdhi pas një periudhe të gjatë të diskutimeve dhe plotësimit të kërkesave ligjore dhe rregullative, infrastrukturës dhe sistemeve teknologjike të nevojshme për realizimin e aktivitetit të saj.

2. Vendimi nr. 217, datë 28.12.2017, “Mbi Fondin e Kompensimit të vitit 2018”, duke zgjidhur situatën e Fondit të Kompensimit, si për pagesat e menjëhershme për praktikat e përfunduara, ashtu dhe evidentimin e detyrimeve të këtij fondi
3. Vendimi nr. 84 datë 19.06.2017 për ngritjen e Komitetit Këshillimor për hartimin e Strategjisë 5-vjeçare të zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje;
4. Vendimi nr. 128 datë 31.08.2017 për miratimin e strategjisë për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje (2017–2020);
5. Vendimi nr. 69 datë 19.06.2017 për miratimin e ndryshimeve strukturore të AMF-së, duke reflektuar më së miri zhvillimin dinamik të tregjeve financiare jobankare, veçanërisht atë të fondeve të investimeve.

PËRMBLEDHJE E ECURISË SË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJE

Gjatë vitit 2017, tregjet financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së, kanë vijuar prirjen e tyre për zgjerim. Totali i aktiveve në këto tregje në 31.12.2017 rezultoi në rreth 105.05 miliardë lekë, me një rritje prej 6.5% kundrejt vitit 2016. Treguesi i totalit të aktiveve ndaj PBB-së për vitin 2017 rezultoi 6.9%. Tregu më i madh për tu mbikëqyrur nga pikëpamja e aktiveve mbetet tregu i fondeve të investimeve. Pesha e këtij tregu për vitin 2017 në tregjet financiare të mbikëqyrura nga AMF, arriti në rreth 69.2%, pesha e tregut të sigurimeve arriti në rreth 29.1%, ndërsa ajo e tregut të pensioneve në 1.7%.

Tre tregjet financiare të mbikëqyrura nga AMF karakterizohen nga dinamika e zgjerimit.

Tregu i fondeve të investimeve

Gjatë vitit 2017, në tregun e fondeve të investimeve ushtruan veprimtari 3 fonde të hapura investimesh me ofertë publike të administruara nga dy shoqëri administruese. Asetet neto të tregut të fondeve të investimeve në 31.12.2017 arritën në 72.72 miliardë lekë, me një rritje prej 7.3 miliardë lekë ose 11.14%, krahasuar me vitin 2016. Numri i investitorëve në fondet e investimeve arriti në 31,320 me një rritje prej 7.01% në krahasim me një vit më parë. Rritja e konsiderueshme e tregut të fondeve të investimeve dhe pesha që ky treg zë në tregjet e mbikëqyrura nga AMF, kanë rritur sfidat me të cilat ky Autoritet duhet të përballet për një mbikëqyrje efektive të tij.

Tregu i Sigurimeve

Në këtë treg kanë ushtruar veprimtarinë e tyre 11 shoqëri sigurimi, nga të cilat 8 ushtrojnë veprimtarinë në sigurimin e Jo-Jetës dhe 3 në atë të Jetës. Primet e shkruara bruto për tregun e sigurimeve në vitin 2017 rezultuan në vlerën rreth 16,2 miliardë lekë, me një rritje prej 0.8 miliard lekë ose 5.37% më shumë se një vit më parë. Tregu i sigurimeve ka ruajtur të njëjtin konfigurim të tregut shqiptar në vite, ku volumi i primeve të sigurimit të Jo-Jetës përbën 92.06% të totalit të primeve të tregut të sigurimeve, ndërsa volumi i primeve të sigurimit të Jetës zë vetëm 7.44%. Në vitin 2017 numri i kontratave arriti 1,235,092 me një rritje prej 9.67% krahasuar me një vit më parë. Tregu i sigurimeve edhe gjatë vitit 2017 vazhdoi i orientuar drejt sigurimit të detyrueshëm, ku raporti ndërmjet sigurimeve të detyrueshme dhe atyre vullnetare rezultoi përkatësisht 61.5% dhe 38.5%, raport ky pothuajse i njëjtë me vitin 2016.

Aktivitetet e tregut të sigurimeve të vitit 2017 krahasuar me 31.12.2016, u rritën me 1,169 milionë lekë ose 3.97% duke arritur në vlerën 30.6 miliardë lekë. Kjo rritje vjen vetëm nga sektori i sigurimit Jo-Jetë, i cili u rrit me 1,066 milionë lekë ose 4.07%, ndërsa sektori i Jetës u rrit me 103 milionë lekë ose 3.1%.

Tregu i Pensioneve Private Vullnetare

Tregu i fondeve të pensionit vullnetar që me fillimin e aktivitetit të tij, ka patur tendencë në rritje përse i përket aseteve që menaxhon si dhe numrit të kontribuesve.

Megjithatë, vlera neto e aseteve të këtij tregu është ende në masë të papërfillshme kundrejt PBB-së në Shqipëri. Totali i aseteve neto të këtij tregu në 31.12.2017 rezultoi 1.73 miliard lekë me një rritje prej 31%, krahasuar me një vit më parë.

Numri i anëtarëve në tregun e fondeve të pensionit vullnetar në fund të vitit 2017 rezultoi 20,947 anëtarë, duke shënuar rritje prej 21% krahasuar me fundin e vitit 2016.

Edhe gjatë vitit 2017, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni vullnetar, të administruar nga tri shoqëri administruese.

Kapitulli 1. MBROJTJA E KONSUMATORIT

1.1 Mbrojtja e Konsumatorit dhe Investitorit

Mbrojtja e interesave të investitorëve dhe konsumatorëve është objektiv parësor i veprimtarisë rregullatore dhe mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Mbrojtja efikase e konsumatorit realizohet nëpërmjet: (i) Shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave të konsumatorëve dhe investitorëve; (ii) Monitorimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi lidhur me detyrimin për informim të publikut si dhe afatet e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim; (iii) Rritjes së edukimit financiar për publikun; si dhe (iv) Asistimit të konsumatorit duke i dhënë informacion dhe sqarime sipas kërkesave.

Me qëllim rritjen e rolit të tij si mbrojtës dhe garantues i të drejtave dhe interesave të konsumatorëve, Autoriteti gjatë vitit 2017 ka realizuar reformimin e strukturës organizative duke synuar ngritjen në një dimension të ri më profesional të njësisë së mbrojtjes së konsumatorit dhe fuqizuar rolin e saj si një strukturë e posaçme, e dedikuar për mbrojtjen e konsumatorit dhe edukimin financiar të tij.

Shqyrtimi dhe trajtimi i ankesave të konsumatorëve dhe investitorëve

Shqyrtimi i ankesave të konsumatorit/investitorit edhe gjatë vitit 2017 ka synuar zgjidhjen në mënyrë profesionale, të paanshme e të shpejtë të ankesave të depozituara. Autoriteti nëpërmjet shqyrtimit të ankesave ka marrë informacion të vlefshëm edhe për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë nga subjektet e mbikëqyrura. Në këtë mënyrë duke vlerësuar veprimtarinë e subjekteve të mbikëqyrura apo eksperiencat e ankimuesve mund të evidentohen sjellje jokorrekte të subjekteve dhe të ndërhyhet në kohë për të zgjidhur çështje konkrete si dhe për të marrë në kohë masat e duhura për të shmangur përsëritjen e problematikave të njëjta në të ardhmen, edhe për ata konsumatorë të cilët kanë zgjedhur të mos depozitojnë ankesë në Autoritet.

Gjatë vitit 2017 Autoriteti ka trajtuar 73 ankesa të cilat kanë qenë të fokusuara në çështje që lidhen me tregun e sigurimeve. Kryesisht konsumatori ka paraqitur ankesa për vonesa dhe për procedura joeficiente nga ana e shoqërive të sigurimit në trajtimin dhe pagesën e dëmshpërblimeve të produkteve të sigurimit të përgjegjësisë ndaj palëve të treta, sigurimit të Jetës apo shëndetit, produkte që dominojnë tregun e sigurimeve. Nga totali i ankesave të depozituara, 51 prej tyre lidhen me pagesën e dëmshpërblimit nga Fondi i Kompensimit dhe 22 lidhen me kërkesat për dëmshpërblim që rrjedhin drejtpërsëdrejti nga kontratat e sigurimit të lëshuara nga shoqëritë e sigurimit.

Kërkesat për informacion janë trajtuar nga Autoriteti brenda afateve të shkurtra kohore që variojnë nga 1 deri 5 ditë pune. Në vitin 2017 janë trajtuar rreth 135 kërkesa për informacion, të cilat kanë konsistuar në kërkesa për konfirmim të kontratave të sigurimit, kërkesa për

sqarime për procedurat e dëmshpërblimit në sigurime, kërkesë për informacion mbi produkte specifike të ofruara në tregun e sigurimeve.

Gjithashtu janë paraqitur edhe kërkesa për informacion të cilave iu është kthyer përgjigje brenda një harku kohor 2-3 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës.

Monitorimi i zbatimit të legjislacionit në fuqi lidhur me detyrimin për informim të publikut si dhe afateve të trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim

Gjatë vitit 2017 është kontrolluar veprimtaria e subjekteve të mbikëqyrura lidhur me detyrimin për informim dhe transparencë ndaj publikut. Masat konkrete të marra nga Autoriteti në këtë kuadër janë fokusuar në monitorimin e informacionit të publikuar në faqet zyrtare të subjekteve, shqyrtimin e materialeve publicitare, për të siguruar që informacioni i përcjellë publikut të jetë i plotë, i qartë, i vërtetë dhe lehtësisht i kuptueshëm dhe i aksesueshëm. Në përfundim të verifikimeve të kryera Autoriteti ka kërkuar plotësimin, korrigjimin dhe përditësimin e informacioneve të publikuara në faqet zyrtare apo të informacioneve të materialeve publicitare.

Në funksion të verifikimit të vazhdueshëm të respektimit të afateve ligjore të trajtimit dhe pagesës së dëmshpërblimeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, shërbeu edhe përditësimi i funksionimit të regjistrit elektronik të dëmeve, duke bërë të mundur që afatet e trajtimit të dëmshpërblimeve të monitorohen në kohë reale nga Autoriteti, duke ndërhyrë në rast evidentimi të vonesave në trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim, edhe në rastet kur konsumatori nuk ka paraqitur ankesë.

Asistimi i konsumatorit dhe investitorit duke i dhënë informacion dhe sqarime sipas kërkesave

AMF ka në funksionim mekanizma komunikimi me publikun të cilat mundësojnë asistencën ndaj tyre jo vetëm nëpërmjet trajtimit formal të ankesave e kërkesave, por edhe duke krijuar disponibilitetin që konsumatori të vihet në kontakt lehtësisht dhe në çdo kohë me AMF-në. Për këtë AMF ka në dispozicion të publikut numrin e telefonit, (Tel: +355(0)42257560, Cel +355 694060671) dhe adresë të posaçme email-i konsumatori@amf.gov.al, të cilat janë lehtësisht të aksesueshme në faqen zyrtare të Autoritetit.

Gjithashtu faqja zyrtare e Autoritetit ofron informacion të vazhdueshëm mbi zhvillimin e tregjeve nën mbikëqyrje, me bazën ligjore të përditësuar, njoftimet për veprimtarinë vendimmarrëse të Bordit të Autoritetit etj. Në rubrika të veçanta në faqen *online* pasqyrohen raporte periodike statistikore, informacione edukuese për konsumatorin, si edhe njoftime për zhvillimet e reja në vendet e rajonit për këto tregje, nëpërmjet publikimeve të përmuajshme të lajmeve. Faqja *online* pasqyron informacion për subjektet që veprojnë në tregjet e mbikëqyrura duke dhënë formën e organizmit dhe stafin drejtues ekzekutiv.

1.2 Edukimi Financiar

Autoriteti vlerëson shumë të rëndësishme nevojën për informim dhe edukim financiar të konsumatorit për tregjet nën mbikëqyrje dhe rritjen e kulturës financiare në vend. Ndërkohë që tregjet financiare nën mbikëqyrje vijnë të zhvillohen, produktet e investimeve po bëhen gjithnjë e më komplekse dhe shërbimet financiare gjithnjë e më të ndryshme.

Synimi është që në një të ardhme të afërt, produktet financiare, si sigurimet vullnetare, fondet vullnetare të pensioneve apo fondet e investimit të mos jenë thjesht informacione apo mekanizma financiarë të largët, prej të cilëve konsumatorët financiarë shmangen, por të shndërrohen në pjesë të jetës së tyre ekonomike e të bashkëjetojnë natyrshëm me to. Një konsumator i informuar dhe me njohuri të mjaftueshme financiare ka aftësinë të marrë vendime të drejta për t'u bërë pjesë e skemave financiare të suksesshme.

Përkufizimi i edukimit financiar sipas OECD:

“Procesi, me anë të të cilit konsumatorët/investitorët financiarë:

- a) Përmirësojnë kuptimin e tyre për produktet financiare, konceptet dhe rreziqet;
- b) Zhvillojnë aftësitë dhe besimin për t'u bërë më të vetëdijshëm për rreziqet financiare, përmes informacionit, udhëzimit dhe/ose këshillimeve objektive dhe për të bërë zgjedhje të informuara, për të ditur ku të shkojnë për ndihmë;
- c) Ndërmarrin veprime të tjera efektive për të përmirësuar mirëqenien e tyre financiare”.

1.3 Strategjia e Edukimit

Autoriteti në kuadër të përmbushjes së misionit të tij, vlerëson si një nga përparësitë kryesore informimin dhe edukimin e vazhdueshëm të investitorit dhe konsumatorit për përfshirjen e tij në tregjet financiare. Për këtë qëllim, Bordi i Autoritetit, në muajin gusht 2017 ka miratuar strategjinë “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje 2017-2020” (Strategjia e Edukimit), që ka në fokus rritjen e besimit të konsumatorit edhe nëpërmjet edukimit financiar.

Qëllimi i Strategjisë së Edukimit është rritja e besimit të konsumatorit dhe investitorit për tregjet nën mbikëqyrje, përmes rritjes së shkallës së njohurive nëpërmjet edukimit financiar, informimit, ndërgjegjësimi dhe mbrojtjes së konsumatorit apo investitorit financiar. Nëpërmjet zbatimit të Strategjisë së Edukimit dhe njëkohësisht duke forcuar transparencën institucionale Autoriteti synon gjithashtu të:

- Zgjerojë informacionin e thjeshtë e të kuptueshëm që i transmetohet publikut të gjerë, dhe rrisë shkallën e njohurive të tyre; edukojë profesionalisht grupe të caktuara të profesionistëve në tregjet nën mbikëqyrje;
- Afrojë grupe të tjera profesionistësh që mund të jenë investitorë potencialë në këto tregje;
- Ndërgjegjësojë të rinjtë, për mundësinë e investimit dhe përfshirjes në tregjet financiare nën mbikëqyrje;
- Përfshijë programe për edukimin financiar në kurrikulat mësimore.

Strategjia e Edukimit përfshin një gamë të gjerë nismash dhe aktiviteteve të cilat synojnë të rrisin praninë e Autoritetit në publik nëpërmjet kanaleve të komunikimit, për të rritur shkallën e informimit dhe përcjelljen e informacionit tek publiku, me qëllim rritjen e besueshmërisë së tij për tregjet nën mbikëqyrje. Këto nisma janë përqëndruar në çështje me prioritet të lartë, të cilat janë konsideruar si një mjet për nxitjen e rritjes ekonomike dhe stabilitetit financiar në vend, së bashku me rregullimin e institucioneve financiare nën mbikëqyrje me qëllim final mbrojtjen e interesave të konsumatorit dhe investitorit financiar. Programet apo metodat e edukimit financiar janë hartuar në kuadër të Strategjisë së Edukimit për të përmbushur nevojat dhe nivelin e njohurive financiare të grupeve të synuara dhe mënyrën si kjo audiencë preferon të informohet.

Gjatë vitit 2017, ka filluar puna për zbatimin e Strategjisë së Edukimit në disa drejtime, në përmbushje të qëllimit për rritjen e besimit të konsumatorit dhe investitorit për tregjet nën mbikëqyrje, si:

Aktivitete në Universitete

Pjesë e rëndësishme ka qenë prezenca e stafit të Autoritetit në tre universitete të ndryshme në vend, publike dhe private, duke prezantuar institucionin dhe veprimtarinë e tij, tregjet nën mbikëqyrje, nëpërmjet leksioneve të hapura, anketimit të studentëve, për të finalizuar me nënshkrimin e MoU-ve përkatëse duke përforcuar bashkëpunimin me këto universitete. Kjo, pasi studentët, si konsumatorë dhe investitorë potencialë të produkteve financiare, janë grupi i synuar i informimit, komunikimit dhe edukimit në këtë Strategji të Edukimit.

Bashkëpunimi me median

Transparenca dhe komunikimi me publikun kanë qenë dhe janë në vëmendje të Autoritetit. Duke konsideruar median si një nga mjetet më të rëndësishme dhe efektive për realizimin e një fushate ndërgjegjësimi. Prezenca në media e drejtuesve të lartë dhe ekspertëve në fusha të ndryshme është rritur ndjeshëm, me qëllim afrimin e institucionit me publikun duke i përcjellë atij mesazhin e duhur.

Organizimi i trajnimeve për formim profesional

Ka vijuar puna me organizimin e trajnimeve për formim profesional (kualifikim profesional dhe edukim në vazhdim) për profesionistët që ushtrojnë veprimtarinë si aktuar, broker e vlerësues dëmsh në sigurime dhe broker në letra me vlerë, duke kontribuar kështu në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të cilësisë së lartë për konsumatorët dhe zhvillimin e mëtejshëm të tregjeve nën mbikëqyrje. Tek trajnimet për këto grupe profesionistësh janë pasqyruar edhe praktikatat më të reja e më të mira botërore.

Tabelë 2: Profesionistë të trajnuar në formim profesional gjatë vitit 2017
(në numër)

Profesionistët	Kualifikim profesional	Edukim në vazhdim
Aktuar	9	12
Vlerësues Dëmesh	30	10
Broker në sigurime	18	14
Broker në letra me vlerë	10	
Pjesëmarrës të tjerë	19	20

Programi i trajnimit afatgjatë të kualifikimit profesional për aktuar

Në muajin prill u zhvillua ceremonia e shpërndarjes së çertifikatave për 9 aktuarë të rinj të cilët përfunduan me sukses programin e trajnimit afatgjatë të kualifikimit profesional për aktuar, të organizuar nga Autoriteti në bashkëpunim të ngushtë me Institutin dhe Fakultetin e Aktuarëve në Londër dhe pjesëmarrjen e Shoqatës Shqiptare të Aktuarëve. Programi mësimor i këtij trajnimi ishte në përputhje me programin e Shoqatës Ndërkombëtare të Aktuarëve dhe i bazuar në praktikat më të mira të Institutit dhe Fakultetit të Aktuarëve në Londër. Autoriteti ka kontribuar ndër vite duke krijuar tashmë një shkollë të përhershme aktuariale në Shqipëri, të mbështetur edhe nga Shoqata Shqiptare e Aktuarëve.

I. MBIKËQYRJA E INTEGRUAR E TREGJEVE FINANCIARE JOBANKARE


Kapitulli 2. Mbikëqyrja e Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve të Investimeve

2.1 Tregu i Fondeve të Investimeve

2.1.1 Struktura e Tregut

Gjatë vitit 2017, në tregun e fondeve të investimit ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde të hapura investimesh me ofertë publike të administruara nga dy shoqëri administruese. Të dyja këto shoqëri administruese kryejnë veprimtarinë e administrimit si për fondet e investimit ashtu edhe për fondet e pensionit vullnetar.

Grafik 1: Pesha që zënë asetet neto të secilit Fond Investimi në treg, 31.12.2017



2.1.2 Pozicioni Financiar dhe Mbikëqyrja e Tregut

Që nga fillimi i veprimtarisë së fondit të parë të investimeve në vitin 2012, tregu i fondeve të investimeve është rritur në mënyrë të konsiderueshme dhe ky treg tashmë përfaqëson një pjesë të rëndësishme të sektorit financiar në Shqipëri. Asetet neto të tregut të fondeve të investimeve më 31.12.2017 arritën në 72.71 miliardë lekë ose 546.95 milionë euro me një rritje prej 7.3 miliardë lekë ose 11.14% krahasuar me 31.12.2016. Numri i investitorëve në fondet e investimeve është 31,320 nga të cilët 99.98% janë investitorë individualë.

Investimet e tregut të fondeve të investimit konsistojnë në Obligacione Qeveritare brenda dhe jashtë R.SH., Bono Thesari të Qeverisë së R.SH.-së., Obligacione të shoqërive jashtë vendit, si dhe kuota në fonde investimi. Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare brenda dhe jashtë R.SH.-së, të cilat përbëjnë 61.3% të aseteve të këtij tregu.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet vlera fillestare e kuotës për secilin fond investimi si dhe vlera e saj në fund të viteve 2016 dhe 2017.

Tabelë 3: Vlera e kuotës së fondeve të investimeve më 31.12.2017

(në lekë)

Përshkrimi	Vlera fillestare e vlerës neto të aseteve për kuotë	Vlera neto e aseteve për kuotë 31.12.2016	Vlera neto e aseteve për kuotë 31.12.2017
Raiffeisen Prestigj	1,000 ²	1,381	1,435
Raiffeisen Invest EURO ³	14,000 ⁴	15,395	15,547
Credins Premium	1,037 ⁵	1,059	1,137

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar ecuria e portofolit të tregut të fondeve të investimit gjatë tremujorëve të vitit 2017.

Tabelë 4 : Të dhëna mbi portofolin e fondeve të investimeve, sipas periudhave tremujore të vitit 2017

Përshkrimi	Vlera (në mln. lekë)			
Periudha	31.03.'17	30.06.'17	30.09.'17	31.12.'17
Asetet neto të fondeve	70,839	71,845	73,604	72,717
Totali i aseteve të fondeve	71,065	71,985	73,751	72,921
<i>nga të cilët:</i>	-	-	-	-
Obligacione Qeveritare	42,846	45,182	46,115	44,700
Obligacione të Shoqërive	4,055	3,940	3,724	3,854
Bono Thesari	10,570	11,742	12,417	12,912
Investime në kuota të fondeve të investimit	2,861	2,788	2,820	3,618
Mjete Monetare	10,000	7,525	7,789	7,101
Asete të tjera	733	808	886	736
Totali i Detyrimeve të Fondeve	226	140	147	204

² Vlera fillestare në 01.03.2012

³ Vlerat e Raiffeisen Invest EURO janë konvertuar me kursin në periudhën përkatëse

⁴ Vlera fillestare në 22.11.2012

⁵ Vlera fillestare në 01.08.2016

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar ndryshimi i portofolit të tregut të fondeve të investimit të vitit 2017 kundrejt vitit 2016 si dhe pesha që secili nga përbërësit e portofolit zë në totalin e aktiveve si në vitin 2016 ashtu dhe në vitin 2017.


Tabelë 5: Ndryshimi në përbërjen e portofolit të fondeve të investimeve, 31.12.'16-31.12.'17

Përshkrimi	Vlera (në mln. lekë)		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj totalit (në %)	
	31.12.'16	31.12.'17		31.12.'16	31.12.'17
Periudha			31.12.'16 - 31.12.'17		
Asetet neto të fondit	65,429	72,717	11.14		
Totali i aseteve të fondeve	65,613	72,921	11.14	100	100
<i>nga të cilët:</i>	-	-	-		
Obligacione Qeveritare (të R.SH-së dhe të huaja)	42,234	44,700	5.84	64.37	61.30
Obligacione të Shoqërive	2,830	3,854	36.18	4.32	5.28
Bono Thesari	9,404	12,912	37.30	14.33	17.71
Investime në kuota të fondeve të investimit	2,173	3,618	66.50	3.31	4.96
Mjete Monetare	8,295	7,101	(14.39)	12.64	9.74
Asete të tjera	677	736	8.71	1.03	1.01
Totali i Detyrimeve të Fondeve	184	204	10.87	0.28	0.28

Siç shihet dhe nga grafikët e mëposhtëm për dy vitet e fundit mbi 60% e aseteve të tregut janë të investuara në Obligacione Qeveritare.


Grafik 2: Struktura e asetëve të fondeve të investimeve 31.12.2016

(në %)



Grafik 3: Struktura e asetëve të fondeve të investimeve 31.12.2017

(në %)




Më poshtë tregohen të detajuara investimet e tregut të investimeve brenda dhe jashtë vendit:

Tabelë 6: Detajimi i investimeve të tregut, 31.12.2016-31.12.2017

Përshkrimi	Vlera (në mln. lekë)		Ndryshimi (në %)
Periudha	31.12.'16	31.12.'17	31.12.'16 - 31.12.'17
Totali i investimeve	56,642	65,084	14.90
<i>nga të cilët:</i>			
Brenda vendit	50,358	56,441	12.08
Obligacione Qeveritare	40,954	43,529	6.29
Bono Thesari	9,404	12,912	37.30
Jashtë vendit	6,283	8,643	37.56
Obligacione Qeveritare	1,280	1,171	(8.52)
Obligacione të Shoqërive	2,830	3,854	36.18
Investime në kuota të fondeve të investimit	2,173	3,618	66.50

Grafik 4: Profili i Investimit të tregut të fondeve të investimit 31.12.2017



Në kuadër të respektimit të kërkesave të rregullores së likuiditetit shoqëritë administruese kujdesen që fondet e investimit që investojnë në tregje jo aktive të mbajnë likuiditet deri në një muaj minimalisht 10%. Siç shihet dhe në grafikun e mësipërm maturimi deri në një muaj i tregut të fondeve të investimit është 16.16%.

Autoriteti, me qëllim përballimin e sfidave të këtij tregu, të cilat vijnë kryesisht nga rritja e tij dhe pesha që ky treg tashmë zë në tregjet e mbikëqyrura prej tij, ka punuar me prioritet për përmirësimin e bazës ligjore në drejtim të mbrojtjes së interesave të investitorëve dhe ndërhyrjes efikase dhe të shpejtë në raste kur kërkohet ndërhyrje nga rregullatori.

Kështu, në shtator 2017, u miratuan ndryshimet në Rregulloren nr. 137, datë 28.09.2017 “Mbi përmbajtjen e detyrueshme, afatet dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive të administrimit dhe depozitarëve” duke përshpejtuar dhe përmirësuar raportimin financiar në mënyrë që ndërhyrja e AMF-së të jetë sa më e shpejtë dhe efikase.

Në nëntor 2017, Bordi i AMF-së miratoi ndryshime në Rregulloren nr. 128, datë 06.10.2011 “Mbi procedurat dhe kërkesat shtesë për licencimin e depozitarit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”, **duke hequr komisionet apo pagesat e ngjashme shtesë që bankat depozitare ngarkonin ndaj investitorëve të fondeve të investimeve në momentin e shlyerjeve.** Duke mbajtur në konsideratë se baza ligjore dhe shoqëritë administruese kanë vendosur një limit për tarifat që do t’u ngarkohen investitorëve, si dhe faktin që komisionet e aplikuara nga banka depozitare në momentin e shlyerjeve nuk janë pjesë e tarifës së administrimit dhe nuk reflektohen në asetet neto të fondit të investimit, Autoriteti kërkoi ndalimin e kësaj praktike me anë të ndryshimit të rregullores të përmendur më sipër. Ky vendim i shërben mbrojtjes së mëtejshme të interesave të investitorëve, pjesëmarrës në skemat e investimeve kolektive, duke eliminuar kështu këtë shpenzim shtesë për investitorin.

Në dhjetor 2017, Bordi i AMF-së miratoi ndryshime në Rregulloren nr. 97, datë 25.06.2014 “Për informacionin kryesor që duhet t’i vihet në dispozicion investitorit të skemave të investimeve kolektive”, ku u përcaktua metodologjia që shoqëria administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive duhet të ndjekë për përllogaritjen e treguesit të riskut sintetik dhe përfitimit, i cili paraqitet në dokumentin me informacionin kryesor për investitorin.

Disa të dhëna nga vendet e rajonit

Në Kroaci operojnë 30 shoqëri administruese të fondeve të investimit nga të cilat 14 janë shoqëri administruese të UCITS dhe 16 janë shoqëri administruese të AIFs, ndërkohë që operojnë 168 fonde investimi të ndara respektivisht 94 UCITS, 39 AIFs, 1 fond special dhe 34 fonde me ofertë private. Sllovenia ka 22 shoqëri administruese (2 për UCITS, 14 për AIFs dhe 6 për fondet ombrellë) të cilat administrojnë 36 fonde investimi të cilat janë 10 UCITS, 18 AIFs, 2 fonde speciale dhe 95 fonde ombrellë të UCITS. Serbia ka të licencuara 6 shoqëri administruese të cilat administrojnë 19 fonde investimi. Në Maqedoni operojnë 5 shoqëri administruese të cilat administrojnë 15 fonde të hapur investimi dhe 12 fonde me ofertë

private. Mali i Zi ka 6 shoqëri administruese të cilat administrojnë 10 fonde investimi, nga të cilët 5 janë fonde të hapur dhe 5 me ofertë private.

Tabelë 7: Informacion mbi numrin e shoqërive administruese dhe fondeve të investimit në vendet e rajonit

Vendi	Shoqëri administruese (nr)	Fonde Investimi (nr)
Kroaci	30	168
Slloveni	22	36
Serbi	6	19
Maqedoni	5	27
Mal i Zi	6	10

2.1.3. Inspektime të Përbashkëta për Mbikëqyrje të Konsoliduar të Tregjeve Financiare

Gjatë vitit 2017, AMF-ja ka kryer inspektim në një prej Shoqërive Administruese të Fondeve të Pensioneve (SHAFF) dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive (SIK), me qëllim zbatimin nga kjo e fundit e kuadrit rregullator në fuqi. Objekt i këtij inspektimi ishte vlerësimi i elementëve të transparencës me klientët e Fondeve të Investimeve gjatë shitjes së produktit nga ana e shoqërisë administruese, në vijim të zbatimit të rekomandimeve të AMF-së nga inspektimet e mëparshme. Grupi i inspektimit u mbështet nga punonjës të Bankës së Shqipërisë në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy institucioneve rregullatore.

Gjithashtu, objekt i këtij inspektimi ishte verifikimi i zbatimit të rregulloreve nga ana e shoqërisë administruese të Fondeve të Investimeve, në lidhje me vlerësimin e aseteve, administrimin e rrezikut si dhe manaxhimin e likuiditetit.

Në përfundim të këtij inspektimi, Autoriteti doli në konkluzione për secilën nga çështjet e inspektimit dhe i komunikoi shoqërisë rekomandimet përkatëse.

2.2 Tregu i Kapitaleve

Bursa

Bordi i AMF-së me Vendimin nr. 88, datë 03.07.2017, licençoi shoqërinë e parë me kapital privat "Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE" sh.a. për ushtrimin e veprimtarisë si bursë e titujve. Vendimi i Bordit erdhi pas një periudhe të gjatë të diskutimeve dhe plotësimit të kërkesave

ligjore dhe rregullative, infrastrukturës dhe sistemeve teknologjike të nevojshme për realizimin e aktivitetit të saj.

Aksionerët pjesëmarrës në kapitalin e Bursës janë: Credins Bank (42.5%), ABI Bank (42.5%) dhe AK-Invest (15%).

Mbështetur në zhvillimet aktuale, si dhe në nevojën për rritjen e kulturës financiare të investorëve dhe emetuesve, Autoriteti vendosi që në vitin e parë të funksionimit të saj (vit i cili fillon nga momenti i vënies në funksionim të infrastrukturës teknike), Bursa e Titujve do të ushtrojë veprimtarinë vetëm në titujt e Qeverisë të Republikës së Shqipërisë.

Tregtimi i titujve në Bursë realizohet nëpërmjet një platforme elektronike tregtimi, e quajtur “Quick Trade”, sistem i cili përdoret nga disa bursa të rajonit.

Në gjysmën e dytë të vitit 2017, pranë Bursës u kryen të gjitha testimet e nevojshme mbi funksionimin e sistemit të tregtimit. Në dhjetor të vitit 2017, Bursa Shqiptare e Titujve organizoi trajnimin mbi sistemin e tregtimit me disa brokera, kryesisht banka të licencuara për aktivitetin e brokerimit në tregun e letrave me vlerë dhe që do të jenë anëtarët potencialë të Bursës. Sistemi i tregtimit u instalua edhe në AMF, me qëllim mbikëqyrjen minutë pas minute të tregtimit në Bursë. Autoriteti po tregohet i kujdesshëm për të monitoruar çdo veprim të bursës për të ofruar garanci dhe transparencë maksimale për investorët.

Funksionimi i Bursës në transaksionet e titujve të Qeverisë, është i lidhur domosdoshmërisht me sistemin e Shlyerjes dhe Regjistrimit të Titujve, AFISaR, pranë Bankës së Shqipërisë. Nga pikëpamja ligjore dhe teknike pothuajse është realizuar procesi i ndërveprimit të Bursës me sistemin AFISaR.

Ndërkohë, Autoriteti po i kushton vëmendje bazës rregullatore të vetë Bursës, në mënyrë që të sigurohet dhe të ofrohet një treg i barabartë për të gjithë operatorët, një treg i drejtë dhe transparent.

Krijimi i Bursës Shqiptare erdhi si domosdoshmëri për të plotësuar nevojat e biznesit për financim si dhe kërkesën e investorëve për alternativa të reja investimi përtej atij bankar. Domosdoshmëria e licencimit të Bursës lidhet edhe me funksionin e rëndësishëm të tregut sekondar për të krijuar likuiditet dhe një vlerësim të drejtë të çmimit të titujve.

Tregu mbi Banak (OTC)

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë është i organizuar në formën e tregut mbi banak. Tregu mbi banak i rregulluar dhe mbikëqyrur nga AMF përfshin vetëm tregtimet ndërmjet shoqërive komisionere të licencuara për të kryer transaksione në tregun me pakicë të letrave me vlerë (kryesisht Banka) dhe investorëve individualë apo investorëve - persona juridikë. Megjithë emetimin e disa dëftesave tregtare apo obligacioneve me ofertë private nga

disa institucione financiare dhe shoqëri tregtare, veprimtaria në tregun e titujve përqëndrohet kryesisht në transaksionet në tregun me pakicë të titujve të qeverisë.

Tregu me pakicë dominohet nga blerjet e bankave në tregun primar të titujve të qeverisë, për llogari të klientit nëpërmjet blerjes direkt në ankandet e organizuara nga Ministria e Financave përmes Bankës së Shqipërisë. Kurse veprimtaria në tregun sekondar mbetet ende e ulët. Në mungesë të alternativave të investimit, pjesëmarrësit në tregun primar të titujve të qeverisë kanë prirjen për t'i mbajtur titujt deri në maturimin e tyre.

Edhe në vitin 2017, në zbatim të Rregullores nr.22, datë 26.03.2009 “Për Tregun me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë së RSH-së”, shoqëritë komisionere të licencuara për të kryer transaksione në tregun me pakicë të letrave me vlerë kanë raportuar periodikisht në Autoritet, si dhe kanë pasqyruar në kohë reale në platformën GSRM transaksionet e kryera në këtë treg. Kjo platformë vazhdoi të funksionojë dhe të përmbushë rolin e saj në funksion të rritjes së transparencës në kuotime dhe dhënies së informacionit të plotë për publikun dhe investitorët institucionalë mbi transaksionet në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë. Gjatë vitit 2017 në platformën GSRM janë kryer 16,048 klikime duke zënë 4% të vizitave në faqen zyrtare të AMF-së.

Volumi i transaksioneve në tregun me pakicë të titujve të Qeverisë

Volumi i transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2017 u dominua në masën 75.12% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe pjesa tjetër prej 24.88% ishin instrumente afatgjatë (obligacione). Përsa i përket numrit të transaksioneve, 93.07% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2017 tregojnë një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim”, përkatësisht me 60.22% dhe 29.82% kundrejt volumit të përgjithshëm. Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë për këtë periudhë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 99.67% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Transaksioni “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë vitit 2017 ka pasur një ulje prej 1,826 milionë lekë ose 28.04% krahasuar me vitin 2016. Gjithashtu edhe numri i transaksioneve është ulur në masën 33.16%. Transaksioni “Blerje para afatit të maturimit” gjatë vitit 2017 ka patur ulje prej 938 milionë lekë ose 26.75% dhe gjithashtu, një ulje në numrin e transaksioneve në masën 22.72%, krahasuar me vitin 2016.

Tabelë 8: Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë

Lloji i Transaksionit		Vlera nominale (në mln. lekë)		Ndryshimi (në %)
		2016	2017	'17/'16
Letra me Vlerë të Qeverisë				
A	Blerje në tregun primar	38,732.30	48,556.49	25.36
	<i>Individë</i>	27,860.61	26,119.69	(6.25)
	<i>Persona juridikë</i>	10,871.69	22,436.80	106.38
B	Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	6,511.15	4,685.59	(28.04)
	<i>Individë</i>	5,397.25	4,291.69	(20.48)
	<i>Persona juridikë</i>	1,113.90	393.90	(64.64)
C	Blerje para afatit të maturimit	3,506.67	2,568.48	(26.75)
	<i>Individë</i>	3,024.77	2,551.48	(15.65)
	<i>Persona juridikë</i>	481.90	17.00	(96.47)
D	Vendosje e bonos si kolateral	464.90	773.16	66.31
	<i>Individë</i>	288.90	506.16	75.20
	<i>Persona juridikë</i>	176.00	267.00	51.70
E	Shlyerje e vlerës nominale në maturim	19,534.10	24,046.12	23.10
	<i>Individë</i>	18,365.01	22,944.28	24.93
	<i>Persona juridikë</i>	1,169.09	1,101.84	(5.75)

Tregu i obligacioneve të shoqërive aksionare (Obligacionet e emetuara me ofertë private)

Obligacionet e emetuara nga shoqëritë aksionare deri tani kanë qenë me ofertë private dhe i ofrohen investitorëve institucionalë, aksionerëve të vetë emetuesve apo deri 100 individëve.

Edhe gjatë vitit 2017 Autoriteti vijoi me miratimin e prospekteve për emetimin e obligacioneve të dy institucioneve financiare, nga të cilat 1 bankë (2 emetime), e cila emetoi obligacione të

konvertueshme në aksione dhe 1 institucion mikrokredie (1 emetim). Karakteristikat e këtyre obligacioneve janë: interesi fiks, kuponi gjashtëmujor dhe afati i gjatë i maturimit, apo tipari i konvertimit në aksione. Gjatë vitit 2017 vlera gjithsej e emetimeve të miratuara arriti në 1,525 milion lekë.

2.3 Aktiviteti i Licencimit

Gjatë vitit 2017, Autoriteti licençoi subjekte të reja si dhe miratoi licenca shtesë për subjektet ekzistuese. Kështu në vitin 2017, numri i kujdestarëve të obligacioneve të shoqërive aksionare u rrit me 3, pas licencimit të Bankës Amerikane të Investimit për të vepruar si kujdestar në këto tituj. Rritja e numrit të kujdestarëve është rezultat i rritjes së interesit të shoqërive aksionare për të emetuar obligacione. Numri i shoqërive komisionere u rrit me 3 duke arritur në 17.

Gjatë vitit 2017, janë licencuar 3 shoqëri brokerimi me fokus të aktivitetit si agjentë i brokerit të huaj nën administrim të të cilëve janë platformat *online* përkatëse”.

1. Shoqëria “EUROTRADE Securities” për llogari të shoqërisë së brokerimit “Lead Capital Markets” Ltd.
2. Shoqëria “Prodata Securities” për llogari të shoqërisë së brokerimit “Depaho” ltd.
3. Shoqëria “Smartcom” sh.a. për llogari të “Rodeler” Ltd, shoqëri brokerimi në tituj.

Licencimi i këtyre shoqërive u krye pas inpektimit të kryer për infrastrukturën e instaluar në këto shoqëri. Deri në fund të vitit 2017 në tregun e titujve rezultojnë 17 shoqëri komisionere, 26 broker individë, 2 shoqëri këshillimi për investime, 3 këshilltarë individë, 4 agjentë të lidhur, 9 kujdestarë të letrave me vlerë, 1 regjistruar që përfaqësohet nga Qendra e Regjistrimit të Aksioneve.

Tabelë 9: Subjekte që veprojnë në tregun e titujve 2011-2017


(në numër)

Subjekte	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Bursa Shqiptare e Titujve	0	0	0	0	0	0	1
Shoqëri komisionere	13	13	13	13	14	15	17
Broker fizik në shoqëri komisionere	17	18	18	18	19	21	26
Kujdestarë të titujve të Qeverisë së R.Sh.	7	8	8	8	8	8	9
Rregjistruar aksionesh	1	1	1	1	1	1	1
Shoqëri këshillimi për investime në tituj	0	0	1	1	1	2	2
Këshilltar për investime në tituj	0	0	1	1	1	3	3
Agjent i lidhur	1	1	1	1	2	2	4

2.4 Qeverisja

Në mbështetje të kërkesave ligjore dhe nënligjore, struktura e organizimit dhe drejtimit të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe fondeve të pensionit vullnetar, paraqitet në skemën më poshtë:

Grafik 5: Skema e strukturës aktuale të drejtimit të shoqërive të administrimit të fondeve të pensioneve dhe investimeve



Tabelë 10: Të dhëna për aksionarët e shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe фондеве të pensionit vullnetar

Subjekte	Numër
Shoqëri administruese	3
Aksionarë gjithsej	5
<i>Klasifikimi i aksionerëve sipas pjesëmarrjes zotëruese</i>	
nën 10%	0
mbi 10% nën 33 %	1
mbi 33% nën 50%	1
mbi 50%	3

Tabelë 11: Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës

Subjekte	Numër
Aksionarë gjithsej	5
<i>nga të cilët</i>	
Aksionarë të huaj	2
Aksionarë vendas	3

Tabelë 12: Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit

Subjekte	Numër
Aksionarë gjithsej	5
<i>nga të cilët:</i>	
Aksionarë individ	1
Aksionarë shoqëri	4

Tabelë 13: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve statutore

Arsyeja e Ndryshimit të Statutit	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Statut i ri/ndryshime të tjera	-	-	1	2	2	-
Rritje kapitali	1	1	1	-	-	1
Ndryshim i strukturës aksionere	-	1	1	-	-	1

Shoqëritë që operojnë në tregun e titujve janë të organizuara në përputhje me Ligjin “Për shoqëritë tregtare”. Ndërkohë kërkesat për emërimin e administratorëve apo anëtarëve të këshillit mbikëqyrës/administrimit janë të përcaktuara në Ligjin e Titujve apo në bazën rregullative të AMF-së.

Për një qeverisje sa më të mirë të shoqërive që veprojnë në tregun e titujve, i është kushtuar kujdes përmbushjes së kërkesave nga personat që mbajnë pozicione drejtuese në shoqëri. Risi për vitin 2017 ka qenë realizimi i intervistave për personat që emërohen administratorë apo anëtarë të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, me qëllim konkludimin mbi përshtatshmërinë dhe aftësinë e tyre.

2.5 Inspektive Pranë Shoqërive që Kryejnë Veprimtarinë e Agjentit të Lidhur

Në datat 10 dhe 11 Maj 2017, u zhvillua inspektim në vend, pranë shoqërive të cilat janë miratuar nga AMF për të kryer veprimtarinë e agentit për llogari të shoqërive të huaja të brokerimit që administrojnë platforma të tregimit *online*.

Ky inspektim kishte në fokus: kushtet teknike dhe organizative të këtyre shoqërive dhe kryesisht infrastrukturën për kryerjen e veprimtarisë, njoftimet dhe reklamat për publikun, mënyrën e identifikimit të klientëve dhe databazat e tyre, mënyrën e evidentimit dhe raportimit të aktivitetit të kryer si dhe respektimin e detyrimeve kontraktuale me shoqërinë e huaj të brokerimit.

Pas inspektiveve në vend, Autoriteti konstatoi se shoqëria “Stock International Albania” sh.a., në funksionin e saj si agjent i brokerit të licencuar kishte mbyllur zyrën ku zhvillonte aktivitetin, kishte larguar stafin, si pasojë e vështirësive financiare të saj dhe nuk dispononte mjete teknike për të siguruar lidhjet mes klientëve, si dhe nuk kishte realizuar detyrimin ligjor për raportim pranë AMF-së të pasqyrave financiare të vitit 2016 dhe ato lidhur me aktivitetin e kryer për periudhën 1 janar - 31 mars 2017. Në vijim Autoriteti ndërmori masat përkatëse ndaj kësaj shoqërie.

2.6 Zbatueshmëria dhe Kuadri Ligjor e Rregullativ

2.6.1 Kuadri Ligjor e Rregullativ

Gjatë vitit 2017 Autoriteti punoi për hartimin dhe përmirësimin e akteve nënligjore të tregut të titujve dhe fondeve të investimit si më poshtë:

Aktet e Autoritetit në fushën e Titujve dhe Fondeve të Investimit

- Rregullores nr.127, datë 06.10.2011 “Mbi përmbajtjen e detyrueshme, afatet dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive të administrimit dhe depozitarëve” iu bënë disa amendime, të cilat ndryshojnë (afrojnë) afatet e dorëzimit në Autoritet të pasqyrave financiare të fondeve të investimit nga shoqëritë e administrimit. Të tjera ndryshime konsistuan në formatin e pasqyrave financiare të fondeve të investimit që depozitohen nga shoqëritë e administrimit në

Autoritet si dhe ndryshimin e afateve për dorëzimin e raporteve të mbikëqyrjes së likuiditetit për fondet e investimit nga shoqëritë e administrimit.

- Rregullores nr.68, datë 27.07.2009 “Mbi përgatitjen dhe publikimin e analizave financiare në fushën e letrave me vlerë” dhe Rregullores nr.165, datë 23.12.2008 “Për licencimin e shoqërive të brokerimit/këshillimit, brokerit dhe këshilltarit të investimeve” iu bënë rregullimet përkatëse me qëllim përputhjen e emërtimeve me ndryshimet në ligjin dhe në strukturën organizative të AMF-së.
- Rregullores nr. 97, datë 25.06.2014 “Për informacionin kryesor që duhet t’i vihet në dispozicion investitorit të skemave të investimeve kolektive”, iu bënë ndryshime duke i shtuar një aneks të dytë në lidhje me informacionin kryesor për investitorin, i cili duhet të përmbajë një tregues sintetik mbi riskun të paraqitur në mënyrë grafike.
- Rregullores nr. 128, datë 06.10.2011 “Mbi procedurat dhe kërkesat shtesë për licencimin e depozitarit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”, iu bënë ndryshime me synim mbrojtjen e investitorit nëpërmjet qartësimi të marrëdhënies së shoqërisë administruese dhe depozitarit, duke parashikuar që detyrimet të përcaktohen qartë mes tyre e të mos i ngarkohen investitorit.

2.1.1 Masat Korrigjuese dhe Administrative

Legjislacioni që rregullon veprimtarinë e subjekteve financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së si edhe Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar parashikojnë masa korrigjuese dhe administrative me qëllim parandalimin, korrigjimin apo ndërprerjen e rrethanave e veprimeve që përbëjnë shkelje të dispozitave ligjore ose akteve të Autoritetit.

Edhe gjatë 2017 masat e marra nga Autoriteti janë bazuar në inspektimet në vend, kontrollin mbi dokumenta dhe verifikim të informacionit. Kështu në mbështetje të inspektimeve të kryera në 2017, Bordi i AMF-së në mbledhjen e muajit maj 2017, vendosi marrjen e masave ndaj shoqërisë “*Stock International Albania*”, si dhe depozitim në AMF të informacionit në lidhje me njoftimin e të gjithë klientëve të tij mbi ndërprerjen e aktivitetit dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë dhe Këshillit Mbikëqyrës për situatën e shoqërisë. Autoriteti kërkoi respektimin e të gjitha afateve dhe procedurave ligjore, me qëllim dhënien kohë shoqërisë për të njoftuar të gjithë investitorët dhe klientët e saj për mbylljen e aktivitetit. Shoqëria “*Stock International Albania*” sh.a. nuk i përmbushi detyrimet e saj të lëna nga vendimi i Bordit të AMF-së në muajin maj 2017. Për rrjedhojë, Bordi i AMF-së, me Vendimin nr. 81, në mbledhjen e datës 19 qershor 2017 vendosi heqjen e licencave për shoqërinë “*Stock International Albania*” sh.a.

Gjatë 2017, Bordi i AMF-së ka vendosur sanksione me gjobë ndaj shoqërisë “*Stock International Albania*”, si dhe ndaj administratorit të shoqërisë “*Kapital Invest*”.

Tabelë 14: Masat sanksion me gjobë të marra nga AMF në tregun e titujve për vitin 2017
(në numër)

Sanksion me gjobë ndaj shoqërive që operojnë në tregun e titujve	Sanksion me gjobë ndaj personave përgjegjës
1	1

Tabelë 15: Masat mbikëqyrëse të marra nga AMF në tregun e titujve për vitin 2017
(në numër)

Plan masash për eliminimin shkeljesh	Heqje të drejte për ushtrim veprimtarie/licence
1	2

Kapitulli 3. Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve

3.1 Struktura e Tregut të Sigurimeve

Në vitin 2017 në total tregu, volumi i primeve të shkruara bruto nga shoqëritë e sigurimit rezultoi 16,197 milion lekë (121 milionë Euro), me një rritje prej 828,6 milion lekë ose 5.39% më shumë se një vit më parë.


Në këtë volum primesh 14,911 milion lekë ose 92.06 e totalit të primeve i përket tregut të Jo-Jetës dhe 1,205 milion lekë ose 7.44% tregut të Jetës.

Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës shënoi një rritje në masën 4.22% dhe volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës shënoi një rritje në masën 23.19% krahasuar me vitin 2016.


Pra, tregu ka ruajtur të njëjtin konfigurim në vite, ku sigurimet e Jetës kanë një volum primesh të ulët krahasuar me ato të Jo-Jetës.

Grafik 6: Primi i shkruar bruto, sipas llojit të sigurimit Jo-Jetë dhe Jetë, viti 2017

(në mln. lekë)



Grafik 7: Ndarja e primit të shkruar bruto sipas linjës biznesit të Jo-Jetës për vitin 2017
(në %)




Sigurimi i detyrueshëm motorrik zë 67% të tregut të Jo-Jetës me një volum primesh 9,964 milion lekë dhe me një rritje prej 4.82% krahasuar me një vit më parë.


Sipas grafikut të mësipërm vendin e dytë në ndarjen e tregut e zë portofoli “Zjarri e dëmtime në pronë” me një volum primesh 1,922 milionë lekë ose me një rritje në volum primesh prej 2.93%.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e aksidenteve dhe shëndetit në vitin 2017 arritën 1,190 milionë lekë ose 3.80% më shumë se një vit më parë.


Grafik 8: Ndarja e tregut - Sigurimi i Jo-Jetës për vitin 2017



Grafik 9: Ndarja e primit të shkruar bruto sipas linjës së biznesit të Jetës për vitin 2017
(në %)




Grafik 10: Primi i shkruar bruto sipas linjës së biznesit të Jo-Jetës për vitin 2017
(në mln. lekë)



Në volumin e primeve të shkruara bruto të sigurimit të Jetës pjesën më të madhe e zë sigurimi Jetë Debitori me 723 milionë lekë ose 38.62% më shumë se një vit më parë.


Grafik 11: Primi i shkruar bruto sipas linjës së biznesit të Jetës për vitin 2017
(në mln. lekë)



Tabelë 16: Volumi i primeve nga vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore në 2016

Vendete Qendrore Lindore	Evropës dhe	Primi i Shkruar Bruto (Mln. Euro)	Primi i Shkruar Bruto / GDP (në %)	Primi i Shkruar Bruto/Frymë (në Euro)	Raporti i primit të sigurimit të Jetës ndaj totalit të tregut
Bosnje Hercegovina		324	2.16	84.12	20.40
Bullgari		1,048	2.21	147.38	20.90
Estoni		388	1.86	295.74	22.07
Hungari		2,849	2.50	289.65	49.53
Kosovë		81	1.34	45.64	3.21
Kroaci		1,159	2.55	277.96	33.31
Letoni		532	2.13	270.37	23.25
Lituani		710	1.84	247.24	34.75
Mal i Zi		80	2.15	128.64	17.10
Maqedoni		142	1.44	68.43	14.80
Poloni		12,667	3.04	333.63	42.57
Republika Ceke		4,386	2.51	415.55	22.35
Rumani		2,090	1.24	105.79	17.79
Serbi		722	2.12	102.82	25.94
Shqipëri		112	1.04	38.89	6.46
Sllovaki		1,987	2.45	366.25	49.32
Slloveni		2,033	5.11	985.15	28.33
Totali		31,310	2.50	258.2	35.36


Grafik 12: Primi i shkruar bruto/GDP për vitin 2016 (në %)




Dëme të paguara bruto

Totali i dëmeve të paguara bruto në vitin 2017 në tregun e sigurimeve kapi shifrën 5,534 milionë lekë (41 milionë Euro), e cila është 774 milionë lekë ose 16.25% më shumë se në vitin 2016.

Grafik 13: Ndarja e dëmeve të paguara bruto sipas linjës së biznesit, viti 2017



Grafik 14: Dëme të paguara bruto sipas linjës së biznesit, viti 2017



3.2 Pozicioni Financiar

Në zbatim të kuadrit rregullator ekzistues, AMF ka mbikëqyrur dhe analizuar tregun e sigurimeve, duke vlerësuar pozicionin financiar, rezultatet dhe treguesit teknikë të veprimtarisë së shoqërive të sigurimit gjatë vitit 2017. AMF ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e kërkesave ligjore mbi fondin e garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij.

Fondi i Garancisë

Fondi i garancisë është një shumë në mjete monetare (vlera e së cilës është përcaktuar në nenin 81 të Ligjit nr. 52/2014) e depozituar nga shoqëria e sigurimit ose e risigurimit në një llogari bankare qëllimore me të njëjtin emër, në bankat në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku shoqëria ka selinë qendrore të saj, e detyrueshme për t'u disponuar nga siguruesi që nga çasti i fillimit të veprimtarisë dhe në vazhdim. Shoqëritë e sigurimit zotërojnë fondin e garancisë të investuar në “depozita qëllimore” me afat 1-vjeçar pranë bankave të nivelit të dytë dhe në bono thesari. Fondi i Garancisë në nivel tregu për 11 shoqëri sigurimi dhe një shoqëri risigurimi duhet të jetë 4,440 milionë lekë.

Në 31.12.2017 Fondi i Garancisë së shoqërive të sigurimit, në nivel tregu është investuar në depozita me afat maturimi jo më pak se 1 vit pranë bankave tregtare si dhe në letra me vlerë.

Nga shqyrtimi i të dhënave të raportimeve financiare të 31.12.2017, të pasqyruara në tabelat e mëposhtme, konstatohet se:

Aktivet e tregut të sigurimeve të vitit 2017 krahasuar me 31.12.2016, u rritën me 1,169 milionë lekë ose 3.97%. Kjo rritje vjen vetëm nga sektori i sigurimit Jo-Jetë, i cili u rrit me 1,066 milionë lekë ose 4.07%, ndërsa sektori i Jetës u rrit me 103 milionë lekë ose 3.1%.

Tabelë 17 : Të dhëna financiare për tregun e sigurimeve

(në mln. lekë)

Periudha Ushtrimore	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Totali i aktiveve	20,343	21,839	24,451	27,610	29,422	30,591
Jeta	3,207	3,788	4,009	3,857	3,287	3,390
Jo-Jeta	17,136	18,051	20,442	23,752	26,135	27,201
Totali i investimeve	13,692	14,082	15,721	18,996	18,811	19,057
Jeta	2,748	2,971	2,684	2,904	2,743	2,862
Jo-Jeta	11,334	12,750	15,175	16,092	16,068	16,195
Provigjonet teknike bruto	8,317	9,650	11,191	14,014	15,568	15,840
Jeta	1,175	1,522	1,529	1,605	1,690	1,702
Jo-Jeta	8,475	9,669	11,486	12,409	13,878	14,138
Totali i kapitaleve veta	10,005	9,173	9,954	10,204	9,688	9,441
Jeta	1,899	2,195	1,988	1,782	1,503	1,560
Jo-Jeta	8,105	6,978	7,966	8,421	8,185	7,881
Totali i kapitalit të nënshkruar	8,247	8,652	8,152	8,190	7,708	6,953
Jeta	1,351	1,355	1,217	1,221	1,221	1,221
Jo-Jeta	7,301	6,797	7,339	6,969	6,487	5,732

Investimet dominuan totalin e aktiveve të shoqërive të sigurimit dhe u përqëndruan në depozita në institucione krediti (banka), bono thesari dhe obligacione. Depozitat zënë peshën kryesore me 32.78%, duke u ndjekur nga toka dhe ndërtesa me 9.88% dhe bono thesari dhe obligacione me 8.33%.

Kapitalet e veta të shoqërive të sigurimit në 2017 pësuan rënie me 6.48% krahasuar me 31.12.2016 si rrjedhojë e mbajtjes së fitimit të periudhës, rritjes së rezervave të rivlerësimit të kapitalit, si dhe shtesës së kapitalit themeltar.

Tabelë 18: Struktura dhe dinamika e aktivitetit dhe pasivitetit të tregut të sigurimeve⁶

Emërtimi	31.12.2014	31.12.2015	31.12.2016	31.12.2017
<i>struktura (në %)</i>				
Depozita	36.26	36.00	29.39	31.55
Toka dhe ndërtime	7.93	7.21	6.76	9.88
Aksione dhe pjesëmarrje	10.92	11.18	17.26	9.15
Bono thesari dhe obligacione	10.85	11.52	9.50	11.72
Debitorë	8.88	7.93	9.32	12.50
Aktive të tjera	25.16	26.16	27.76	25.21
Totali i Aktivitetit	100.00	100.00	100.00	100.00
Provizjonet teknike bruto	45.16	50.76	48.63	51.78
Detyrime të tjera	13.32	12.28	14.20	17.36
Kapitalet e veta	41.62	36.96	37.17	30.86
Totali i Pasivitetit	100.00	100.00	100.00	100.00
Emërtimi	31.12.2014	31.12.2015	31.12.2016	31.12.2017
<i>dinamika (në %) viti i mëparshëm = 100</i>				
Depozita	107.20	110.43	94.67	102.55
Toka dhe ndërtime	95.82	101.08	108.84	139.54
Aksione dhe pjesëmarrje	100.84	131.82	179.02	95.44
Bono thesari dhe obligacione	163.63	118.19	95.64	117.87
Debitorë	97.21	99.35	136.27	128.10
Aktive të tjera	121.09	115.68	123.04	86.76

⁶ Pasqyrat e bilancit në këtë tabelë përfshijnë shoqëritë e sigurimeve të Jo-Jetës dhe Jetës. Raportimi i pasqyrave financiare të shoqërive të sigurimit bëhet sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe mbështetur në bazën ligjore të AMF-së.

Totali i Aktivit	111.76	112.92	115.95	103.97
Provizjonet teknike bruto	122.16	125.30	111.08	101.75
Detyrime të tjera	111.25	102.58	134.07	116.79
Kapitalet e veta	102.47	102.45	116.62	101.42
Totali i Pasivit	111.76	112.92	115.95	103.97

Testet e Paralajmërimit të Hershëm

Testet e Paralajmërimit të Hershëm

Testet e Paralajmërimit të Hershëm (*Early Warning Tests*) konsistojnë në një sërë treguesish financiarë, të cilët konsiderohen si tregues kyç të sinjalizimit për fillimin e dobësimit financiar tek shoqëritë e sigurimit. Testet e Paralajmërimit të Hershëm u zhvilluan nga Shoqata Kombëtare e Komisionerëve të Sigurimeve të SHBA (NAIC) në fillim të viteve 1970, bazuar në rezultatet financiare të disa mijëra siguruesve dhe qindra paaftësive paguese të siguruesve që ndodhën në një periudhë mbi 50-vjeçare. NAIC përcaktoi “diapazonet normale” në mënyrë empirike në të gjithë gamën e gjerë të shoqërive dhe ngjarjeve gjatë një periudhe të konsiderueshme dhe meqenëse biznesi i sigurimeve është në thelb i njëjtë në çdo juridiksion, është e vështirë që të imagjinohet që këto diapazone të mos jenë të zbatueshme dhe në juridiksione të tjera. Ky njihet si i vetmi studim në shkallë të gjerë për raportet e sigurimeve që është kryer mbi një bazë të rëndësishme statistikore.

Qëllimi i këtyre testeve është që duke vepruar si tregues të paralajmërimit të hershëm, të ndihmojnë mbikëqyrësin në vendosjen e përparësive për alokimin e burimeve në monitorimin e shoqërive të sigurimeve. Pavarësisht disa kufizimeve dhe paralajmërimeve, raportet janë pranuar në mënyrë ndërkombëtare nga mbikëqyrësit në të gjithë botën, pasi është konstatuar se ato japin një kontribut mjaft të dobishëm për matjen e rrezikut të shoqërisë së sigurimit.


Në tabelën e mëposhtme paraqiten disa nga Testet e Paralajmërimit të Hershëm më të rëndësishëm për tregun shqiptar të sigurimeve, për periudhën 2012-2017.

Tabelë 19: Teste të paralajmërimit të hershëm për tregun e sigurimeve Jo-Jetë
(në %)

(shprehur në %)	2012		2013		2014		2015		2016		2017	
Raporti Dëme/Prime	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>
	31.4	20.1	42.8	15.5	35.8	16.8	38.8	16.9	29.7	23.6	31.1	13.8
	<i>Diapazona: 50 - 80</i>											
Raporti i Shpenzimeve	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>
	68.9	59.7	72.9	62.7	65.7	51.5	62.1	57.6	66.9	67.1	64.5	69.8
	<i>Diapazona: 25 - 50</i>											
Raporti i Kombinuar	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>
	100.3	80.4	115.7	78.2	101.4	68.3	100.8	74.5	96.6	90.7	95.6	83.6
	<i>Diapazona: 85 - 105</i>											
Raporti i Mbajtjes	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>
	86.7	95.6	72.4	96.9	78.1	97.1	78.6	97.3	81.1	96.3	79.4	96.6
	<i>Diapazona: 40 - 80</i>											
ROE	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>	<i>Jo Jetë</i>	<i>Jetë</i>
	4.9	10.4	-5.9	9.7	6.7	6.9	4.4	13.2	5.1	5.1	9.6	11.7
	<i>Diapazona: mbi 6.5</i>											

Raporti dëme/prime (shpenzime neto për dëme të paguara/prime të fituara neto), në 2017 për tregun e sigurimit të Jo-Jetës ishte 31.1%, duke pësuar një rritje të lehtë në krahasim me fundin e vitit 2016, ndërsa për tregun e Jetës ishte 13.8%, Ky raport vazhdon të jetë nën nivelin e poshtëm të “diapazonës normale” që është 50%. Për tregun e Jetës ky raport ka një rënie të ndjeshme, pasi primet e fituara neto kanë shënuar një rritje të konsiderueshme dhe nga ana tjetër shpenzimet neto për dëmet e paguara kanë patur të njëjtën ecure. Kjo tendencë për periudhën 2012–2017, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:


Grafik 15: Dëmet e paguara/primet e fituara neto



Raporti i shpenzimeve (Shpenzime operative neto të veprimtarisë/Prime të fituara neto) në 2017 për tregun e sigurimit Jo-Jetë ishte 64.5%, dhe tregun e sigurimit të Jetës 69.8%. Ky raport, megjithëse ka patur një tendencë në rënie gjatë kësaj periudhe, përsëri është mbi nivelin e sipërm të “diapazonës normale”, që rekomandon një raport maksimal deri në 50%. Ky raport për tregun e sigurimit Jo-Jetë ka një rënie krahasuar me fundvitin 2016 (66.9%), ndërsa për tregun e sigurimit të Jetës ky raport ka një rritje, në krahasim me fundvitin 2016 (67.1%), si pasojë e rritjes së shpenzimeve administrative me një ritëm më të lartë se primet e fituara neto.


Nga 1 janari 2017, bazuar në ndryshimet në Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 12, datë 04.04.2017, taksa kombëtare mbi primet e shkruara, e cila aplikohet mbi primet e shkruara për aktivitetin e Jo-Jetës, përjashtuar produktet e Kartonit Jeshil dhe Shëndetit në Udhëtim, nuk është më pjesë e primeve të shkruara dhe për rrjedhojë nuk është pjesë e shpenzimeve. Kjo tendencë për periudhën 2012–2017, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Grafik 16: Shpenzimet neto të veprimtarisë/primet e fituara neto




Raporti i kombinuar (Raporti dëme/prime + Raporti i shpenzimeve) në 2017 për tregun e sigurimit të Jo-Jetës është në masën 95.6%, ndërsa për tregun e Jetës është 83.6%. Edhe pse ky tregues mbetet nën 100% duke rezultuar brenda “diapazonës normale”, nuk nënkupton domosdoshmërisht që performanca financiare e tregut të sigurimeve është optimale, pasi komponenti përbërës i raportit të dëmeve është nën nivelin e poshtëm të “diapazonës normale”, ndërkohë që komponenti i shpenzimeve rezulton mbi nivelin e sipërm të “diapazonës”, çka do të thotë se këto shpenzime nuk menaxhohen në mënyrë efikase. Në kushtet e administrimit efektiv të shpenzimeve, do të pritej që ky tregues të ishte nën limitin e poshtëm të “diapazonës”, duke nënvizuar si shkak primar rritjen e nivelit të pagesës së dëmeve dhe uljen e nivelit të shpenzimeve. Kjo tendencë për periudhën 2012–2017, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Grafik 17: Raporti i kombinuar




Raporti i mbajtjes për tregun shqiptar të sigurimeve Jo-Jetë është në masën 78.9%, duke arritur pothuajse limitin e sipërm të diapazonës, duke dëshmuar kështu se shoqëritë e sigurimit mbajnë vetë masën më të konsiderueshme të riskut, duke mos ceduar mjaftueshëm në risigurim. Nëse nuk do të ishte për dy shoqëri sigurimi, të cilat zotërojnë një pjesëmarrje të konsiderueshme në treg dhe që kanë patur një raport të ulët mbajtjeje për produktin MTPL, për arsye të politikave të tyre të cedimit në risigurim, ky raport për tregun e sigurimit Jo-Jetë do të tejkalonte nivelin e sipërm të “diapazonës normale”. Për tregun e Jetës, raporti i mbajtjes është 96.4%, duke tejkaluar nivelin e sipërm të “diapazonës”. Kjo tendencë për periudhën 2012–2017, paraqitet në grafikun e mëposhtëm.

Grafik 18: Raporti i mbajtjes së primit



ROE për tregun e sigurimit të Jo-Jetës në 2017 paraqitet në nivel të favorshëm prej 9.6%, ndërsa për tregun e Jetës është 11.7%. Shoqëritë e sigurimit Jetë dhe Jo-Jetë kanë performuar mbi këtë mesatare gjatë kësaj periudhe të vitit 2017. Arsyet kryesore janë rezultatet teknike pozitive si dhe kthimet nga investimet për shoqëritë që zotërojnë pjesëmarrje. Kthimi mesatar i kapitalit gjatë 5 viteve të fundit për shoqëritë e sigurimit është 6.48%. Kjo tendencë për periudhën 2012–2017, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Grafik 19: ROE



3.3 Inspektimi në shoqëritë e sigurimeve sipas mbikëqyrjes me fokus rrezikun

Inspektime të plota me fokus rrezikun

Në vazhdimësi edhe gjatë vitit 2017, Autoriteti vijoi me inspektimin e plotë në vend në tre shoqëri sigurimi të Jo-Jetës sipas metodologjisë me fokus rrezikun, bazuar në Manualin e Mbikëqyrjes së Shoqërive të Sigurimit. Inspektimi u përqëndrua në strukturimin e procedurave të inspektimit dhe hartimin e planit të intervistave me nivelet e drejtimit të shoqërive të sigurimit. Gjithashtu u vlerësuan rreziqet e pranishme sipas aktiviteteve të biznesit në shoqëritë e inspektuara, si dhe administrimi dhe mitigimi i këtyre rreziqeve nga drejtuesit e lartë të shoqërisë.

Në mënyrë më të detajuar këto inspektime u përqëndruan në:

- Vlerësimin e riskut të kreditit në marrëdhënie me risiguruesit, mbledhjen e primeve dhe aktivitete të tjera të lidhura me to;
- Vlerësimin e riskut të sigurimit, duke u fokusuar kryesisht tek marrja në sigurim dhe rreziqet e përgjegjësi, si dhe aktivitete të tjera të lidhura me to;

- Vlerësimin e rrezikut operacional, duke u fokusuar tek provigjonet, vlerësimi i dëmeve, procedurat e trajtimit të dëmeve, sistemet e teknologjisë së informacionit, performanca operationale, si edhe aktivitete të tjera të lidhura me to;
- Vlerësimin e rrezikut rregullator dhe strategjik në drejtim të vlerësimit të Fondit të Garancisë;
- Vlerësimin e fuqisë së kapitalit dhe cilësisë së fitimeve;
- Vlerësimin e elementëve të veçantë të aktiveve të pasqyrave financiare të shoqërisë;
- Menaxhimin e rrezikut, sistemet e kontrollit të brendshëm, përfshirë edhe mbikëqyrjen e veprimtarisë nga nivelet drejtuese të shoqërisë.

Në përfundim të inspektimeve, Autoriteti hartoi profilin e rrezikut për shoqëritë e inspektuara, i cili përfaqëson vlerësimin e tij për secilin nga rreziqet e shoqërisë brenda kontekstit të tregut të sigurimeve në përgjithësi. Inspektimi sipas metodologjisë me fokus rrezikun përqëndrohet në përgjegjësitë e këshillit mbikëqyrës dhe menaxhimit të lartë të shoqërisë së sigurimit në drejtim të ruajtjes së sigurisë dhe stabilitetit financiar të shoqërisë.

Inspektime Tematike

Gjatë vitit 2017 janë kryer tre inspektime tematike në shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë, me objekt: verifikimin e dëmeve të ndodhura, shpenzimeve të marrjes në sigurim, shpenzimeve për sponsorizime dhe reklama, si edhe verifikimin e policave kufitare të shitura jashtë sistemit të raportimit të shitjeve *online*.

Gjithashtu, gjatë vitit 2017 janë kryer edhe dy inspektime tematike pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit, si dhe një inspektim në secilën nga shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë me fokus dëmet objekt i Fondit të Kompensimit. Këto inspektime kanë konsistuar në çështjet më thelbësore që kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave të dëmeve sipas kërkesave rregullatore, kontrollin e dokumentacionit fizik për dëmet me vlera të larta në BSHS, përputhshmërinë e tyre me të dhënat e raportuara, vlerësimin e sigurisë dhe vlefshmërisë së programeve informatike të përdorura nga BSHS për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave, ndjekjes së padive të regresit, si dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga inspektimet e mëparshme të Autoritetit.

Inspektime të përbashkëta:

- Inspektim në bashkëpunim Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave

AMF bazuar në Manualin e Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave miratuar me Vendim Bordi nr. 136, datë 29.09.2016, ka kryer gjatë vitit 2017 inspektim të përbashkët me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave në një shoqëri risigurimi, objekt i ligjit të parandalimit të pastrimit të parave.

Fokusi i inspektimit ishin verifikimet lidhur me respektimin e kuadrit ligjor në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe masat kundër financimit të terrorizmit. Nga ky inspektim nuk u konstatuan kundravajtje administrative nga ana e shoqërisë së risigurimit.

- Inspektim i përbashkët me Bankën Qendrore të Kosovës (BQK)

Në kuadër të Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis AMF dhe BQK-së, me qëllim mbikëqyrjen efektive të grupeve të sigurimit që ushtrojnë aktivitet në të dyja vendet Shqipëri dhe Kosovë, gjatë vitit 2017, përfaqësues të AMF-së morën pjesë në një inspektim të përbashkët me BQK-në pranë shoqërive të sigurimit që veprojnë në Kosovë, pjesë e grupeve të sigurimit me qendër në Shqipëri.

Një bashkëpunim i tillë i realizuar edhe në vitet e kaluara ndikon pozitivisht në efektivitetin e mbikëqyrjes dhe rregullimin e industrisë së sigurimeve të të dy vendeve, sidomos në kushtet e shtrirjes së veprimtarisë së shoqërive shqiptare të sigurimit në territorin e Kosovës.

3.4 Provigjonet Teknike

Në kuadrin e analizës së shëndetit financiar të shoqërive të sigurimit, AMF vlerëson nëse provigjonet teknike janë të mjaftueshme dhe në përputhje me nivelin e rrezikut të kontraktuar nga shoqëritë. Mjaftueshmëria e provigjoneve teknike, vlerësohet në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe mospërmbushja e këtij detyrimi përbën shkelje të rregullave të menaxhimit të rrezikut.

Ecuria në nivel tregu e provigjoneve teknike ndër vite shfaq një tendencë në rritje duke ruajtur dhe strukturën e aktivitetit Jetë dhe Jo-Jetë. Kështu në vazhdimësi, peshën më të lartë nga pikëpamja e veprimtarisë së ushtruar e mbajnë provigjonet teknike bruto të shoqërive të Jo-Jetës, e cila reflekton edhe strukturën e tregut të sigurimeve në Shqipëri.

Provigjoni Teknik


Provigjoni teknik është shuma e llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas mënyrave aktuariale të caktuara, e cila mbahet nga siguroesi, për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit.

Provigjonet teknike përfshijnë:

- Provigjonet për prime, të cilat përbëhen nga provigjonet për primet e pafituara dhe për rreziqe të paskaduara. Këto provigjone krijohen në përpjesëtim me primet e shkruara që lidhen me mbulimet e sigurimit, të cilat janë ende të vlefshme pas përfundimit të periudhës financiare gjatë së cilës janë krijuar këto provigjone;
- Provigjonet për bonuse dhe rabate, të cilat krijohen në nivel të njëjtë me shumën e pagesave që merr i siguruari bazuar në të drejtën për përfitimet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, të drejtën për reduktim të pjesshëm të primit të sigurimit (rabat) si dhe të drejtën e rimbursimit të një pjese të primit të sigurimit në rast të përfundimit të parakohshëm të kontratës së sigurimit;
- Provigjonet teknike të dëmeve, të cilat krijohen në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit para përfundimit të periudhës së sigurimit të kontratës së sigurimit dhe vlerësimi i tyre bëhet në nivel të njëjtë me përgjegjësitë e marra përsipër nga shoqëria e sigurimit nëpërmjet kontratës së sigurimit;
- Provigjone për mbrojtjen për rrezikun ndaj investimit;
- Provigjone të tjera teknike. Këto provigjone krijohen nga shoqëritë e sigurimit me qëllim për të mbuluar përgjegjësitë e pritshme dhe rreziqet për dëme të mëdha, të cilat rrjedhin nga sigurimi i përgjegjësisë për humbje nga rreziqe bërthamore, përgjegjësinë e prodhuesit të produkteve farmaceutike si dhe rreziqet e përmbytjes dhe tërmetit.

Nga të dhënat në nivel tregu, të pasqyruara në grafikun e mëposhtëm, vihet re tendenca në rritje e treguesit të provigjionit teknik të dëmeve dhe primeve, duke reflektuar përpjekjet e vazhdueshme të Autoriteti në drejtim të përmirësimit të këtij treguesi. Veçanërisht, AMF në vazhdimësi ka dhënë rekomandime për përmirësimin në rritje të treguesit të provigjionit teknik të dëmeve nga sigurimi i detyrueshëm në përputhje me rritjen e aktivitetit të tregut të sigurimeve. Këto rekomandime janë bazuar në analizat e të dhënave të shoqërive të sigurimit, në gjetjet e konstatuara gjatë inspektimeve në vend, si dhe nga informacioni i marrë nga palë të treta (gjykatat, për dëmet në proces gjyqësor) lidhur me detyrimet dhe rrezikun ndaj të cilit janë të ekspozuara shoqëritë.

Grafik 20: Provigjoni teknik bruto



Provigjoni Teknik Bruto për sigurimin e detyrueshëm motorik (MTPL)

Provigjoni teknik bruto për produktin e MTPL-së zë peshën specifike më të lartë në totalin e provigjoneve teknike të tregut të Jo-Jetës. Për 31.12.2017 ky tregues ka vijuar të jetë në nivele pothuajse të pandryshuara krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në 69 % kundrejt 70% që rezultoi në fund të vitit 2016. Struktura e provigjoneve teknike reflekton dhe strukturën e tregut të sigurimeve të Jo-Jetës, me një përqëndrim të lartë në sigurimin e detyrueshëm.

Tabelë 20: Peshë e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm

(Në mijë lekë)

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
<i>Pesha e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm</i>							
Provigjone bruto total MTPL	4,594,762	4,903,000	5,876,000	7,606,407	8,259,209	9,757,238	9,823,894
Provigjone bruto total Jo-Jeta							
	6,781,384	7,375,000	7,980,000	9,662,572	12,409,665	13,866,272	14,137,852
Pesha specifike (në %) e sigurimeve të detyrueshme kundrejt totalit për tregun	68%	66%	74%	79%	67%	70%	69%
<i>Struktura e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm</i>	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Provigjoni teknik për dëmet MTPL	62%	56%	52%	53%	52%	52%	52%
Provigjoni i Primit të pafituar MTPL	38%	44%	48%	47%	48%	48%	48%
Provigjone bruto total MTPL	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Gjithashtu përse i përket strukturës së provigjonit teknik të sigurimit të detyrueshëm në vazhdimësi vërehet që peshën më të lartë e mban provigjoni teknik i dëmeve në krahasim me provigjone të primit të pafituar. Edhe gjatë vitit 2017 është ruajtur e njëjta strukturë ndarjeje megjithë reflektimin e luhatjes të tarifave të shitjes së produkteve të sigurimit të detyrueshëm, tregues i cili shfaq efektin e vet tek provigjoni i primit të pafituar.

Primet e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik

Primi i rrezikut

Në kuadrin e projektit të Bankës Botërore *First Initiative*, lidhur me liberalizimin e tarifave të sigurimit të detyrueshëm motorik, shoqëritë e sigurimit janë njohur dhe kanë pranuar modelin e llogaritjes së primit të rrezikut për kontratën e sigurimit të detyrueshëm motorik TPL, metodologji e cila është përshtatur dhe përdorur edhe në vlerësimin e primit të rrezikut për kontratën e sigurimit të Kartonit Jeshil dhe atë Kufitar.

Bazuar në kërkesat e kësaj metodologjie, ku elementët kryesorë për përcaktimin e primit të rrezikut, janë frekuenca dhe kostoja mesatare e dëmeve, shoqëritë e sigurimit marrin në konsideratë inflacionin e dëmit ndër vite si dhe bëjnë projeksionin e tij për periudhat e ardhshme financiare, element ky i rëndësishëm në përcaktimin e një vlere sa më të saktë të primit të rrezikut të ardhshëm.

Autoriteti, mbi bazën e të dhënave të shoqërive të sigurimit, llogarit primin e rrezikut në nivel tregu për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik brenda datës 31 mars të çdo viti pasardhës. Ky prim është orientues për tregun e sigurimit lidhur me vlerësimin e primit të rrezikut që do të kryejnë vetë shoqëritë e sigurimit.

Në terma konkretë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016, vihet re një ulje me rreth 10% të primit të rrezikut në nivel tregu për portofolin TPL e brendshme (e llogaritur si mesatare e ponderuar e të gjitha kategorive të TPL-së).

Primi mesatar i sigurimit

Primi i paguar nga të siguruarit përfshin primin e rrezikut, pjesën e llogaritur për mbulimin e shpenzimeve të marrjes në sigurim dhe shpenzimeve administrative, përfshirë dhe komisionet, si dhe pjesën e llogaritur për fitimin e shoqërisë së sigurimit.

Primi mesatar i paguar nga të siguruarit për kategoritë kryesore është i pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 21: Primi mesatar i paguar për motoçikleta, autovetura, furgonë për periudhën janar–dhjetor 2017

(në lekë)

Viti/Kategoria	A1/1	A1/2	B1/1	B1/2	B2/1	B2/2
2015	5,640	8,550	15,100	15,850	24,500	29,050
2016	6,150	9,210	16,330	17,120	26,500	31,440
2017	6,040	9,280	16,050	16,880	26,260	30,550

Primi mesatar i paguar nga të sigurvearit për kategoritë kryesore të mjeteve motorike ka pësuar një ulje afërsisht me 1.6% për periudhën janar- dhjetor 2017, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Risigurimet

Bazuar në kuadrin ligjor dhe aktet rregullatore të miratuara nga Autoriteti, shoqëria e sigurimit është e detyruar të risigurojë në një shoqëri risigurimi atë pjesë të rrezikut të sigurvear që tejkalon limitin e lejuar prej 10% të vlerës së kapitalit.

Për produkte dhe raste të veçanta sigurimi, shoqëritë e sigurimit kanë kryer transferim të rrezikut, me anë të kontratave të risigurimit fakultativ, për të zbutur efektet financiare të dëmeve të mëdha dhe ato të mundshme.

Risigurimi fakultativ

Risigurimi fakultativ nënkupton transferimin e një pjese të një rreziku të veçantë të sigurvear nga shoqëria e sigurimit te shoqëria e risigurimit, sipas një kontrate të veçantë të risigurimit.

Strategjia e ndjekur nga tregu i sigurimit për transferimin e rrezikut, në përgjithësi, është realizuar nëpërmjet bashkësigurimit (kalimit të një pjese të rrezikut të kontratës së sigurimit në një kompani tjetër sigurimi), kalimit në risigurim të portofoleve të sigurimit si dhe mbulimit me risigurim fakultativ të kontratave të veçanta.

Në bazë të kërkesave rregullatore, shoqëritë e sigurimit, raportojnë në Autoritet programin e risigurimit. Bazuar në funksionin e saj mbikëqyrës, AMF ndjek ecurinë e zbatimit të këtij programi dhe kontratave specifike të lidhura, duke synuar të sigurojë stabilitetin e vazhdueshëm financiar në lidhje me standardet e mbajtjes së rrezikut nga këto shoqëri risigurimi dhe kritereve të lidhura me cilësinë e risigurveave.

Marrëveshjet risigurvease në portofolet e sigurimit të Jo-Jetës kanë qenë të formës jo proporcionale, kryesisht të tipit *Excess of Loss* (Tejkalim humbjeje) dhe të formës proporcionale, të tipit *Quota Share Surplus*. Në sigurimin e Jetës, mbulimi me risigurim është kryer nëpërmjet marrëveshjeve risigurvease të formës proporcionale të tipit *Surplus* dhe të tipit *Quota Share*.


Primet e ceduara në risigurim për 31.12.2017 rezultojnë:

- Për totalin e tregut të sigurimeve në vlerën prej 3,07 miliardë lekë ose sa 19.39% e vlerës së primeve të shkruara bruto në nivel tregu;
- Për sigurimin e Jo-Jetës në vlerën prej 3.04 miliardë lekë ose sa 21.58% e vlerës së primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jo-Jetës;
- Për sigurimin e Jetës në vlerën prej 35,66 milionë lekë ose sa 2.01% e vlerës së primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jetës.


Vlera e primeve të ceduara në risigurim krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016:

- Në nivel tregu, është rritur me rreth 319,94 milionë lekë ose 11.62%;
- Për sigurimin e Jo-Jetës, është rritur me rreth 320,12 milionë lekë ose 11.78%;
- Për sigurimin e Jetës, është ulur me rreth 0,18 milionë lekë ose 0.5%.


Grafik 21: Ecuria e primeve të ceduara në risigurim për periudhën 2011–2017




Grafik 22: Primi i ceduar në risigurim/prime të shkruara bruto, total i tregut



Grafik 23: Primi i ceduar në risigurim/prime të shkruara bruto Jo-Jetë



Grafik 24: Primi i ceduar në risigurim/prime të shkruara bruto Jetë



Pjesëmarrësit kryesorë në kontratat e risigurimit, sikurse edhe gjatë viteve të kaluara për sigurimin e Jo-Jetës kanë qenë *VIG Re*, *UNIQA Re*, *Munich Re*, *Hannover Re*, *Swiss Re*, *Partner Re*, *Scor*, *Lloyd's syndicates*, etj. Për sigurimin e Jetës, shoqëria e vetme risiguruese e përfshirë në këtë program është *Scor Global Life*. Më shumë se 90% e partnerëve risigurues të

shoqërive të sigurimit kanë klasifikim më të lartë se BB nga *Standard & Poors*, nga ku mbi 60% kanë klasifikim më të lartë se A.

Raportet e Vetëvlerësimit të rreziqeve (ORSA)

Në zbatim të kërkesave dhe afateve të përcaktuara në Rregulloren nr. 18, datë 28.04.2015 për “Rregullat e organizimit të sistemit të administrimit të rrezikut në shoqërinë e sigurimit”, shoqëritë e sigurimit gjatë vitit 2017 kanë paraqitur raportin vjetor mbi vlerësimin e rreziqeve të shoqërisë. Autoriteti ka analizuar raportet e vetëvlerësimit të shoqërive të sigurimit, ku vëmendje e veçantë i është kushtuar shqyrtimit të:

- Strategjive, me anë të të cilave përcaktohet qasja e shoqërisë së sigurimit për të trajtuar zonat e veçanta të rrezikut dhe detyrimet ligjore e rregullatore;
- Politikave, me anë të të cilave përcaktohen procedurat dhe kërkesat e tjera që janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes, drejtuesit e lartë ekzekutivë, funksionarët kryesorë dhe punonjësit e shoqërisë së sigurimit;
- Proceseve, me anë të të cilave zbatohen strategjitë dhe politikat e shoqërisë së sigurimit; dhe
- Kontrolleve, me anë të të cilave sigurohet që strategjitë, politikat dhe proceset ekzistojnë, mbikëqyren dhe funksionojnë në përmbushje të objektivave.

Në vijim të analizimit të raporteve të vetëvlerësimit, në kuadër të mbikëqyrjes dhe të monitorimit, u bë i mundur nga Autoriteti një vlerësim perspektiv për aftësinë paguese të shoqërive të sigurimit, si dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin në të ardhmen të këtij raporti.

Mbi llogaritjen e mbajtjes neto të mbulimit maksimal agregat të rreziqeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit

Gjatë vitit 2017 me Vendimin e Bordit nr. 57, datë 26.05.2017, është miratuar Rregullorja "Mbi llogaritjen e mbajtjes neto të mbulimit maksimal agregat të rreziqeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit".

Rregullorja përbën një risi në kuadrin mbikëqyrës të Autoritetit dhe nënkupton kërkesa shtesë mbi kapitalin e nevojshëm që duhet të zotërojnë shoqëritë.

3.5 Mbikëqyrja e Grupeve

Gjatë muajit nëntor 2017, përfaqësues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare morën pjesë në takimet e përvitshme të kolegjeve të mbikëqyrjes të grupeve të sigurimeve *UNIQA Insurance Group* (UIG) dhe *Vienna Insurance Group* (VIG), të cilat organizohen nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Austrisë (FMA). Kolegjet e mbikëqyrjes kanë si qëllim shkëmbimin e

informacionit në lidhje me ecurinë e grupeve të sigurimit, në funksion të një mbikëqyrjeje financiare sa më efektive. Përfaqësuesit e AMF-së raportuan gjithashtu pranë FMA-së mbi mbarëvajtjen e veprimtarive të shoqërive të sigurimit, pjesë e grupeve UIG dhe VIG, që ushtrojnë veprimtari në Shqipëri, mbi prezantimin e rreziqeve që karakterizojnë funksionimin e tyre në tregun shqiptar, si dhe sjelljen në vëmendje të çështjeve dhe problematikave të konstatuara, si nga mbikëqyrja në distancë (*off site*), ashtu edhe nga mbikëqyrja në vend (*on site*).

Në muajin korrik 2017, në kuadër të Marrëveshjes së Mirëkuptimit, në ambjentet e AMF-së u zhvillua një takim ndërmjet përfaqësuesve të AMF-së dhe përfaqësuesve të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve të Maqedonisë për të shkëmbyer informacion mbi grupet e sigurimeve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në të dyja vendet. Në fokusin qendror të këtij takimi ishte prezantimi i treguesve financiarë për tregun e sigurimeve në përgjithësi dhe atyre për grupet e sigurimeve që shtrihen në Shqipëri dhe Maqedoni, në veçanti, si dhe diskutimi mbi fenomenet dhe problematikat që shoqërojnë ecurinë e tyre dhe marrjen e masave sa më efektive për eliminimin apo minimizimin e këtyre problematikave.

3.6 Qeverisja e Shoqërive të Sigurimit

Shoqëritë e sigurimit që operojnë në tregun shqiptar janë të organizuara sipas sistemit me një ose me dy nivele qeverisjeje. Në shoqëritë me një nivel qeverisjeje, këshilli i administrimit ushtron funksionet e administrimit e të mbikëqyrjes, ndërsa tek shoqëritë me dy nivele qeverisjeje, këshilli mbikëqyrës ushtron funksione mbikëqyrjeje ndërsa administratori ose bordi i drejtorëve ushtron funksione administrimi.

Gjatë vitit 2017, Autoriteti ka miratuar ndryshime apo riemërime në përbërjen e këshillave mbikëqyrës të pesë shoqërive të sigurimit, si dhe ka miratuar emërime në organet drejtuese të tyre.

Tabelë 22: Të dhëna për aksionarët e shoqërive të sigurimit

Subjekte	Numër	%
Shoqëri sigurimi	11	
Aksionarë gjithsej	35	
<i>Klasifikimi i aksionerëve sipas pjesëmarrjes zotëruese:</i>		100
nën 10%	19	54.29
mbi 10% nën 20%	4	11.43
mbi 20% nën 33 %	2	5.71
mbi 33% nën 50%	1	2.86
mbi 50%	9	25.71
<i>Klasifikimi i aksionerëve sipas vendit të origjinës:</i>		100

Aksionarë të huaj	2	6
Aksionarë vendas	33	94
<i>Klasifikimi i aksionerëve sipas statusit:</i>		<i>100</i>
Aksionarë individë	28	80
Aksionarë shoqëri	7	20

Miratime të ndryshimeve statutore të shoqërive të sigurimit

Gjatë vitit 2017, AMF ka miratuar kërkesat e shoqërive të sigurimit në lidhje me ndryshimet statutore, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabelë 23: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve statutore

(në numër)

Arsyeja e Ndryshimit të Statutit	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Statut i ri/ndryshime të tjera	6	2	6	4	4	2
Rritje kapitali	4	3	5	2	2	1
Ndryshim i strukturës aksionere	2	2	3	3	4	1

3.7 Aktiviteti Licencues

Gjatë vitit 2017, aktiviteti licencues i Autoritetit në tregun e sigurimeve u fokusua në licencimin e veprimtarisë së:

- Ndërmjetësimit në sigurime (brokerim/agjent);
- Vlerësuesit të dëmeve në sigurime.

Në procesin licencues Autoriteti është kujdesur që kërkesat dhe procedurat e zbatuara për subjektet që kërkojnë të ushtrojnë aktivitet në fushën e ndërmjetësimit të jenë të qarta, objektive dhe transparente. Rregullorja nr. 79, datë 31.08.2015 "Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës", si dhe Rregullorja nr. 48, datë 30.06.2015 "Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime", e ndryshuar, vë theksin tek rritja e profesionalizmit dhe integritetit të personave që do të ushtrojnë aktivitetin në ndërmjetësimin e produkteve të sigurimit.

Edhe gjatë vitit 2017, si rezultat i zhvillimeve në tregun e sigurimeve ka vijuar interesi i subjekteve për licencimin në tregun e ndërmjetësimit.

Të dhënat mbi numrin e brokerave të licencuar në sigurime jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 24: Të dhëna mbi brokera të licencuar në sigurime

(në numër)

Statusi i Brokerit	Të licencuar në vitin 2016	Licenca të reja në vitin 2017	Të licencuar në fund të vitit 2017
Shoqëri brokerimi	14	2	16
Broker fizikë	35	1	36

Gjatë vitit 2017 vijoi puna për miratimin e personave fizikë për ushtrimin e veprimtarisë si agentë në sigurime të Jo-Jetës, në bazë të kërkesave të ardhura nga shoqëritë e sigurimeve të jojetës.

Gjatë vitit 2017 u licencuan 224 persona fizikë (agentë) në sigurime, nga të cilët 165 për herë të parë. Ndërkohë në këtë proces u përfshinë edhe 8 subjekte me aktivitete financiar dhe tregtar.

Tabelë 25: Të dhëna mbi agentë të licencuar në sigurime

(në numër)

Statusi i agentit	Të licencuar në fund të vitit 2016	Rinovim licence në 2017	Licenca të reja në 2017	Përfunduar afati i licencës në 2017	Tërheqje licence në 2017	Të licencuar në fund të vitit 2017
Persona juridikë	8	1	7	1	1	14
Person fizikë	334	59	165	121	17	420

Testimet profesionale në fushën e sigurimeve

Në zbatim të kërkesave rregullative, licencimi i profesionit të brokerit në sigurime, apo i vlerësuesit të dëmeve në sigurime është i lidhur me kalimin me sukses të testit për njohuritë profesionale në fushën përkatëse. Gjatë vitit 2017, Autoriteti ka organizuar 2 testime për aplikantët që kërkuan të pajisen me licencën e brokerit në sigurime dhe 2 testime për vlerësuesit e dëmeve. Qëllimi i organizimit të testimeve ka qenë çertifikimi i njohurive profesionale, me synim kryerjen e shërbimeve financiare nga profesionistë që njohin legjislacionin dhe fushën e aktivitetit ku do të operojnë.

3.8 Ndërmjetësit në Sigurime

Veprimtaria e ndërmjetësimit në sigurime ushtrohet nga brokera dhe shoqëri brokerimi, agjentë dhe shoqëri agjentësh.

Brokerimi në sigurime

Në tregun e sigurimeve aktualisht operojnë 13 shoqëri brokerimi dhe 3 banka me veprimtari brokerimi. Nga 13 shoqëritë e brokerimit, 8 prej tyre ushtrojnë veprimtari vetëm në fushën e sigurimit të Jo-Jetës, 3 shoqëri ushtrojnë veprimtari brokerimi në sigurime të Jetës, të Jo-Jetës dhe risigurime, 2 shoqëri dhe 3 banka ushtrojnë veprimtari brokerimi në të dyja fushat e sigurimit të Jetës dhe Jo-Jetës.

Tabelë 25: Shoqëri brokerimi sipas klasave të sigurim

(në numër)

Viti	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë	5	5	4	5	6	8
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë dhe Jetë	1	2	2	2	5	5
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë, Jetë, Risigurime	1	1	2	2	3	3
Totali	7	8	8	9	14	16

Primet e shkruara bruto të sigurimit, të ndërmjetësuara nga shoqëritë e brokerimit rezultojnë në shumën 7,107 milionë lekë për vitin 2017.

Krahasuar me totalin e primeve bruto të shkruara të tregut të sigurimeve, treguesi i ndërmjetësimit nëpërmjet brokerave rezulton në masën 44.11%, duke pësuar një ulje prej 4.63% krahasuar me vitin 2016. Numri i kontratave të sigurimit të ndërmjetësuara nga shoqëritë e brokerimit, për të njëjtën periudhë, përbën 38.51% të numrit të kontratave të sigurimit të të gjithë tregut.

Në totalin e primeve të shkruara bruto të ndërmjetësuara nga shoqëritë e brokerimit, sigurimi i Jo-Jetës zë 92.53% ndërsa sigurimi i Jetës 7.47%. Veprimtaria e brokerimit për produktet e sigurimit të Jo-Jetës është e orientuar nga sigurimi i detyrueshëm motorik.

Mbikëqyrja e veprimtarisë së agjentëve në sigurime

Autoriteti, gjatë vitit 2017 ka ushtruar disa inspektime në vend, pranë pikave të shitjeve të shoqërive të sigurimit, me qëllim mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre gjatë aktivitetit të shitjes së policave të sigurimit.

Nga verifikimi në vënd janë konstatuar edhe raste të shkeljeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, për të cilat Bordi i Autoritetit ka kërkuar marrjen e masave nga shoqëritë e sigurimit, me qëllim mospërsëritjen e shkeljeve që lidhen me shitjet e policave të sigurimit të detyrueshëm.

Gjithashtu janë marrë edhe masa administrative për persona të veçantë për shkelje më të rënda, duke aplikuar pezullimin e licencës për një afat 6-mujor, si dhe në një rast heqje të licencës për të mos ushtruar më veprimtari.

Vlerësuesit e dëmeve në sigurime

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, bazuar në kuadrin rregullator, në dispozitat e Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, licencon vlerësuesit e dëmeve në sigurime.

Gjatë vitit 2017, AMF miratoi 16 licenca të reja për vlerësues të dëmeve në sigurime dhe rinovoi 4 licenca ekzistuese. Të dhëna mbi numrin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime, sipas statusit të vlerësuesit dhe llojit të licencës jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 26: Të dhëna mbi numrin e vlerësuesve të licencuar

(në numër)

Vlerësues dëmsh në sigurime	Të licencuar në fund të vitit 2016	Licencime të reja në 2017	Rinovim licence në 2017	Përfunduar afati i licencës në 2017	Terheqje licence gjatë vitit 2017	Të licencuar në fund të vitit 2017
<i>sipas statusit të vlerësuesit</i>						
I pavarur	41	5	4	4	10	36
I punësuar	34	6	-	4	-	36
Licenca jo-aktive	2	5	-	2	-	5
<i>sipas llojit të licencës</i>						
Për dëme materiale	4	1	-	1	1	3
Për dëme shëndetësore	14	5	1	1	3	16
Për dëme materiale dhe shëndetësore	59	10	3	8	6	58
Vlerësues të licencuar në total	77	16	4	10	10	77

Autoriteti, në vitin 2017, hartoi Rregulloren nr. 85, datë 03.07.2017 “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”.

Kjo rregullore përcakton kërkesat, procedurat, afatet për licencimin dhe rinovimin e licencës së vlerësuesve të dëmeve në sigurime, si person fizik dhe juridik, si dhe rastet dhe procedurat e refuzimit, revokimit dhe pezullimit të licencës së vlerësuesit të dëmeve.

Gjatë vitit 2017, Autoriteti pasi ka përfunduar gjithë procedurën e parashikuar në rregulloren e përmendur sa më sipër, ka revokuar licencën 10 vlerësuesve të pavarur, duke njoftuar dhe Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) mbi këtë këto vendime.

3.9 Byroja Shqiptare e Sigurimeve (BSHS)

Byroja Shqiptare e Sigurimit është person juridik, me seli në Tiranë, e krijuar për qëllime jo fitimprurëse.

Anëtar i Byrosë Shqiptare është çdo shoqëri sigurimi e licencuar për të ushtruar veprimtarinë në sigurimin e detyrueshëm motorik dhe sigurimin e pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik. Byroja është përfaqësuese kombëtare në Këshillin e Byrove dhe është përgjegjëse për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia në sistemin e Kartonit Jeshil.

Mbikëqyrja e Byrosë kryhet nga Autoriteti, i cili përcakton me rregullore të veçantë rregullat dhe standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes. Kompetencat, detyrat e organeve drejtuese të byrosë dhe forma e organizimit të saj përcaktohen në statutin e byrosë, i cili propozohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe miratohet nga Autoriteti.

Referuar dispozitave të nenit 43, të Ligjit nr.10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, një përfaqësues i Autoritetit ka marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së BSHS-së.

Kartoni Jeshil

Sistemi i Kartonit Jeshil

Sistemi i Kartonit Jeshil lehtëson rrjedhën e trafikut rrugor në kalimin e kufijve në Evropë dhe garanton kompensimin e viktimave vendase të aksidenteve të shkaktuara nga automobilistët e huaj.

Ekzistenca e Kartonit Jeshil i ndihmon automobilistët në rast aksidenti në çdo vend të Sistemit të Kartonit Jeshil, sepse mbulimi i tyre në sigurim dhe Kompania e Sigurimit që ka lëshuar policën mund të përcaktohet lehtësisht, dhe si pasojë, pagesa e dëmshpërblimit të palës së dëmtuar mund të bëhet pa ndonjë vonesë.

Nëse ju përfshiheni në një aksident rrugor në vendin tuaj, i cili shkaktohet nga një mjet me targa të huaja, ju mund të zgjidhni kërkesën tuaj për dëmshpërblim nëpërmjet Sistemit të Kartonit Jeshil. Ju mund t'ia drejtoni këtë kërkesë për dëmshpërblim Byrosë Tuaj Kombëtare të Sigurimeve Motorike, e cila do të shlyejë këtë kërkesë në përputhje me ligjin kombëtar në fuqi. Më pas Byroja Kombëtare do t'i drejtohet Siguruesit të automobilistit që është përgjegjës për aksidentin.

Autoriteti ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e detyrimeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, lidhur me zbatimin e Marrëveshjes Uniforme dhe të Rregullores së Brendshme të Këshillit të Byrove.

Shteti shqiptar, nëpërmjet vendimmarrjes së Qeverisë, ka aderuar në këtë Marrëveshje dhe njëkohësisht në zbatim të saj ka pranuar që Byroja Shqiptare të bëhet anëtare e Këshillit të Byrove.

Byroja Shqiptare e Sigurimit në statusin e anëtarit të Këshillit të Byrove ka detyrimin të respektojë Marrëveshjen Uniforme që zbatohet ndërmjet anëtareve. Byroja Shqiptare e Sigurimit ka bërë ndryshime të dukshme duke e rritur ndjeshëm performancën e saj në lidhje me plotësimin e kërkesave financiare që parashikohen për Byronë në fazën e monitorit.

Pas vendosjes në monitorim të Byrosë, AMF ka ndjekur hap pas hapi të gjithë procesin e plotësimit të kushteve të vendosura nga Këshilli i Byrove, si dhe po ndjek në vazhdimësi përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e Kartonit Jeshil.

Gjatë vitit 2017, nuk ka rezultuar asnjë thirrje garancie që lidhet me pagesat e dëmeve të Kartonit Jeshil.

Memorandumi i Mirëkuptimit midis Autoritetit të Bankës Qendrore të Kosovës dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimit

Autoriteti ka ndjekur dhe problematikat e trashëguara gjatë zbatimit të Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur midis Autoritetit të Bankës Qendrore të Kosovës dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimit.

Në funksion dhe në zbatim të lëvizjes së lirë të qytetarëve të dy vendeve, ka hyrë në fuqi që nga viti 2001, Memorandumi i Mirëkuptimit (MoU) i lidhur midis Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (sot Banka Qendrore e Kosovës) dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimit. Memorandumi është rishikuar më datë 31.10.2006.

MoU është lidhur me qëllim njohjen reciproke të certifikatave të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë ndaj palëve të treta, me të cilën nënkuptohet se automjetet që janë të regjistruara në Kosovë mund të qarkullojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë me policën e sigurimit TPL, ndërsa automjetet që janë të regjistruara në Shqipëri mund të qarkullojnë në territorin e Kosovës me policën e sigurimit TPL e brendshme. Gjithashtu dhe për trajtimin dhe pagesën e dëmeve, parashikohet se secila palë do të trajtojë dhe paguajë dëmet që janë adresuar në baza të njëjta siç trajtohen dhe paguhen sipas legjislacionit të sigurimit të detyrueshëm në fuqi të vendit të aksidentit. Trajtimi dhe pagesa përfshin dëme materiale dhe shëndetësore.

Nisur nga fakti se zbatimi i kësaj MoU ka paraqitur problematika që lidhen me bllokimet e pagesave të dëmshpërblimit ndaj qytetarëve të dy shteteve, situatë e cila po bëhet emergjente për shkak të rritjes të shumave të këtyre detyrimeve, me kërkesën e Autoritetit, është zhvilluar një takim zyrtar me përfaqësues të Bankës Qendrore të Kosovës, Byrosë Kosovare dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimit.

Në këtë takim u diskutuan problematikat e dala gjatë zbatimit të MoU, si dhe u diskutua lidhur me mbulimet e kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik, të cilat sipas legjislacionit të dy vendeve nuk mbulojnë përgjegjësinë në territoret reciproke.

Me qëllim zgjidhjen e problematikës së mësipërme, lind nevoja e mbështetjes për ndryshime ligjore, me qëllim njohjen e vlefshmërisë territoriale të këtyre kontratave të sigurimit ose ratifikimi i marrëveshjes së re që do të lidhet midis BSHS-së dhe BKS-së.

Në këtë situatë, për nevojën e përputhshmërisë ligjore të kontratës së sigurimit të detyrueshëm motorik dhe zbatimin reciprok të Memorandunit të Mirëkuptimit midis palëve, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me përfaqësuesit e Bankës Qendrore të Kosovës, ka përcaktuar disa detyra konkrete ku ndër detyrat kryesore është miratimi i një Memorandumi Mirëkuptimi të ri, i cili është në proces finalizimi.

3.10 Fondi i Kompensimit

Byroja Shqiptare e Sigurimit në bazë të ligjit, kryen funksionet e entit kompensues, për bërjen e pagesave të dëmshpërblimit që përballohen nga Fondi i Kompensimit.

Fondi i Kompensimit

Fondi i Kompensimit ka për qëllim pagesën e dëmeve pasurore dhe jopasurore të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur:

- Pronari i mjetit motorik nuk ka lidhur kontratën e sigurimit të pasagjerit;
- Shkaktari i dëmit nuk është i mbuluar nga sigurimi i përgjegjësishë ndaj palëve të treta;
- Dëmi është shkaktuar nga një mjet i paidentifikuar;
- Shoqëria e sigurimit përgjegjëse për pagesën e dëmit rezulton në mbyllje apo falimentim

Autoriteti gjatë 2017 i ka kushtuar një vëmendje të veçantë mbikëqyrjes së BSHS-së, me qëllim mbrojtjen e interesave të konsumatorit, duke ndjekur me përparësi pagesat e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit.

Autoriteti me propozim të Byrosë, vendos çdo vit shumën e kontributeve të Fondit të Kompensimit dhe përcakton afatin brenda së cilit duhet të kryhet derdhja e kontributeve.

Gjatë vitit 2017, janë marrë disa vendime nga Autoriteti lidhur me kontributin e Fondit të Kompensimit.

Vendimet e Autoritetit për Fondin e Kompensimit të marra gjatë vitit 2017

- Vendim nr. 5, datë 03.02.2017, “Për marrjen e masave lidhur me Fondin e Kompensimit”;
- Vendim nr. 26, datë 30.03.2017, “Mbi Fondin e Kompensimit për vitin 2017”;
- Vendim nr. 145, datë 20.10.2017, “Për një shtesë në Fondin e Kompensimit të vitit 2017”;
- Vendim nr. 217, datë 28.12.2017, “Mbi Fondin e Kompensimit për vitin 2018”.

Puna e Autoritetit është përqendruar edhe në evidentimin dhe zgjidhjen e problemeve të akumuluarra ndër vite në Byronë Shqiptare të Sigurimit. Për këtë qëllim, Autoriteti ka bërë një sërë verifikimesh që lidhen kryesisht me pagesat e kryera ndër vite nga të gjithë shoqëritë e sigurimit, duke bërë transparente vlerat e pagesave të kryera, si dhe detyrimet aktuale të këtij fondi.

Gjithashtu, Autoriteti për plotësimin e detyrimeve të shoqërive të sigurimit ndaj Byrosë, për financimin e Fondit të Kompensimit dhe ndjekjen e zbatimit të vendimeve për kryerjen e pagesave të dëmeve objekt i këtij fondi në kohën e duhur, ka hartuar një plan shlyerjeje në lidhje me praktikën e dëmeve që u përkasin ngjarjeve më të hershme.


Gjatë këtij viti ka vijuar të monitorohet zbatimi i vendimeve të Bordit të AMF-së për kryerjen e pagesave të Fondit të Kompensimit duke pasur si prioritet praktikën që u përkasin ngjarjeve më të hershme.

Gjatë vitit 2017, rezulton se pagesat nga shoqëritë e sigurimit, objekt i Fondit të Kompensimit për ngjarjet deri më 31.12.2013, dhe ato me ngjarje sigurimi nga data 1 janar 2014 e në vazhdim, janë në total 726,751,002 lekë, me një rritje rreth 40% krahasuar me vitin e kaluar.

Në fund të vitit 2017, Bordi i Autoritetit miratoi Fondin e Kompensimit për vitin 2018, duke i dhënë zgjidhje problematikave të mbartura ndër vite për fondin e kompensimit, si për pagesat e menjëhershme për praktikantët, të cilave i ka përfunduar procesi i trajtimit, ashtu dhe evidentimin e detyrimeve të këtij Fondi. AMF është e angazhuar të mbrojë konsumatorin, dhe të zgjidhë përfundimisht problematikën që lidhet me Fondin e Kompensimit.

Grafik 25: Vlera e Fondit të Kompensimit, miratuar nga AMF, në vite

(mln. lekë)



Autoriteti, me qëllim zbatimin e vendimeve të Bordit, lidhur me Fondin e Kompensimit, ka pasur komunikime të vazhdueshme me shoqëritë e sigurimit, si dhe ka zhvilluar disa takime me drejtorët e shoqërive të sigurimit.

3.11. Masat e Marra për Stabilizimin e Tregut të Sigurimit të Detyrueshëm

Gjatë vitit 2017, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në funksion të misionit të tij për nxitjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të sigurt të tregjeve në mbikëqyrje, si dhe ushtrimin e kompetencave të mbikëqyrjes, i ka kushtuar rëndësi të veçantë stabilizimit të tregut të sigurimit të detyrueshëm.

Disa nga hapat e marra në këtë drejtim vijnë sa më poshtë:

Problematika e akumuluar ndër vite në lidhje me Fondin e Kompensimit

Autoriteti, i ka kushtuar një vëmendje të veçantë mbikëqyrjes së BSHS-së, me qëllim mbrojtjen e interesave të konsumatorit duke ndjekur me përparësi pagesat e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit.

Gjatë vitit 2017, puna e Autoritetit është përqëndruar te evidentimi dhe zgjidhja e problematikave të akumuluar ndër vite në Byronë Shqiptare të Sigurimit. Për këtë qëllim Autoriteti përveç realizimit të një sërë verifikimesh që lidhen kryesisht me pagesat e kryera ndër vite nga të gjithë shoqëritë e sigurimit, si dhe ndjekjes së pagesave të këtij fondi gjatë vitit 2017, për ngjarjet më të hershme, në muajin nëntor 2017 miratoi shtesën e Fondit të Kompensimit për vitin 2017.

Gjithashtu, me vendimin e Bordit nr. 217, datë 28.12.2017, “Mbi Fondin e Kompensimit të vitit 2018”, Autoriteti pasi ka marrë në shqyrtim situatën e Fondit të Kompensimit lidhur me detyrimet e mbartura dhe të akumuluar ndër vite, si dhe detyrimet që do të lindin gjatë vitit 2018, ka zgjidhur situatën e Fondit të Kompensimit, si për pagesat e menjëhershme për praktikantët e përfunduar, ashtu dhe evidentimin e detyrimeve të këtij fondi.

Vendim tjetër i rëndësishëm që lidhet me kryesisht me përcaktimin e detyrimit të Fondit të Kompensimit ndër vite, duke bërë analiza për faktorët e rritjes së vlerës së dëmeve të ndodhura objekt i këtij fondi është edhe vendimi i marrë në muajin dhjetor 2017, për auditimin e veprimtarisë së BSHS-së nga shoqëri auditimi ndërkombëtare.

Raportimi i kontratës së sigurimit kufitar në kohë reale sipas legjislacionit në fuqi

Autoriteti, në funksion të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve, bazuar në nenin 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, dhe neneve 129 e vijues të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, lidhur me shitjen e kontratave të sigurimit të detyrueshëm kufitar, në mbledhjen e datës 20.10.2017, ka marrë vendimin nr. 146, datë 20.10.2017, “Për shfuqizimin e vendimit nr. 11, datë 30.01.2008 “Për furnizimin e bazës së të dhënave të regjistrit elektronik për shitjen e Policave të Sigurimit kufitar”.

Sipas këtij vendimi raportimi dhe identifikimi i Policave Pufitare të shitura duke filluar nga data 1 nëntor 2017, duhej të kryhej vetëm në kohë reale nëpërmjet regjistrit elektronik *online* të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik, miratuar me Rregulloren nr. 3, datë 03.10.2007 “Për regjistrin elektronik *online* të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik”, e ndryshuar. Lidhur me këtë detyrim Autoriteti ka patur komunikime të vazhdueshme me strukturat e kontrollit të trafikut rrugor dhe kufirit të Republikës së Shqipërisë, që të monitorojnë përmbushjen e këtij detyrimi nga drejtuesit e mjeteve motorike me regjistrim të huaj.

Për këtë është kërkuar që, në zbatim të ligjit, nëse personat e autorizuar për kontrollin e trafikut vërejnë gjatë kontrollit rutinë të trafikut se drejtuesi i mjetit nuk ka dokument të vlefshëm të kontratës së sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë, ato duhet të ndalojnë qarkullimin e mëtejshëm të mjetit motorik dhe të urdhërojnë lidhjen e kontratës kufitare në përputhje me ligjin.

Evidentimi i problematikave që lidhen me veprimtarinë e agjentëve apo punonjësve të shoqërive në procesin e shitjes së kontratave të sigurimit

Autoriteti, gjatë vitit 2017, ka ushtruar inspektim në vend, pranë pikave të shitjeve të policave të sigurimit MTPL, nga agjent apo punonjës të shoqërive të sigurimit, ku janë konstatuar disa shkelje që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së agjentit/punonjësit të disa shoqërive të sigurimit.

Lidhur me këto shkelje, janë marrë disa masa “pezullim ushtrim veprimtarie”, për disa agjentë apo punonjës të disa shoqërive të sigurimit.

Po kështu, Bordi i Autoritetit, ka marrë vendim lidhur me përmirësimin dhe standardizimin e veprimtarisë së këtyre ndërmjetësve. Kërkesat e Autoritetit lidhen, si me ushtrimin me profesionalizëm dhe etikë të veprimtarisë së tyre, zbatimin e kërkesave të licencimit, ashtu dhe kërkesave që lidhen me procesin e ndërmjetësimit të shitjes së kontratave të sigurimit.

Standardizimi dhe unifikimi i policave të sigurimit të detyrueshëm motorik

Gjatë vitit 2017, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është angazhuar për rinovimin teknologjik dhe modernizmin e platformave dhe aplikacioneve aktuale të raportimit në Qendrën e Informacionit të Sigurimit të Detyrueshëm.

Në këtë kuadër, si dhe me qëllim shmangien e fenomenit të mosraportimit të kontratave të sigurimit të detyrueshëm, ka lindur nevoja e unifikimit të numrit serial që personalizohet në policat e sigurimit të detyrueshëm motorik, të cilat emetohen nga BSHS. Unifikimi i numrit serial realizohet me anë të vendosjes shtesë, para numrit aktual serial (7 numra) të 2 numrave të fundit të vitit aktual për të cilin emetohen policat. Autoriteti ka vendosur si datë për hedhjen në treg të këtyre policave të sigurimit të detyrueshëm datën 1 janar 2018.

Inventarizimi i policave të sigurimit të pakonsumuara

Rëndësi të veçantë Autoriteti i ka kushtuar edhe procesit të inventarizimit të policave të sigurimit të detyrueshëm, duke parashikuar në ndryshimet e Rregullores “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit”, si procesin e rakordimit midis shoqërive të sigurimit dhe BSHS-së, ashtu dhe procesin e asgjësimit të policave të pakonsumuara.

Ky ndryshim shoqërohet dhe me ndryshimin në Rregulloren nr. 38 datë 31.03.2016 “Për përmbajtjen, mënyrën, afatet e raportimit dhe njoftimit periodik në AMF nga shoqëritë e sigurimit”, e cila përcakton detyrimin e shoqërive të sigurimit që të raportojnë, njoftojnë në Autoritet, në lidhje me sasi të shpërndara tek agjentët dhe brokerat, të policave të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, sipas numrave serialë përkatës brenda datës 10 të çdo muaji.

Zbatimi i legjislacionit në fuqi nga vlerësuesit e dëmeve në sigurime

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, bazuar në nenin 226 e vijues të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, licencon dhe mbikëqyr veprimtarinë e vlerësuesit e dëmeve në sigurime.

Në zbatim të kompetencave ligjore, me qëllim përmirësimin dhe detyrimin për ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesve me profesionalizëm sipas kërkesave të legjislacionit në fushën e sigurimeve, Autoriteti ka pasur komunikime si dhe ka organizuar takim me vlerësuesit e pavarur të dëmeve në sigurime.

Autoriteti ka kërkuar nga vlerësuesit e dëmeve që të jenë të paanshëm dhe të pavarur, duke respektuar parimin: një vlerësim për një ngjarje sigurimi.

Raportimi i dëmeve nga shoqëritë e sigurimit dhe BSHS-së në Regjistrin Elektronik të Dëmeve

Autoriteti në zbatim të nenit 38, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” i ndryshuar, si dhe të Rregullores nr. 36, datë 30.04.2009 “Për Regjistrin Elektronik të Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike”, i ndryshuar, ka pasur komunikime të vazhdueshme lidhur me raportimin e dosjeve të dëmeve nga ana e shoqërive të sigurimit dhe BSHS.

Procesi i raportimit të dëmeve konsiderohet shumë i rëndësishëm për Autoritetin dhe i shërben jo vetëm verifikimit të të dhënave që përmban ky regjistër lidhur me procesin e trajtimit të dëmeve, por në të ardhmen edhe zbatimit të ndryshimeve ligjore që lidhen me implementimin e sistemit *Bonus-Malus*.

Gjithashtu, po punohet për ndryshime në Rregulloren nr. 3, datë 03.10.2007 “Për regjistrin elektronik *online* të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik”, e ndryshuar, me qëllim përmirësimin e identifikimit të regjistrimit të policave të sigurimit. Në këtë rregullore mendohet të parashikohen procedurat dhe rastet për anulimin e policave të sigurimit, raportimin të të dhënave të një police sigurimi në mënyrë jo të përsëritur, eliminimin e rasteve me numër identifikimi të dubluar, rasteve me numër identifikimi jo korrekt, rasteve të verifikimit të ndryshimeve të të dhënave të raportuara në krahasim me ato të printuara, rastet e cënimit të sigurisë së sistemit, etj.

Hartimi i projektligjit të sigurimit të detyrueshëm

Pjesë tjetër shumë e rëndësishme ishte dhe hartimi i projektligjit të sigurimit të detyrueshëm, sipas të cilit ata që do të përfitojnë të parët janë konsumatorët si në drejtim të mbrojtjes së interesave të tyre në rastet e dëmshpërblimit, ashtu edhe në drejtim të mbrojtjes së tyre në përgjithësi.

3.12 Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik

Gjatë vitit 2017 është siguruar vazhdimësia dhe përmirësimi i funksionimit të regjistrave elektronikë dhe optimizimi i vazhdueshëm i sistemeve informatike, për të plotësuar dhe përmirësuar kërkesat e AMF-së për raportim, nevojat e tregut, rritjen e shkallës së sigurisë e vazhdimësisë së shërbimeve.

Regjistri Elektronik *Online* i Sigurimit të Detyrueshëm Motorik

Regjistri Elektronik *Online* i Sigurimit të Detyrueshëm Motorik përfaqëson një platformë raportimi dhe identifikimi të shitjeve të Policave të Sigurimit të detyrueshëm motorik përkatësisht: Polica e Sigurimit për përgjegjësisë ndaj palëve të treta (TPL e brendshme), Kartoni Jeshil dhe sigurimi kufitar. Ky regjistër është një bazë e plotë të dhënash, i cili furnizohet në kohë reale me policat e shitura TPL, Karton Jeshil dhe kufitare nga sistemet e shitjeve të shoqërive të sigurimit.

Sistemet e shitjeve të shoqërive të sigurimit realizojnë shitjet e policave nëpërmjet agentëve apo zyrave qendrore të tyre. Çdo agent i licencuar i një shoqërie siguri identifikohet në databazë me një kod unik.

Agjenti i një shoqërie siguri kur shkruan targën e një automjeti, të dhënat e automjetit dhe pronarit shfaqen automatikisht pa mundësi ndryshimi duke i shfaqur kategorinë e duhur, kjo si rritje e transparencës në lëshimin e policave sipas të dhënave të lejes së qarkullimit të mjetit.

Policat e shitura nga shoqëritë e sigurimit identifikohen në kohë reale përmes një numri unik raportimi dhe të dhënat e policave të identifikuara përmes këtij numri vendosen në regjistër. Numri i raportimit shtypet në momentin e lëshimit të policës.

Regjistri është kompetencë e AMF-së dhe instaluar në ambientet e AMF-së, i cili mban dhe përditëson të dhënat e policave të sigurimit të detyrueshëm motorik bazuar në të dhënat e raportuara në kohë reale nga sistemet e shitjeve të shoqërive të sigurimit.

Për të certifikuar të dhënat që vijnë, si dhe për shmangien e problematikave të ndryshme në shitjen e policave, sistemi elektronik i shitjeve është i integruar gjithashtu dhe me regjistrin e mjeteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor (DPSHTRR) dhe me regjistrin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC).

Integrimi me DPSHTRR-në mundëson marrjen e të dhënave të mjetit në kohë reale duke ia shfaqur shoqërive të sigurimit në sistemin e shitjeve. Integrimi me DPGJC-në mundëson konsultimin e Nr. Personal (ID e kartës së identitetit) të pronarit të mjetit.

Bashkëpunimi i ngushtë me shoqëritë e sigurimeve dhe bashkëpunimi ndërinstitucional, ka patur për qëllim shmangien e abuzimeve të mundshme, rritjen e standardizimit të marrjes në sigurim, si dhe shkëmbimit të informacionit të kontrolluar, ku përfituesi kryesor është konsumatori dhe tregu në tërësi.

Regjistri i Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike

Pjesë e qendrës së raportimit *online* është dhe Regjistri Elektronik i Dëmeve. Dëmet e ndodhura të sigurimit të detyrueshëm motorik raportohen *online* në Regjistrin e Dëmeve nga shoqëritë e sigurimeve. Ky regjistër u krijua për të mundësuar krijimin e sistemit *Bonus-Malus*, duke përdorur si një nga parametrat e tij, historikun e dëmeve.

Gjatë vitit 2017, puna e AMF-së konsistoi në dy drejtime:

- Përmirësimi i strukturës dhe logjikës së regjistrit të dëmeve;
- Migrimi i të dhënave ekzistuese nga regjistri i vjetër në regjistrin e përmirësuar të dëmeve.

Procesi për krijimin e Regjistrit të ri Elektronik të Dëmeve, kaloi në disa faza, ajo e konstatimit të problematikave, ndryshimeve të strukturës së këtij regjistri, me qëllim përdorimin e tij, si dhe përshtatjen sipas skemës Ngjarje - Dosje - Përfitues. Fazat e ndryshimit parashikuan gjithashtu dhe rishikimin e bazës së të dhënave për dëmet e sigurimeve të detyrueshme motorike dhe ndërfaqes nëpërmjet së cilës shoqëritë e sigurimit regjistrojnë të dhënat përkatëse.

Duke filluar nga muaji tetor 2017, shoqëritë e sigurimit përdorin Regjistrin e ri Elektronik të Dëmeve.

3.13 Zbatueshmëria dhe Kuadri Ligjor e Rregullativ

3.13.1 Kuadri Ligjor e Rregullativ

Gjatë vitit 2017, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator punoi për hartimin e projektligjit të ri për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, si dhe për hartimin dhe ndryshimin e akteve nënligjore si më poshtë:

Projektligji "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit"

Në fund të vitit 2016, AMF paraqiti pranë Ministrisë së Financave ndryshime ligjore të Ligjit nr. 10 076, datë 12.2.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", me qëllim miratimin e tyre në Kuvend.

Ministria e Financave nuk e paraqiti për miratim në Këshillin e Ministrave e më tej në Kuvend, për shkak të problematikave të ngritura nga Ministritë me të cilat u konsultua ligji, moskonsultimit të plotë të ndryshimeve ligjore me Bankën Botërore, moszgjidhjes të një sërë problematikash të hasura në treg, si dhe përafrimit më të plotë me direktivat e BE-së, rekomandimeve të Komisionit Evropian të dhëna, si nëpërmjet progres raporteve, ashtu edhe të takimeve vjetore të Nënkomitetit BE-Shqipëri "Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca".

Në vitin 2017 në Autoritet u ngrit grupi i punës për të riparë edhe njëherë Ligjin nr. 10076, datë 12.2.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" dhe ndryshimet e propozuara, duke patur për referim edhe modelet më të mira të rajonit e më gjerë, si dhe direktivat e BE-së, apo rekomandimeve të KE-së.

Pas procesit të shqyrtimit dhe rishikimit të draftit të sipërpërmendur u konstatua se në rreth 70% të neneve të ligjit ekzistues nevojiteshin ndryshime apo shtesa të dispozitave të tij. Për këtë arsye Autoriteti vendosi hartimin e një projektligji të ri në fushën e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.

Projektligji synon të mbrojë më mirë konsumatorin, të sigurojë zbatimin e sistemit *Bonus-Malus*, të ndikojë në uljen e numrit të drejtuesve të mjeteve të transportit që qarkullojnë të pa pajisur me kontratën e sigurimit të detyrueshëm, t'i japë zgjidhje problematikave të ligjit aktual nga ana e autoriteteve përgjegjëse, të sigurojë përshtatjen me zhvillimet dhe kërkesat e tregut të sigurimeve, të risë shkallën e përafrimit të mëtejshëm me direktivat evropiane.

Gjatë hartimit të aktit janë marrë parasysh gjithashtu aktet ligjore në fushën e sigurimit të detyrueshëm të disa vendeve të rajonit dhe Evropës. Mbështetja në kuadrin ligjor të këtyre shteteve ka pasur si qëllim edhe standardizimin e legjislacionit vendas me atë të vendeve fqinje me problematika të ngjashme të tregjeve financiare.

Projektligji për sigurimin e detyrueshëm në transportin publik ka synuar përafrimin me Direktivën 2009/103/KE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 shtator 2009, për sigurimin e përgjegjësisë civile në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike dhe për zbatimin me forcë të detyrimit për të marrë një sigurim të tillë.

Aktet e Autoritetit në fushën e sigurimeve:

Akte të reja

Gjatë vitit 2017, u hartuan dhe u miratuan 6 rregullore të reja, nga të cilat 5 përmbyllën detyrimin për miratimin e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, e më konkretisht:

- Rregullore nr. 57, datë 26.05.2017 “Mbi llogaritjen e mbajtjes neto të mbulimit maksimal agregat të rreziqeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit”. Kjo rregullore përcakton rregulla për shoqëritë e sigurimit në lidhje me llogaritjen e mbajtjes neto të mbulimit maksimal agregat të rreziqeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, nga tërmetet dhe rreziqe të tjera aggregate dhe të akumuluar për kontratat e nënshkruara nga shoqëria e sigurimit.
- Rregullore nr. 86, datë 03.07.2017 "Mbi administrimin dhe rastet e ndërhyrjes në Fondin e Garancisë së shoqërisë së sigurimit", e cila vendos rregulla mbi administrimin e Fondit të Garancisë dhe rastet e ndërhyrjes në Fondin e Garancisë së shoqërisë së sigurimit.
- Rregullore nr. 54, datë 26.05.2017 “Mbi likuidimin e detyrueshëm të degës së shoqërisë së sigurimit, të një vendi të huaj dhe të një vendi anëtar të BE-së. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të likuidimit të detyrueshëm të degës së shoqërisë së sigurimit, të një vendi të huaj dhe degës së shoqërisë së sigurimit të një vendi anëtar të BE-së.
- Rregullore nr. 55, datë 26.05.2017 “Mbi mbikëqyrjen e grupit të sigurimit”, e cila vendos rregulla, kushte dhe kërkesa për realizimin e mbikëqyrjes së grupit të sigurimit, me qëllim administrimin e rrezikut që rrjedh nga ushtrimi i veprimtarisë së grupit të sigurimit.
- Rregullore nr. 56, datë 26.05.2017 "Për transferimin e portofolit të sigurimit në lidhje me vendet anëtare" Objekt i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave për transferimin e portofolit të sigurimit në lidhje me vendet anëtare.
- Rregullore nr. 85, datë 03.07.2017 “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, e cila shfuqizoi Rregulloren nr.127, datë 26.11.2015, përcakton procedurën, rastet, afatet e pezullimit dhe revokimit të licencës së vlerësuesit të dëmeve si person fizik apo person juridik, përcakton detyrimin e vlerësuesve të dëmeve për të raportuar në Autoritet si për fillimin e veprimtarisë ashtu edhe për vijimin e saj, etj.

Amendime

Gjatë vitit 2017 ndryshuan katër rregullore ekzistuese të tregut të sigurimeve, sa më poshtë:

- Ndryshimi në Rregulloren 38/31.3.2016 “Për përmbajtjen, mënyrën, afatet e raportimit dhe njoftimit periodik në AMF nga shoqëritë e sigurimit”, vjen si rrjedhojë e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren 2/28.1.2010 “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit”, që lidhet me monitorimin e shitjeve

si dhe procesin e inventarizimit të policave të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit. Ndryshimi konsiston në detyrimin e shoqërive të sigurimit që të raportojnë, njoftojnë në Autoritet, në lidhje me sasitë e shpërndara tek agjentët dhe brokerat, të policave të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, sipas numrave serialë përkatës brenda datës 10 të çdo muaji;

- Ndryshimet në Rregulloren nr. 2, datë 28.01.2010 “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit”, synojnë unifikimin e numrit serial që personalizohet në policat e sigurimit të detyrueshëm motorik, i cili është një nga të dhënat që raportohet në Regjistrin Elektronik *Online* të Shitjeve, në zbatim të Rregullores nr. 3, datë 03.10.2007 "Për Regjistrin Elektronik *Online* të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik", e ndryshuar. Unifikimi i numrit serial realizohet me anë të vendosjes shtesë, para numrit aktual serial (7 numra) të 2 numrave të fundit të vitit korrent për të cilin emetohen policat. Gjithashtu, me rëndësi në këtë rregullore është shtesa e një neni të ri, i cili parashikon procedurën që do të ndiqet për asgjësimin e policave të sigurimit e cila fillon me evidentimin e policave të sigurimit të pakonsumuara nga shoqëritë e sigurimit, dorëzimin e tyre pranë Byrosë, ngritjen e komisioneve të posaçme për asgjësimin e tyre si dhe raportimin në Byro;
- Ndryshime në Rregulloren nr. 38, datë 28.05.2015 "Për formatin e detajuar, minimumin e objektit dhe të përmbajtjes së raportit të auditimit, të shoqërisë së sigurimit", miratuar me Vendimin e Bordit nr. 151, datë 30.11.2017;
- Ndryshime në Rregulloren nr. 2, datë 25.01.2016 "Për formën, afatet dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, raporteve statistikore dhe raportimeve të tjera të ndërmjetësve në sigurime dhe risigurime", miratuar me Vendimin e Bordit nr. 58, datë 26.05.2017

3.13.2 Masat korrigjuese dhe administrative

Masat mbikëqyrëse, korrigjuese e sanksionuese të vendosura nga Autoriteti gjatë 2017 kanë pasur për qëllim parandalimin, korrigjimin, ndërprerjen e rrethanave apo veprimeve në shkelje të dispozitave ligjore ose akteve të tij. Masat e marra nga Autoriteti janë bazuar në inspektimet në vend, kontrollin mbi dokumenta, verifikim të informacionit, apo në shqyrtim të ankesave të depozituara.

Bordi i AMF-së, gjatë vitit 2017, ka marrë 35 vendime për masa administrative e korrigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura pas konstatimeve të bëra, si nga analizimi i treguesve financiarë, ashtu edhe nga inspektimet në vend të kryera nga Autoriteti.

Masat e marra në përputhje me legjislacionin në fuqi, si rezultat i gjetjeve nga inspektimet dhe performancës jo të mirë financiare, janë: shtimi i mjeteve për plotësim të kërkesave rregullative për kapitalin minimal të kërkuar, kufizim përdorimi të aktiveve të shoqërisë, kërkesa për riauditim të pasqyrave financiare, revokim licence, kërkesë për plan të rimëkëmbjes, gjoba dhe çështje të tjera.

Vendimet e detajuara sipas llojit të masave administrative paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabelë 27: Masat mbikëqyrëse të marra nga AMF në tregun e sigurimeve për vitin 2017
(në numër)

Urdhër për eliminim shkeljeje	Plan masash për eliminim shkeljesh	Rekomandim për rritje kapital	Revokim licence	Ndalim pagese të dividendit	Ndalim të dhënies së huave	Mbi fondin e kompensimit	Ndalim të transaksioneve me palë të lidhura
2	9	4	9	2	1	5	3

Gjatë vitit 2017 Autoriteti ka vendosur sanksione me gjobë ndaj disa shoqërive të sigurimit. Gjjobat e vendosura të cilat lidhen me vendimet e marra gjatë këtij viti, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 28: Masat sanksion me gjobë të marra nga AMF në tregun e sigurimeve për vitin 2017
(në numër)

Sanksion me gjobë ndaj shoqërive të sigurimit	Sanksion me gjobë ndaj personave përgjegjës
5	1

Gjatë vitit 2017, është ankimuar në Gjykatë një Vendim i Bordit dhe vijon gjykimi për trembëdhjetë vendime të Bordit të AMF-së.

AMF ka ndjekur me rigorozitet proceset e ankimit dhe mbrojtjes gjyqësore në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor. Gjatë vitit 2017, Autoriteti ka ndjekur 14 procese gjyqësore.

Tabelë 29: Proceset gjyqësore të ndjekura nga AMF për vitin 2017
(në numër)

Totali	Të përfunduara	Në proces
14	0	14

Gjatë vitit 2017, është ankimuar në Gjykatë 1 (një) Vendim dhe vijon gjykimi për 13 (trembëdhjetë) prej vendimeve të marra nga Bordi i AMF-së.

Gjatë vitit 2017, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë janë gjykuar 3 çështje, ndaj të cilave është bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit. Ankimi në dy raste është bërë nga Autoriteti dhe në një rast nga një prej shoqërive të sigurimit, pasi në shkallë të parë është vendosur rrëzimi i kërkesë padisë dhe i masës për sigurimin e padisë.

Në Gjykatën Administrative të Apelit gjatë 2017 janë gjykuar dy çështje, ndaj të cilave është bërë rekurs nga shoqëritë e sigurimit.

Numri total i çështjeve që priten të shqyrtohen në Gjykatën Administrative të Apelit është shtatë, po ashtu edhe numri total i çështjeve që priten të gjykohen në Gjykatën e Lartë është shtatë.

Kapitulli 4. Mbikëqyrja e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare


4.1 Struktura e Tregut

Skema e organizimit dhe funksionimit të pensioneve private vullnetare, e sanksionuar me Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 ka krijuar hapësirat e nevojshme për të stimuluar shtetasit të kursejnë privatisht dhe vullnetarisht për të përfituar një pension shtesë.

Edhe gjatë vitit 2017, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre 3 fonde pensioni vullnetar të administruar nga tre shoqëri administruese, përkatësisht “Raiffeisen Invest” sh.a., që administron Fondin e Pensionit Vullnetar “Raiffeisen”, “SIGAL-Life Uniqa Group Austria” sh.a., që administron Fondin e Pensionit Vullnetar “Sigal”, si dhe “Credins Invest” sh.a., që administron Fondin e Pensionit Vullnetar “Credins Pension”.


Numri i anëtarëve në tregun e fondeve të pensionit vullnetar në fund të vitit 2017 është 20,947 anëtarë, duke shënuar rritje prej 3,630 anëtarë, ose 20.96% krahasuar me fundin e vitit 2016. Nga këto 12,081 anëtarë bëjnë pjesë në fondin e pensionit vullnetar “Credins Pension”, të cilët zënë pjesën më të madhe të tregut të ndarë sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar, e shprehur kjo në përqindje 57.67%. Në vend të dytë përta i përket numrit të anëtarëve është fondi i pensionit vullnetar “Sigal” me 6,066 anëtarë ose 28.96%, kurse pjesa e mbetur prej 2,800 anëtarësh ose 13.37% janë anëtarë të fondit të pensionit vullnetar “Raiffeisen”. Në grafikun më poshtë është pasqyruar ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar e shprehur në përqindje për fundvitin 2017.

Grafik 26: Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar më 31.12.2017



Në grafikun më poshtë është pasqyruar ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar gjatë tre viteve të fundit.

Grafik 27: Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar



Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet numri i anëtarëve sipas fondeve të pensionit vullnetar gjatë tre viteve të fundit si dhe ndryshimi në përqindje për periudhat 31.12.2015-31.12.2016 dhe 31.12.2016-31.12.2017.

Tabelë 30: Numri i anëtarëve sipas fondeve të pensionit vullnetar

Përshkrimi	Numri i anëtarëve në FP			Ndryshimi (në %)	
Periudha	2015	2016	2017	31.12.'15-31.12.'16	31.12.'16-31.12.'17
Sigal	5,486	5,794	6,066	5.61%	4.69%
Raiffeisen	2,583	2,653	2,800	2.71%	5.54%
Credins Pension	4,490	8,870	12,081	97.55%	36.20%
Total	12,559	17,317	20,947	37.89%	20.96%

Siç mund të shihet nga tabela e mësipërme, numri i anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar ka ardhur duke u rritur. Ritmi i rritjes së numrit të anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar për periudhën 31.12.2016-31.12.2017 është më i ulët se ai për periudhën 31.12.2015-31.12.2016. Në fund të vitit 2017 numri i anëtarëve në fondin e pensionit vullnetar “Credins Pension” është rritur me 36.20% në krahasim me fundin e vitit 2016, kurse numri i anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar “Raiffeisen” dhe “Sigal” respektivisht është rritur me 5.54% dhe 4.69%.


Në fund të vitit 2017, 12,269 anëtarë të tregut të fondeve të pensionit vullnetar janë përfshirë në planet individuale të pensionit vullnetar dhe 8,678 anëtarë janë përfshirë në planet profesionale të pensionit vullnetar të krijuara nga punëdhënësit për punonjësit e tyre. Në 31.12.2017 në fondin e pensionit vullnetar “Sigal” dhe në fondin e pensionit vullnetar “Raiffeisen” pjesa më e madhe e anëtarëve në secilin nga këto dy fonde janë përfshirë në planet profesionale të pensionit përkatësisht në masat 79.66% dhe 68.43%, kurse në fondin e pensionit vullnetar “Credins Pension” 84.02% e anëtarëve në këtë fond janë përfshirë në planet individuale të pensionit. Tabela më poshtë tregon ndarjen anëtarëve në secilin prej fondeve të pensionit vullnetar sipas planeve individuale dhe profesionale të pensionit për fundvitin 2017.

Tabelë 31: Ndarja e anëtarëve të fondeve të pensionit vullnetar sipas planeve të pensionit më 31.12.2017

Fond Pensioni	Numri i anëtarëve në planet individuale të pensionit	Numri i anëtarëve në planet profesionale të pensionit
Sigal	1,234	4,832
Raiffeisen	884	1,916
Credins Pension	10,151	1,930
Total	12,269	8,678

Në grafikun më poshtë është paraqitur ndarja e anëtarëve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar sipas planeve të pensionit për fundvitin 2017, ku 58.57% e anëtarëve të këtij tregu bëjnë pjesë në planet individuale të pensionit, kurse 41.43% e tyre bëjnë pjesë në planet profesionale të pensionit.

Grafik 28: Ndarja e anëtarëve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar sipas planeve të pensionit më 31.12.2017



4.2 Pozicioni Financiar

Tregu i fondeve të pensionit vullnetar që prej fillimit të aktivitetit të tij, ka pasur tendencë në rritje, përse i përket aseteve që menaxhon, si dhe numrit të kontribuesve. Megjithatë, vlera neto e aseteve të këtij tregu është ende në masë të papërfillshme kundrejt PPB-së në Shqipëri. Totali i aseteve neto të këtij tregu më 31.12.2017 është 1,727.54 milionë lekë me një numër prej 20,947 anëtarë. Asetet neto të këtij tregu më 31.12.2017 kanë pësuar një rritje me 31%, ndërsa numri i anëtarëve është rritur me 20.96%, krahasuar me fundin e vitit 2016. Ecuria e vlerës neto të aseteve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar për tre vitet e fundit jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 32: Asetet neto të fondeve të pensionit vullnetar


Përshkrimi	Vlera (mln. lekë)			Ndryshimi (në %)	
Periudha	2015	2016	2017	31.12.2015- 31.12.2016	31.12.2016- 31.12.2017

Asetet neto të tregut të FP	928.74	1,318.74	1,727.54	41.99%	31.00%
-----------------------------	--------	----------	----------	--------	--------

Siç mund të shihet nga tabela e mësipërme ritmi i rritjes së aseteve neto të tregut të фондеве të pensionit vullnetar për periudhën 31.12.2016-31.12.2017 është më i ulët se ai për periudhën 31.12.2015-31.12.2016.


Në 31.12.2017 fondi i pensionit vullnetar “Sigal” zë peshën më të madhe të këtij tregu përse i përket vlerës së aseteve neto 50.67%, kurse fondi i pensionit vullnetar “Raiffeisen” dhe fondi i pensionit vullnetar “Credins Pension” zënë respektivisht 29.35% dhe 19.99% të tregut, siç shihet edhe në grafikun e mëposhtëm.

Grafik 29: Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të фондеве të pensionit më 31.12.2017



Në grafikun e mëposhtëm është pasqyruar ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensionit vullnetar gjatë tre viteve të fundit.

Grafik 30: Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensionit vullnetar



Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet vlera e kuotës për secilin fond pensioni vullnetar gjatë tre viteve të fundit.

Tabelë 33: Vlera e kuotës së fondeve të pensionit vullnetar

<i>Fondi i pensionit</i>	<i>Vlera e aseteve neto për kuotë 2015</i>	<i>Vlera e aseteve neto për kuotë 2016</i>	<i>Vlera e aseteve neto për kuotë 2017</i>
Sigal	1,243	1,297	1,350
Raiffeisen	1,444	1,544	1,635
Credins Pension	1,249	1,305	1,354

Nga tabela e mësipërme mund të shihet se vlera e aseteve neto për kuotë për secilin nga fondet e pensionit ka pasur një tendencë në rritje. Në fund të vitit 2017 vlera e aseteve neto për kuotë e fondit të pensionit “Sigal” është rritur me 4.09%, krahasuar me fundin e vitit 2016, kurse për

fondin e pensionit vullnetar “Raiffeisen” dhe “Credins Pension” ky tregues është rritur respektivisht me 5.89% dhe 3.75%.

Asetet e këtij tregu në 31.12.2017 janë në vlerën 1,732.94 milionë lekë dhe janë investuar në obligacione të qeverisë shqiptare. Investimet në obligacione të RSH-së përbëjnë 94.74% të totalit të aseteve të tregut të fondeve të pensionit dhe janë rritur me 30.79% krahasuar me fundvitin 2016. Pjesa tjetër e aseteve e këtij tregu konsiston në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare dhe në llogari të arkëtueshme, të cilat përfaqësojnë interesin e përllogaritur të investimeve në obligacione të R.SH., përkatësisht në masat 3.37% dhe 1.89%. Struktura e aseteve të këtij tregu gjatë tre viteve të fundit dhe ndryshimi i kësaj strukture jepet në tabelat e mëposhtme:

Tabelë 34: Struktura e aseteve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar gjatë tre viteve të fundit

Përshkrimi	Vlera (mln. lekë)		
	31.12.'15	31.12.'16	31.12.'17
Periudha			
Asetet neto të fondeve të pensionit	928.74	1,318.74	1,727.54
Totali i aseteve të fondeve	930.40	1,325.36	1,732.94
<i>nga të cilët:</i>			
Mjete Monetare dhe Ekuivalentë të Mjeteve Monetare	69.07	46.31	58.44
Obligacione Thesari të R.SH.	843.02	1,255.29	1,641.76
Depozita bankare	0.00	0.00	0.00
Asete të tjera ⁷	18.31	23.76	32.74
Totali i Detyrimeve të Fondeve	1.66	6.62	5.40

Tabelë 35: Ndryshimi i strukturës së aseteve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar më 31.12.2017 krahasuar me 31.12.2016

Përshkrimi	Vlera (Në mln. lekë)		Ndryshimi (Në %)	Pjesa ndaj totalit (Në %)	
	31.12.2016	31.12.2017		31.12.'16	31.12.'17
Asetet neto të fondeve të	1,318.74	1,727.54	31.00		

⁷ Përfaqëson interesin e përllogaritur të investimeve në obligacione të R.SH.

pensionit					
Totali i aseteve të fondeve	1,325.36	1,732.94	30.75	100	100
nga të cilët:					
Mjete Monetare dhe Ekuivalentë të Mjeteve Monetare	46.31	58.44	26.19	3.49	3.37
Obligacione Thesari të R.SH.	1,255.29	1,641.76	30.79	94.71	94.74
Depozita bankare	0.00	0.00	-	0.00	0.00
Asete të tjera	23.76	32.74	37.79	1.79	1.89
Totali i Detyrimeve të Fondeve	6.62	5.4	-18.43	0.50	0.31

Gjatë vitit 2017, totali i investimeve të fondeve të pensionit ka qenë 1,641.76 milionë lekë dhe këto investime konsistojnë në obligacione të thesarit të Republikës së Shqipërisë (94.74% ndaj totalit të aseteve). Investimet e tregut të pensioneve kanë shënuar një rritje me 30.79% krahasuar me 31.12.2016. Ecuria e investimeve gjatë tre viteve të fundit paraqitet në tabelën e mëposhtme:


Tabelë 36: Vlera e investimeve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar

(në mln. lekë)

Periudha	2015	2016	2017
Totali i investimeve të FP	843.02	1,255.29	1,641.76

Duke qenë se detyrimet e fondeve të pensionit vullnetar janë afatgjata pasi anëtarët mund të tërhiqen kur arrijnë moshën e pensionit, atëherë dhe politika e investimeve për të tre fondet e pensionit, të cilat operojnë në treg është afatgjatë duke mbartur në këtë mënyrë dhe riskun e tregut. Kështu kjo politikë e investimeve të fondeve të pensionit ka synuar në maturime 3, 5, 7 dhe 10 vjeçare siç mund të shihet dhe në grafikun më poshtë:

Grafik 31: Ndarja sipas maturimit të investimeve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar më 31.12.2017



Në grafikun më sipër vihet re se pjesën më të madhe e zënë investimet në obligacione me afat maturimi 7 vjeçar dhe 10 vjeçar përkatësisht në masat 34.99% dhe 47.23%. Ky fakt tregon se fondet e pensionit vullnetar synojnë të ndërtojnë një portofol të përbërë kryesisht nga letra me vlerë afatgjatë.

Disa tregues nga vendet e rajonit

Në Maqedoni, Serbi dhe Kroaci, ashtu si dhe në Shqipëri, skemat e pensionit të shtyllës së tretë të ofruara nga fondet e pensionit vullnetar të këtyre shteteve janë të tipit me përfitime të përcaktuara.


Në Maqedoni ushtrojnë veprimtarinë e tyre dy shoqëri adminstruese, të cilat administrojnë dy fonde pensioni vullnetar. Sipas raportit vjetor të autoritetit mbikëqyrës maqedonas MAPAS, në fund të vitit 2017, ky treg numëron 23,800 anëtarë me një vlerë të aseteve neto prej 21.15 milionë euro. Gjithashtu, sipas tij 48.66% e totalit të aseteve të tregut maqedonas të fondeve të pensionit vullnetar është investuar në obligacione të qeverisë. Ndërkohë, vlera e aseteve neto të

fondeve të pensionit vullnetar në vendin tonë e shprehur në monedhën euro në fund të vitit 2017 është 13 milionë euro.

Në Serbi kryejnë aktivitetin e tyre 4 shoqëri administruese, të cilat administrojnë 7 fonde pensioni vullnetar gjithsej. Sipas raportit të tre mujorit të katërt të vitit 2017 të publikuar nga autoriteti mbikëqyrës serb NBS, vlera e aseteve neto e këtij tregu në fund të vitit 2017 është 305.7 milionë euro dhe numri i anëtarëve është 185,455 anëtarë. Bazuar në këtë raport, në fund të vitit 2017, 83.6% e totalit të aseteve të këtij tregu është investuar në obligacione të qeverisë. Në Kroaci operojnë 4 shoqëri administruese dhe 8 fonde pensioni vullnetar gjithsej. Në bazë të raportit statistikor të publikuar nga autoriteti mbikëqyrës kroat HANFA, në fund të vitit 2017 vlera e aseteve neto e këtij tregu është 523.6 milionë euro dhe numri i anëtarëve është 285,775 anëtarë.

Në grafikun më poshtë është pasqyruar vlera e aseteve neto për tregun e fondeve të pensionit vullnetar në Shqipëri si dhe për vendet e rajonit të përmendura më sipër për fundvitin 2017.

Grafik 32: Vlera e aseteve neto sipas vendeve të rajonit më 31.12.2017 (mln. euro)



Krahasuar me vendet e mësipërme, tregu i fondeve të pensionit vullnetar në vendin tonë i afrohet më tepër tregut maqedonas për sa i përket vlerës së aseteve neto dhe numrit të anëtarëve.

4.3 Mbikëqyrja dhe Analiza e Rreziqeve të Tregut

Në kuadrin e metodologjisë mbikëqyrëse me bazë rrezikun, në vitin 2017 vijoi puna për zbatimin e programit të inspektimit në vend pranë njësisë së depozitarit të dy prej fondeve të

pensionit. Objekti i këtij inspektimi ishte vlerësimi i nivelit të rreziqeve të njësisë së depozitarit mbështetur në parimet me të cilat duhet të përputhet aktiviteti i tij.

Këto parime janë pjesë e zbatimit të metodologjisë së re mbikëqyrëse për fondet e pensioneve vullnetare, asaj me bazë rreziku, e cila u hartua dhe u miratua në vitin 2016. Nëpërmjet kësaj metodologjie evidentohen rreziqet më të mëdha që prekin këtë treg dhe njëkohësisht strategjitë që duhen ndjekur për zbutjen e tyre në një nivel të pranueshëm.

Qasja e ndjekur gjatë inspektimit pranë njësisë së depozitarit ishte shqyrtimi i dokumentacionit të kërkuar paraprakisht nga njësia e depozitarit, zhvillimi i intervistave me punonjës që mbajnë pozicione kryesore në njësinë e depozitarit, si dhe verifikimi ose testimi në vend në lidhje me çështje të ndryshme. Pas përfundimit të inspektimit, mbi bazën e gjetjeve të identifikuara, u vlerësua përputhshmëria e aktivitetit të njësisë së depozitarit me parimet me të cilat duhet të përputhet aktiviteti i tij dhe niveli i rreziqeve të njësisë së depozitarit. Nga gjetjet e këtij inspektimi, AMF ka lënë rekomandimet përkatëse, për të cilat njësia e depozitarit ka punuar për t'i përmbushur.

Metodologjia me bazë rrezikun, me qëllim zhvillimin e një procesi të shëndoshë për gjykimin e vlerësimit të rrezikut, ka parashikuar gjithashtu ngritjen e Komitetit të Rrezikut për Fondet e Pensionit, i cili ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2016 me miratimin e metodologjisë së re mbikëqyrëse.

Gjatë mbledhjeve të Komitetit të Rrezikut në vitin 2017 janë prezantuar matricat e rrezikut të pranishëm dhe rrezikut të mbetur në sistem dhe u dakordësua vlerësimi i këtyre rreziqeve, duke identifikuar rreziqet që kërkojnë ndërhyrje më të shpejtë në sistem. Kështu, si rreziku më i madh në kushtet e Shqipërisë u identifikua rritja e pjesëmarrjes së kontribuesve në sistem, gjë që ka lidhje edhe me rritjen e besueshmërisë në sistem. Komiteti i Rrezikut, duke pasur si objektiv zbutjen e rreziqeve, miratoi planin e mbikëqyrjes për një periudhë afatmesme për tregun e fondeve të pensionit.

4.4. Kuadri Ligjor dhe Rregullativ

Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 "Për Fondet e Pensionit Vullnetar"

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të Ligjit nr. 10197 datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar", për ta përshtatur me zhvillimet e fundit në fushën e pensioneve vullnetare, me direktivat e BE-së, si dhe në zbatimin rekomandimeve të progres raporteve të BE-së, finalizoi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar"". Përmirësimi i kuadrit ligjor në tregun e pensioneve vullnetare lindi edhe si nevojë e përmbushjes së angazhimeve të marra në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2015 -2020, të miratuar me VKM nr. 404,

datë 13.05.2015. Aktualisht draftligji është përcjellë nga Ministria e Financave, pranë Këshillit të Ministrave për miratim.

Akte në fushën e pensioneve vullnetare:

- Rregullores nr.25, datë 23.02.2011 “Për raportimin në AMF të veprimtarisë së shoqërisë administruese të fondeve të pensionit” iu bënë disa amendime, të cilat afrojnë afatet e raportimit në AMF, gjithashtu ndryshon mënyra e depozitimit në Autoritet të pasqyrave financiare të fondeve të pensionit nga shoqëritë e administrimit.
- Rregullores nr.113, datë 18.11.2010 “Për testimin e administratorëve të shoqërisë administruese të fondeve të pensioneve”, iu bënë rregullimet përkatëse, me qëllim përputhjen e emërtimeve me ndryshimet në ligjin dhe në strukturën organizative të AMF-së.

Kapitulli 5. Bashkëpunimi institucional dhe projektet

5.1. Bashkëpunimi me institucionet e vendit

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka një rol të rëndësishëm për zhvillimin dhe ruajtjen e stabilitetit të qëndrueshëm financiar të vendit. Bashkëpunimi i rregullatorëve të ndryshëm ekonomikë dhe financiarë është konsideruar mjaft i rëndësishëm për ecurinë e tregjeve financiare. Për t'i shërbyer këtij bashkëpunimi edhe gjatë vitit 2017 janë thelluar marrëdhëniet me institucionet më të rëndësishme financiare në vend apo institucione e grupe të tjera interesi, veprimtaria e të cilëve lidhet direkt ose indirekt me aktivitetin mbikëqyrës apo rregullator.

Një vend të rëndësishëm zuri bashkëpunimi dypalësh ndërmjet AMF-së dhe Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave, Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, si dhe shumëpalësh ndërmjet tyre në kuadër të Grupi Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF). Në muajin prill 2017 u zhvillua mbledhja e radhës së këtij grupi, ku fokusi i diskutimeve lidhej me nevojën për të forcuar përdorimin e monedhës vendase në ekonominë shqiptare dhe në sistemin financiar, si dhe rëndësinë e këtij procesi për përmirësimin e efektivitetit të politikës monetare dhe uljen e rreziqeve për stabilitetin financiar dhe politikën fiskale.

Me qëllim angazhimit institucional, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Banka e Shqipërisë në këtë mbledhje nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi “Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare”, ku u angazhuan të ndërmarrin veprime për të ulur nivelin e përdorimit të monedhave të huaja në ekonomi sipas sektorëve të cilët mbikëqyrin.

Në funksion të forcimit të tregut të sigurimeve dhe veçanërisht të tregut të sigurimit të detyrueshme motorik, AMF gjatë 2017 ka punuar ngushtësisht me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, si dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor. Në sajë edhe të marrëveshjeve të realizuara më parë me këto institucione, bashkëpunimi ka mundësuar kontrollin e zbatimit të legjislacionit për sigurimin e detyrueshëm, evidentimin e saktë dhe pajisjen e mjeteve motorike që lëvizin në territorin e Republikës së Shqipërisë me kontrata sigurimi të vlefshme.

Një element i rëndësishëm i bashkëpunimit institucional është edhe nënshkrimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me institucione rregullatore e jo rregullatore në vend. AMF nënshkroi më datë 11 shtator 2017, Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve “Inspektimet e përbashkëta në shoqëritë e sigurimeve dhe subjektet e tjera në mbikëqyrje të AMF-së dhe shkëmbimin e informacionit. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje shërben si bazë bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve, me qëllim kryerjen e inspektimeve të përbashkëta midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas afateve dhe rregullave procedurale në fuqi për kontrollin, si dhe shkëmbimin e informacioneve në funksion të këtyre inspektimeve.

AMF në muajin dhjetor 2017 nënshkroi Memorandumin e Bashkëpunimit me Institutin e Statistikave (INSTAT), në bazë të të cilit dy institucionet do të bashkëpunojnë për hartimin e planeve strategjike në fushën e statistikave, përmirësimin e metodologjisë së statistikave, metodave dhe teknikave ekzistuese, si përmes grupeve të punës ashtu dhe shkëmbimit të rregullt të dokumentave formalë dhe teknik.

Një nga synimet e punës së AMF-së ka qenë dhe mbetet edhe zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë në kuadër të transmetimit të dijeve mbi aktivitetin dhe mbikëqyrjen e tregut financiar përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, si dhe shërbimeve nga institucionet e arsimit të lartë. Gjatë vitit 2017 AMF në kuadër edhe të zbatimit të strategjisë për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje, 2017-2020 nënshkroi Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Aleksandër Moisiu, Durrës në muajin tetor, me Universitetin Mesdhetar në muajin nëntor dhe me Universitetin Luarasi në muajin dhjetor 2017.

5.2 Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

Partnerite dhe anëtarësime në organizata ndërkombëtare

AMF është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve, (IAIS), që prej vitit 2001. Themeluar në vitin 1994, IAIS përfaqëson rregullatorët dhe mbikëqyrësit e më shumë se 200 juridiksioneve në rreth 140 vende. Objektivat e saj janë mbikëqyrja sa më efektive e industrisë së sigurimeve për zhvillimin dhe ruajtjen e tregjeve, si dhe mbrojtjen e të sigurve, si dhe të kontribuojë në stabilitetin financiar global. Ky anëtarësim ka ndihmuar në thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar mes autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve.

Në Konferencën e 24-të vjetore të IAIS-it në muajin nëntor 2017 me temë “Mbikëqyrja në sigurime: vështirësi më të gjerë” AMF prezantoi iniciativat e ndërmarra për të rritur edukimin financiar në vend në kuadër të Strategjisë së miratuar nga Bordi i Autoritetit për të rritur besimin e konsumatorëve në tregjet nën mbikëqyrje. Gjithashtu, AMF vazhdoi pjesëmarrjen në mënyrë aktive në aktivitete të tjera të organizuara nga IAIS. Më poshtë vijojnë disa nga aktivitetet kryesore të IAIS, ku AMF ka marrë pjesë si anëtare e kësaj organizate:

Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me IAIS

- Forumi i 3-të Ndërkombëtar i Sigurimeve me temë “Sfidat e reja për industrinë e sigurimeve motorike”;
- Mbledhjet e Komiteteve dhe Konferencës Vjetore të IAIS;
- Mbledhjet e Komiteteve dhe Nënkomiteteve të IAIS dhe konferenca globale e sigurimeve.

AMF është anëtare me të drejta të plota në Organizatën Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë, (IOSCO) dhe njëkohësisht nënshkruese e Memorandumit Shumëpalësh të

IOSCO-s që prej vitit 2009. Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë është organizmi ndërkombëtar që mbledh së bashku rreth 95% të rregullatorëve të letrave me vlerë në gjithë botën dhe njihet si hartues i standardeve globale për sektorin e letrave me vlerë. IOSCO zhvillon, zbaton dhe promovon respektimin e standardeve të njohura ndërkombëtare për rregullimin e letrave me vlerë.

AMF ka qenë e angazhuar në plotësimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja në këtë organizatë dhe vazhdon të plotësojë kuadrin rregullator, me qëllim përafrimin me standardet e parimet e IOSCO-s. AMF është gjithashtu pjesëmarrëse aktive në Komitetin Evropian të IOSCO-s (*European Regional Committee, ERC*) dhe e Komitetit të Tregjeve në Rritje e Zhvillim (*Growth and Emerging Markets Committee, GEM*).

Më poshtë është një përmbledhje e pjesëmarrjes së AMF-së në aktivitetet e organizuara nga IOSCO gjatë vitit 2017.

Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me IOSCO

- Konferenca e 42-të Vjetore e Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë
- Mbledhjet e Komitetit Rajonal Evropian (*ERC*);
- Mbledhjet e Komiteteve të IOSCO-s (*GEM*);
- Seminar “Mbi mbrojtjen e investitorit nëpërmjet mbikëqyrjes, inspektimeve dhe ekzaminimeve”

AMF është anëtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve, (IOPS), që prej vitit 2006. IOPS është organizatë e pavarur ndërkombëtare, e cila përfaqëson ato institucione që janë përfshirë në mbikëqyrjen e marrëveshjeve të pensioneve private. IOPS aktualisht ka 87 anëtarë dhe vëzhgues që përfaqësojnë 76 vende dhe territore në të gjithë botën.

Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me IOPS

- Forumi i 6-të Botëror mbi Pensionet (*World Pensions Investment Forum*);
- Seminari Ndërkombëtar “Panorama e skemave të pensioneve, progresi, perspektivat dhe sfidat”;
- Mbledhja e Përbashkët e Grupit të Punës dhe Seminari kërkimor i IOPS/OECD mbi Pensionet Private;
- Forumi Global OECD/IOPS “Mbi kujdesin për të ardhmen e pensioneve;
- Mbledhja e Komiteteve Teknike dhe Ekzekutive, Mbledhja e Përgjithshme Vjetore.

Projektet strategjike dhe rritja e kapaciteteve institucionale të AMF-së janë mbështetur edhe gjatë vitit 2017 nëpërmjet bashkëpunimit dhe marrëdhënieve efektive me institucionet ndërkombëtare, financiare dhe donatorët. Kështu, gjatë vitit 2017, AMF ka bashkëpunuar ngushtë me Bankën Botërore, Sekretariatit Zvicerian për Çështjet Ekonomike (SECO), organizatën A2II, dhe FSVC.

Banka Botërore mbetet një partner i rëndësishëm strategjik që mbështet Autoritetin në vite, në përmbushje të misionit themelor. Edhe gjatë vitit 2017, Banka Botërore vijoi të mbështesë Autoritetin në zbatimin e projektit të asistencës teknike “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, i fokusuar në zhvillimin e tregut të kapitaleve”. Banka Botërore, nëpërmjet ekspertizës dhe ekspertëve të saj, ka ndjekur në vazhdimësi zhvillimin e këtij projekti të rëndësishëm, i cili është i financuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike Zvicerane (SECO) përmes Grantit (*Trust Fund Grant*).

Gjithashtu, gjatë 2017 Autoriteti i mbështetur nga Banka Botërore filloi zbatimin e projektit “Përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar”, i cili synon të mbështesë dhe ndihmojë rritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve të rregullatorëve financiarë (AMF dhe B.SH.) në monitorimin dhe zbatimin e një cilësie të lartë të raportimeve financiare bazuar në IFRS.

Gjatë vizitave zyrtare të misionëve të Bankës Botërore në Tiranë, përfaqësuesit e Bankës Botërore kanë shprehur vlerësimin e saj të konsiderueshëm lidhur me punën e kryer nga AMF në kuadër të zbatimit të projektit. Stafi i AMF-së në bashkëpunim me konsulentët e projektit dhe mbështetjen e Bankës Botërore kanë punuar intensivisht për të realizuar produktet e projektit me një cilësi të lartë dhe brenda afateve. Ky bashkëpunim i suksesshëm pritet të vijojë edhe gjatë vitit 2018, për të arritur finalizimin e projektit në tremujorin e parë të vitit 2019.

Bashkëpunimi me Korpusin Vullnetar të Shërbimeve Financiare (FSVC)

Një partner shumë i rëndësishëm për AMF-në është dhe Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare (FSVC/USAID). Ndër vite kjo organizatë ka ndihmuar AMF-në në projekte të ndryshme, për forcimin e rolit mbikëqyrës dhe rregullator, si edhe zhvillimin e burimeve njerëzore. Edhe gjatë vitit 2017, AMF dhe FSVC kanë thelluar bashkëpunimin duke vijuar me projektet si Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm (*Early Warning System*), Memorandumin mbi bashkëpunimin mbikëqyrës mes AMF-së dhe BSH-së.

AMF thellon bashkëpunimin me Korpusin Vullnetar të Shërbimeve Financiare

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi një takim me Z. Charles E. Kilbourne, menaxher në zyrat e Korpusit Vullnetar të Shërbimeve Financiare, FSVC-së, në muajin dhjetor 2017. Objekti i takimit ishte thellimi i mëtejshëm i bashkëpunimit dhe nisja e projekteve të përbashkëta midis dy institucioneve.

Nga ana e AMF-së u theksua gatishmëria për vazhdimin e bashkëpunimit me FSVC për të ndihmuar në zhvillimin dhe përmirësimin e aksesit në mikrosigurime për popullsinë me të ardhura të ulëta në vend. Përfaqësuesit e FSVC-së u shprehën të gatshëm për thellimin e bashkëpunimit me Autoritetin duke rritur edhe numrin e projekteve të përbashkëta.

Bashkëpunimi me autoritete homologe në BE

Gjatë vitit 2017, Autoriteti ka pasur në vëmendje zgjerimin dhe forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të tij dypalëshe dhe shumëpalëshe me autoritetet homologe, duke marrë pjesë në takimet apo veprimtaritë e organizuara për njohjen dhe përditësimin me tendencat më të fundit mbikëqyrëse dhe rregullatore, shkëmbimit të përvojave të ndërsjella.

Autoriteti i Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA)

Një partner mjaft i rëndësishëm i AMF-së në zhvillimin e tregjeve financiare nën mbikëqyrje prej vitesh është Autoriteti i Tregjeve Financiare të Austrisë (*FMA*). Bashkëpunimi me FMA-në, është konsoliduar ndër vite edhe materializuar me takime të shpeshta të drejtuesve të lartë të institucioneve, si edhe të stafeve teknike. Prej vitit 2009, të dy institucionet kanë një marrëveshje mirëkuptimi, e lidhur menjëherë pas investimeve të grupeve austriake të sigurimeve në Shqipëri, duke u konkretizuar me shkëmbim përvoje dhe punë të përbashkët në mbikëqyrjen e grupeve austriake që operojnë në Shqipëri.

Në këtë kuadër, një delegacion i nivelit të lartë drejtues të FMA-së bëri një vizitë pune në muajin maj 2017 në AMF dhe zhvilloi takime me drejtues të lartë të këtij Autoriteti. Gjatë takimeve u diskutua për çështje të rëndësishme të interesit të përbashkët si dhe u pasqyruan zhvillimet e fundit për tregjet e sigurimeve të Austrisë dhe Shqipërisë. Ndërmjet të tjerash, takimet u përqendruan në zhvillimet e reja të tregut të sigurimeve gjatë zbatimit të *Solvency II* në tregjet që mbikëqyren.

AMF është pjesëmarrëse e rregullt e kolegjeve mbikëqyrëse të “*UNIQA Insurance Group*” (UIG) dhe “*Vienna Insurance Group*” (VIG). Ekspertët e departamentit të mbikëqyrjes të AMF-së në vitin 2017 morën pjesë në mbledhjet dy ditore të Kolegjit të Mbikëqyrjes të Grupit UIG dhe atij të Grupit VIG.

IVASS dhe CONSOB – ITALI

Në kuadrin e zgjerimit të marrëdhënieve dypalëshe me autoritetet homologe, drejtues të nivelit të lartë të AMF-së, në korrik të vitit 2017 zhvilluan takime pune të nivelit të lartë me zyrtarë të Institutit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Italisë (*IVASS*), dhe Komisionit Kombëtar për Shoqëritë dhe Bursën, (*CONSOB*). Në këto takime u diskutua mbi forcimin e marrëdhënieve midis rregullatorëve nëpërmjet asistencës teknike, trajnimeve, si dhe u ra dakord për hartimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe të mirëkuptimit si me *IVASS* ashtu dhe me *CONSOB*.

Bashkëpunimi Rajonal

Edhe në vitin 2017 ka vijuar bashkëpunimi me institucionet homologe të rajonit, nëpërmjet takimeve të përbashkëta pune, shkëmbimit të informacionit dhe eksperiencave në aspektin

rregullator e mbikëqyrës me synim rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes së tregjeve financiare jobankare.

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë (ISA)

AMF ka bashkëpunuar ngushtë me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë (ISA). Marrëveshja e Mirëkuptimit midis dy institucioneve, e cila është në veprim që prej vitit 2010 ndikon pozitivisht në efikasitetin e mbikëqyrjes dhe rregullimit të industrisë së sigurimeve të të dy vendeve, sidomos në kushtet e shtrirjes së veprimtarisë të shoqërive shqiptare të sigurimit në territorin e Maqedonisë. Në mënyrë periodike, dy autoritetet rregullatore zhvillojnë takime të përbashkëta pune që kanë për qëllim forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit për një mbikëqyrje efektive dhe dinamike të tregut të sigurimeve në të dy vendet.

Gjatë 2017 bashkëpunimi ka vijuar me vizita zyrtare të nivelit të lartë bilateral të AMF-së dhe ISA-s në muajin korrik, në Tiranë dhe në muajin shtator, në Shkup, me qëllim koordinimin dhe bashkëveprimin mes dy institucioneve, edhe përmes hartimit të një plani të përbashkët pune. Autoritetet rregullatore të të dy vendeve tashmë po përballen me të njëjtat sfida të mbikëqyrjes, kanë në përdorim të njëjtën platformë elektronike raportimi, kanë të përbashkët përpjekjen për zbatimin e direktivave të Bashkimit Evropian në procesin e integritetit, si edhe po zbatojnë projektin e përbashkët për mbrojtjen nga katastrofat natyrore me mbështetjen e Bankës Botërore.

Banka Qendrore e Kosovës (BQK)

Bashkëpunimi i AMF-së me Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) vijoi të forcohet edhe gjatë vitit 2017. Në kuadër të thellimit të bashkëpunimit midis dy autoriteteve, një delegacion nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe Byrosë Kosovare të Sigurimeve zhvilloi në muajin dhjetor 2017, një takim pune pranë zyrave të AMF-së, me praninë edhe të drejtuesve ekzekutivë të shoqërive shqiptare të sigurimit, të cilat e kanë shtrirë aktivitetin e tyre edhe në Kosovë. Takimi synonte forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit si në drejtim të shkëmbimit të informacionit, përvojave teknike e profesionale për një mbikëqyrje sa me efektive, ashtu edhe diskutimit të problematikave që lidhen me mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregjeve respektive, apo të disa çështjeve specifike për byrotë e sigurimeve përkatëse.

Iniciativa Rajonale për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE)

AMF është pjesëmarrës aktiv në nismën rajonale “Iniciativa Rajonale për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore”, (CESEE), e cila konsiderohet e suksesshme, nisur nga interesimi i vazhdueshëm dhe pjesëmarrja aktive e vendeve të rajonit, duke ruajtur dhe nxitur më tej frymën e bashkëpunimit efektiv mbi

çështjet dhe problematikat e përbashkëta që hasen në rregullimin e tregjeve të sigurimeve në rajon. Gjatë vitit 2017 janë zhvilluar dy takime të kësaj iniciative, në Bratislavë, Sllovaki dhe Zagreb, Kroaci. Në takimin e trembëdhjetë në Sllovaki çështjet e trajtuara lidheshin me zbatimin praktik të Direktivës së re të BE-së, “Shpërndarja në sigurime”, si dhe problematikat e hasura gjatë transpozimit të saj në legjislacionin kombëtar të çdo vendi. Sipas kësaj direktive, të datës 23 shkurt 2018, shpërndarësit në sigurime duhet të veprojnë në përputhje me rregullat e reja.

Në takimin e katërbëdhjetë në Kroaci, u trajtuan sfidat e mbikëqyrjes me bazë rreziku, sfidat dhe eksperiencat e rregullatorëve në drejtim të vënies në zbatim të regjimeve të reja mbikëqyrëse, qasja e tregjeve ndaj kërkesave të reja, mbikëqyrja e grupeve të sigurimit, si dhe mënyrat e rritjes së bashkëpunimit midis rregullatorëve të rajonit. Në këtë takim, moderator i temës “Mbikëqyrja me Bazë Risku” ishte një përfaqësues i AMF-së. **Takimi i ardhshëm i kësaj iniciative, në pranverën e vitit 2018 do të zhvillohet në Shqipëri, nën kujdesin organizativ të AMF-së.**

Takimi Autoriteteve të Tregut të Kapitalit të gjashtë të vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6)

Në muajin dhjetor, AMF mori pjesë në takimin e parë të Autoriteteve të Tregut të Kapitalit të gjashtë të vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6) “Diversifikimi i sistemeve financiare për të rritur investimet”.

Takimi shqyrtoi mundësitë për integrimin e tregjeve financiare në rajon dhe konkretisht të tregjeve të kapitalit, duke vlerësuar edhe nevojën për një strategji rajonale për zhvillimin e tregjeve të kapitalit. Përfaqësuesi i Shqipërisë bëri një prezantim mbi zhvillimin e tregjeve të kapitalit në Shqipëri dhe sfidat me të cilat përballen ato.

5.3 Proceset integruese për tregjet nën mbikëqyrje

Roli i AMF-së në integrimin evropian

AMF ka bërë përpjekje pozitive për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm të shërbimeve financiare me *acquis*. Legjislacioni aktual i Shqipërisë në fushën e shërbimeve financiare përbën një bazë të fortë për një harmonizim të mëtejshëm dhe të plotë me legjislacionin evropian. Në fushën e shërbimeve financiare jobankare është konsoliduar puna për rishikimin e kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës duke synuar përafrimin e mëtejshëm të tij me *acquis* e BE-së dhe është bërë progres në përafrimin e legjislacionit të tregut të sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensione private. AMF, si institucion kontribues në këtë proces, ka punuar intensivisht përsa i përket përafrimit të kuadrit ligjor, gjë që nënvizohet edhe në Progres Raportin e fundit të BE-së.

Gjithashtu AMF ka vazhduar të japë kontributin e saj në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Raporti i Progresit dhe Planit Kombëtar i Integritimit Evropian. Ajo koordinon dhe përgatit raportimet në lidhje me Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare” dhe Kriterin Ekonomik.

AMF gjithashtu ka monitoruar rregullisht zbatimin e MSA-së, si dhe të Planit Kombëtar për Integritimin Evropian. Ajo ka marrë pjesë në takimin e Komitetit të Stabilizim-Asociimit, si edhe në takimet e radhës të nënkomiteteve përkatëse. Kështu gjatë vitit 2017 AMF ka kryer raportime të suksesshme në kuadër të Integritimit Evropian me konkretisht:

- Takimi i 9-të i Nënkomitetit Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca duke përfshirë Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Shëndetit - 17 tetor 2017;
- Takimi i 9-të i Nënkomitetit Çështjet Ekonomike – Financiare & Statistikat - 28 shtator 2017;
- Komiteti i 8-të i Stabilizim – Asociimit - 4 tetor 2017.

Vlerësimi i palës evropiane gjatë këtyre raportimeve ishte pozitiv për veprimtarinë e AMF-së dhe rekomandimi i vetëm në kuadër të këtyre takimeve për AMF-në ishte miratimi i projektligjit “Për sigurimin e detyrueshëm motorik në sektorin e transportit”.

Gjatë vitit 2017, AMF ka vazhduar bashkëpunimin me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme si institucioni koordinues në procesin e integritimit evropian. AMF ka përgatitur raporte, të cilat pasqyrojnë progresin e arritur duke kontribuar në hartimin e dokumenteve që lidhen me procesin e Stabilizim-Asociimit. Kyçi i suksesit të Shqipërisë në rrugën e integritimit evropian është zbatimi i shpejtë i reformave, përmes aktiviteteve të planifikuara, në një nga dokumentet bazë siç është Planit Kombëtar i Integritimit Evropian (PKIE) për periudhën 2017-2020, i cili shërben si bazë për planifikimin e procesit të integritimit evropian të Shqipërisë. AMF gjatë vitit 2017 ka përcjellë në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme informacione periodike për monitorimin e realizimit të PKIE 2017-2020 për kapitujt “Shërbimet Financiare” dhe “Kriteri Ekonomik”, si dhe ka punuar për përditësimin e këtij plani për periudhën 2017-2020, si një nga instrumentet kryesore për planifikimin dhe monitorimin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë.

Edhe gjatë vitit 2017 Autoriteti në cilësinë e koordinatorit të Kapitullit 9 “Shërbimet Financiare” ka zhvilluar takime mujore të GNPIE-së për Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, pjesë e të cilit është edhe Banka e Shqipërisë, sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 107, datë 28.02.2014 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integritimin evropian”, si dhe ka marrë pjesë edhe në takimet mujore të GNPIE-ve të Kapitullit “Kriteri ekonomik” dhe Kapitullit 3 “E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime” si anëtare e këtyre grupeve ndërinstitucionale.

Autoriteti gjatë vitit 2017 ka vlerësuar dhe shfrytëzuar instrumentin e asistencës afatshkurtër *TAIEX (Technical Assistance and Information Exchange)*, i cili ofrohet nga BE për të ndihmuar vendet kandidate dhe kandidate potenciale, në drejtim të njohjes dhe zbatimit të legjislacionit të BE-së. Të gjitha aplikimet në kuadër të instrumentit *TAIEX* kryhen në bazë të direktivave evropiane, duke parashtruar argumentimet përkatëse të nevojës së këtij instrumenti, si dhe qëllimin dhe objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij instrumenti. Aktivitetet e zhvilluar në kuadër të *TAIEX* kanë si qëllim forcimin e kapaciteteve të punonjësve të AMF-së për njohjen me legjislacionin dhe praktikën më të mira evropiane. Kështu gjatë vitit 2017 u krye aplikimi i suksesshëm dhe organizimi i aktiviteteve të mëposhtme të instrumentit të asistencës afatshkurtër *TAIEX*:

1. Vizitë studimore “Mbi licencimin dhe mbikëqyrjen e ndërmjetësve në sigurime”. Ky aktivitet u organizua nga Komisioni Evropian në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Hungarisë (*Magyar Nemzeti Bank*), në Budapest, Hungari. Zhvillimi i këtij aktiviteti ishte në formën e shkëmbimit të eksperiencave, sesione prezantimesh nga organizatorët si dhe diskutime nga pjesëmarrësit pas çdo tematike.

2. Misioni i Ekspertëve “Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit”. Ky aktivitet u organizua nga Komisioni Evropian në bashkëpunim me Autoritetin Italian të Sigurimeve (IVASS), në ambientet e AMF-së, me ekspertë italianë. Qëllimi i këtij *Expert Mission* ishte shkëmbimi i njohurive në fushën e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, veçanërisht në funksionimin e sistemit *Bonus-Malus*, shlyerjen dhe trajtimin e dëmshpërblimeve.

Misioni mundësoi edhe diskutimin e një sërë çështjesh dhe problematikash të hasura nga ekspertët dhe pjesëmarrësit në punën e tyre të përditshme mbikëqyrëse dhe rregullatore, si dhe në lidhje me zbatimin e rregullave të ndryshme për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit.

4. Misioni i Ekspertëve “Për rregullat e reja të BE-së mbi abuzimin e tregut dhe tregtimin e brendshëm në fushën e titujve. Ky trajnim u organizua nga Komisioni Evropian në bashkëpunim me Autoritetin e Shërbimeve Financiare të Maltës (MFSA). Qëllimi i këtij *Expert Mission* ishte shkëmbimi i njohurive në fushën e titujve, duke u fokusuar në çështjet që lidheshin me rregullat e reja të BE-së dhe kërkesat kryesore të regjimit të ri të abuzimit të tregut. Misioni mundësoi diskutimin dhe shkëmbimin e eksperiencave në lidhje me zbatimin e rregullave të ndryshme mbi abuzimin e tregut dhe tregtimin e brendshëm në fushën e titujve.

Zhvillime të reja rregullative të BE-së

IORP II: Direktiva e re Evropiane e Fondeve të Pensioneve

Më 23 dhjetor 2016, Direktiva e shumëpritur "*IORP II*" u botua në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Kjo direktivë është pasardhëse e Direktivës 2003/41/BE *IORP I*, e cila daton më 3 qershor 2003 dhe që përcaktonte dispozita në lidhje me aktivitetet dhe mbikëqyrjen e institucioneve për ofrimin e pensioneve profesionale (*IORPs*). Direktiva e *IORP II*, ashtu si *IORP I*, përmban një numër standardesh të përbashkëta të cilat duhet të përfshihen në ligjin kombëtar dhe të zbatohen përkatësisht.

Rregullat e reja, krahasuar me direktivën e mëparshme, kanë si qëllim:

- Të sigurojnë që pensionet profesionale të kenë stabilitet dhe të mbrojnë më mirë anëtarët dhe përfituesit e skemës së pensioneve;
- Të informojë më mirë anëtarët dhe përfituesit për të drejtat e tyre;
- Të heqin pengesat me të cilat ballafaqohen fondet e pensionit profesional që funksionojnë përtej kufijve;
- Të inkurajojnë fondet e pensionit profesional për të investuar në mënyrë afatgjatë në aktivitetet ekonomike që ndikojnë në rritjen ekonomike, mjedisin dhe punësimin;
- Direktiva hyri në fuqi më 13 janar 2017, por është e zbatueshme vetëm që nga 13 janari 2019. Shtetet anëtare kanë deri atëherë kohë të transpozojnë këtë direktivë në legjislacionin e brendshëm.

5.4 Procesi i Vlerësimit në kuadrin e *MONEYVAL*

Gjatë vitit 2017 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në kuadrin e raundit të pestë të vlerësimit të Shqipërisë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, u angazhua në procesin e dhënies së përgjigjeve të pyetësorit të përgatitur nga Komiteti *MONEYVAL* i Këshillit të Evropës për çështjet që lidhen me tregjet financiare jobankare. Në muajin tetor 2017, u zhvilluan takime me ekipin vlerësues të këtij raundi, të përbërë nga ekspertë të Komitetit *Moneyval* të KE-së. Autoriteti gjatë këtij procesi vlerësimi ka dhënë kontribut në plotësimin e dy pyetësorëve (mbi efektivitetin dhe teknike).

Komiteti *MONEYVAL* i Këshillit të Evropës (KE) gjithashtu ka organizuar takimet e subjekteve në mbikëqyrje në lidhje me vizitën në vend të ekspertëve të Komitetit *MONEYVAL KE*, në kuadër të vlerësimit të Shqipërisë.

Për vitin 2018 është planifikuar që procesi i mbikëqyrjes sipas këtij manuali të vijojë edhe në shoqëritë nën mbikëqyrje, të cilat do të jenë subjekt i inspektimeve të plota.

Gjithashtu në kuadër të pastrimit të parave, bazuar në manualin me fokus rrezikun për Parandalimin e Pastrimit të Parave, AMF gjatë vitit 2017 ka kryer një inspektim në bashkëpunim me DPPP-në (Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave). Fokusi i

inspektimit ishin verifikimet lidhur me respektimin e kuadrit ligjor në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe masat kundër financimit të terrorizmit.

5.5 Projekte

Projekti “Përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar” me komponent “Përmirësimi i kapaciteteve të regullatorëve financiar”.

Në kuadër të projektit në rang kombëtar “Përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar (REPARIS), AMF është përfitues i komponentit të dytë të projektit “Përmirësimi i kapaciteteve të regullatorëve financiarë në monitorimin dhe kontrollin e zbatimit më të mirë të raportimit financiar” Ky komponent i projektit është financuar nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), administrohet nga Banka Botërore dhe ekzekutohet nga Ministria Financave dhe Ekonomisë. Projekti ka filluar me nënshkrimin e kontratës në muajin korrik 2017 dhe pritet të zgjasë për një periudhë 18 mujore. Gjatë vitit 2017, pasi u arrit dakordësimi i termave të referencës filloi faza e parë e projektit “Trajnimi mbi SNRF-të me fokus në sigurime dhe fonde”. Kështu, gjatë muajve tetor - dhjetor ka filluar trajnimi i stafit të AMF-së, për standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF-të). Për institucionet mbikëqyrëse, qëllimi kryesor i projektit është të mbështesë dhe ndihmojë rritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve të rregullatorëve financiarë (AMF & BSH) në monitorimin dhe zbatimin e një cilësie të lartë të raportimeve financiare bazuar në SNRF-të. Projekti do të përmirësojë kapacitetet e institucioneve të rëndësishme të kontrollit financiar në nivel ekspertize, trajnimesh, sistemi dhe kapaciteti rregullator, si dhe në drejtim të përshtatjes dhe adoptimit të standardeve me të larta të legjislacionit të BE-së dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

Projekti i Mikrosigurimeve “Akses në Iniciativën e Sigurimeve” (A2ii)

Ky projekt mbështetet dhe financohet nga Iniciativa për Akses në Sigurime (*Access to Insurance Initiative*) në bashkëpunim me Akademinë për Udhëheqje Globale të GIZ (*GIZ Global Leadership Academy*). Projekti synon të promovojë bashkëpunimin shumë palësh, të mësuarit nga kolegët ndërkombëtarë dhe zhvillimin e zgjidhjeve inovative që do të rrisin pranimin e sigurimeve në popullatën me të ardhura të ulëta si dhe bizneseve të vogla. Projekti bashkon një gamë të gjerë të aktorëve gjithëpërfshirës të fushës së sigurimit të përfshirë në 4 ekipet e vendeve të përzgjedhura, për të mundësuar një zgjidhje inovative, në drejtim të rritjes së shkallës së përfshirjes së grupeve vulnerabël në skemat e sigurimit vullnetar.

Pas aplikimit të suksesshëm gjatë muajit maj, Shqipëria u përzgjedh si një nga vendet fituese dhe pjesëmarrëse në këtë projekt. Projekti nisi konkretisht në muajin nëntor 2017 dhe do të ketë një kohëzgjatje prej 12 muaj, deri në muajin nëntor 2018.

Shqipëria ka krijuar skuadrën kombëtare me përfaqësues nga shoqëritë e sigurimit, banka, agjenci kreditimi si edhe organizma të tjerë që kanë aktivitet në fushën financiare dhe të biznesit, e cila do të punojë për të adresuar në një mënyrë të re sfidat me të cilat përballlet

industria e sigurimeve në vend lidhur me mikro-sigurimet, si sigurime vullnetare gjithëpërfshirëse.

Në muajin dhjetor 2017 u organizua workshopi i parë kombëtar në Shqipëri. Këtë aktivitet e përshëndetën drejtues të lartë të AMF-së dhe Iniciativës për Akses në Sigurime.

Projekti “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve”

Projekti “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve” synon të mbështesë AMF-në në forcimin e kapaciteteve të saj në mbikëqyrjen e tregut të fondeve të investimeve dhe tregjet e obligacioneve të korporatave dhe atyre të qeverisë vendore. Ky projekt është mbështetur nga Banka Botërore, e cila do të ndjekë edhe zbatimin e tij, ndërsa Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) është financues i këtij projekti përmes Grantit (*Trust Fund Grant*).

Projekti i cili ka filluar të zbatohet në muajin korrik 2016, ka një kohëzgjatje prej 36 muajsh dhe pritet të përfundojë në muajin mars të vitit 2019. Ai është hartuar për të përballuar sfidat me të cilat po përballlet AMF dhe fushat që mbulon ky projekt janë kryesisht:

- Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për mbikëqyrjen dhe rregullimin e fondeve të investimeve. Në këtë komponent synohet të kryhen vlerësimet diagnostikuese, të zhvillohet paketa e mbikëqyrjes (metodologjia, manualët dhe mjetet), si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore;
- Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për t’u përgatitur për emetimet e obligacioneve të shoqërive aksionare dhe atyre të qeverisë vendore. Në këtë komponent synohet të kryhen vlerësimet diagnostikuese, si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në fushën e instrumenteve dhe tregjeve të borxhit.

Gjatë vitit 2017 është kryer një punë intensive në kuadër të zbatimit dhe zbatimit të tre fazave të këtij projekti. Në vijim të përfundimit të fazës së parë, AMF ndërmori gjatë vitit 2017 veprimet e mëposhtme:

- Përgatitja e një plani veprimi në vijim të rekomandimeve të konsulentëve, i cili u miratua në mbledhjen e Bordit të datës 19.06.2017;
- Përmirësimi i strukturës organizative në përputhje me rekomandimet e konsulentëve. Gjithashtu, një punë intensive është kryer edhe në drejtim të zbatimit të fazës së dytë të projektit duke realizuar përfundimin e një sërë raportesh. Në vijim të rekomandimeve të konsulentëve, ka filluar puna për rishikimet ligjore të dy ligjeve të Fondeve të Investimit dhe Titujve, si dhe rregulloreve përkatëse.

Gjatë vitit 2017 ka filluar gjithashtu puna për zbatimin e fazës së tretë të projektit lidhur me zhvillimin e kapaciteteve dhe trajnimet e stafit, ku gjatë 6 mujorit të dytë të vitit 2017 filluan edhe trajnimet për stafin e AMF-së.

Projekte me asistencë teknike të Korpusit Vullnetar të Shërbimeve Financiare – FSVC

Projektet e mbështetura nga FSVC gjatë vitit 2017 janë si më poshtë:

- Sistemi paralajmërimit të hershëm (*Early Warning System*). Gjatë vitit 2017 ka vijuar puna për ndjekjen e zbatimit të sistemit të paralajmërimit të hershëm. Në muajin shtator një ekspert asistoi AMF-në në temën e ndjekjes së zbatimit të një sistemi të paralajmërimit të hershëm. Në një ekip të përbashkët me stafin e AMF-së, u hartua një plan për një platformë të mbikëqyrjes së sigurimeve, e cila përfshin kriteret e paralajmërimit të hershëm. Zbatimi do të përfshijë gjithashtu automatizimin nëpërmjet një pakete *Business Intelligence (BI)*, që do të zgjidhet dhe instalohet nga stafi i TI pranë Autoritetit.
- Memorandumi mbi bashkëpunimin mbikëqyrës mes AMF-së dhe BSH-së. Puna për hartimin e një skeme për memorandumin e bashkëpunimit mes BSH-së dhe AMF-së filloi gjatë muajit maj 2017, pasi të 2 Autoritetet mbikëqyrin veprimtarinë e institucioneve financiare, të ndërlidhura midis tyre. Konsulenti i FSVC-së në bashkëpunim me departamentet e mbikëqyrjes të AMF-së dhe BSH-së punuan për hartimin e skemës së bashkëpunimit mes dy mbikëqyrësve, draft i cili u dërgua në AMF në fund të muajit qershor.

II. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL I AMF-së

II.1 Kuadri ligjor dhe rregullator i AMF-së

Gjatë vitit 2017, me qëllim përmirësimin e kuadrit të brendshëm rregullator të Autoritetit, që rregullon organizimin dhe funksionimin e tij u ndryshuan aktet si më poshtë:

- Rregullorja nr. 130, datë 31.08.2017 “Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e detyrave”, shfuqizoi pjesët respektive të Rregullores nr. 136, datë 21.12.2015, duke përcaktuar normat e përgjithshme që rregullojnë organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e strukturës dhe të detyrave kryesore të çdo departamenti, drejtorie, sektori dhe njësie të administratës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare si dhe procedurat e komunikimit ndërmjet tyre;
- Rregullorja nr. 13, datë 03.02.2017, bëri ndryshime në Rregulloren nr. 129, datë 26.11.2015 "Për marrëdhëniet e punës të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare".;
- Me rregulloret nr. 138, datë 28.09.2017 dhe nr. 164, datë 30.11.2017, pësoi ndryshime Rregullorja nr. 155, datë 23.12.2014 “Për përcaktimin e elementëve të përlogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre”. Shtesat dhe ndryshimet në rregulloren nr. 118, datë 19.09.2011 "Për kartën e auditimit të brendshëm", janë reflektim i ndryshimeve në ligjin për auditimin e brendshëm në sektorin publik, të tilla si përkufizimi i Kartës së Auditimit të Brendshëm, misioni i audituesit të brendshëm;
- Udhëzimi nr.76, datë 28.07.2015 “Për shpërblimet e anëtarëve jo ekzekutivë dhe pagat e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, Nëndrejtorit Ekzekutiv dhe të punonjësve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, pësoi shtesa dhe ndryshime me Vendimin e Bordit 131, datë 31.08.2017.

Gjithashtu gjatë vitit 2017 u bënë rregullimet përkatëse me qëllim përputhjen e emërtimeve me ndryshimet në ligjin dhe në strukturën organizative të AMF-së, si më poshtë:

- Rregulloren nr. 177, datë 13.12.2011 “Mbi organizimin e veprimtarisë kërkimore në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, e ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 152, datë 30.11.2017;
- Rregulloren nr. 17, datë 21.03.2007 “Për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave të subjekteve të licencuara, autorizuar dhe miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare”, e ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 152, datë 30.11.2017;
- Rregulloren nr. 118, datë 19.09.2011 “Për kartën e auditimit të brendshëm”, e ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 214, datë 28.12.2017.

II.2 Politika e Burimeve Njerëzore

Bordi i AMF-së, bazuar në Ligin nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, në muajin qershor të vitit 2017, miratoi strukturën e AMF-së me Vendimin nr. 69, datë 19.06.2017 “Për miratimin e strukturës organizative, numrin e punonjësve dhe përshkrimet e punës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”.

Gjatë vitit 2017 pas një procesi konkurrence është plotësuar struktura me një Audit të Teknologjisë së Informacionit. Gjithashtu struktura e re parashikoi edhe pozicionin e përgjegjës të zyrës së auditit të brendshëm, i cili u shpall si vend vakant dhe u konkludua në vitin 2018.

Modeli i strukturës së re u mbështet duke ruajtur në koncept strukturën ekzistuese, por u riformatua për të mundësuar një hierarki të përshtatshme për punonjësit, mbulimin më të mirë të funksioneve në Autoritet, një koordinim më efektiv ndërmjet njësive në funksion të një vendimmarrje më efikase.

Organizimi i ri strukturor u realizua duke patur synim promovimin e stafit dhe kryesisht të punonjësve që kanë një përvojë të gjatë pune në autoritet, por që në të njëjtën kohë posedojnë aftësi shumë të mira profesionale dhe kualifikime që i përgjigjen kërkesave të zhvillimit të Autoritetit.

Gjithashtu dinamika e zhvillimit të tregjeve dhe praktikat e autoriteteve të tjera homologe përbënë një bazë të rëndësishme në propozimet për ndryshimet e strukturës.


Garantimi i një strukture organizative fleksibël si dhe forcimi i kapaciteteve administrative të AMF-së ka qenë një kërkesë e vazhdueshme e Bankës Botërore dhe Komisionit Evropian, në funksion të një mbikëqyrjeje efektive dhe të shëndoshë.

Në përgjigje të zhvillimeve të tregut të kapitalit dhe investimeve, risia në strukturën e re konsistoi në ndarjen e departamenteve me funksione mbikëqyrëse duke krijuar një njësi të posaçme për mbikëqyrjen e tregjeve të kapitalit dhe fondeve të investimit e atyre të pensionit. Struktura e re konsiderohet si një plan strukturimi dhe plotësimi strukturash afatmesëm, e cila do të rishikohet në bazë të zhvillimeve që mund të vërehen në tregjet financiare, ku pesha kryesore e punonjësve do të jetë në strukturat mbikëqyrëse.

Struktura e re u shoqërua me një rritje të vogël të numrit të punonjësve duke e shtuar atë me 3 punonjës. Numri në total i punonjësve të miratuar në fund të vitit 2019 është 100 punonjës. Për vitin 2017, shkalla e plotësimit të vendeve të punës e matur me numrin e miratuar të punonjësve për vitin 2017 është në masën 94%.

Bazuar në strukturën e re organizative, shpërndarja e punonjësve sipas funksioneve të AMF-së dhe profesioneve jepet si më poshtë:


Grafik 33: Struktura e punonjësve të funksioneve kryesore të AMF-së sipas njësive
(në numër)




77% e numrit të punonjësve të AMF-së i përkasin njësive që kryejnë funksione kryesore, të cilat lidhen me detyrat bazë të AMF-së, të tilla si licencimi, rregullimi e mbikëqyrja. Në këtë grup janë përfshirë edhe të emëruarit në nivelin e lartë drejtues. Pjesa tjetër, rreth 23% janë punonjës të angazhuar në funksionet mbështetëse, që mundësojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të institucionit.

Grafik 34: Struktura e punonjësve sipas profesionit

(në numër)



Grafik 35: Struktura e punonjësve të AMF-së sipas grupmoshës



Prej disa vitesh është ruajtur niveli mesatar i moshës mesatare në 39 vjeç, gjë ka sjell harmonizimin më të mirë të cilësive të brezave të ndryshëm dhe ka siguruar transmetim të pandërprerë të njohurive dhe përvojës.

Rreth 72% e stafit janë femra, të cilat mbajnë më shumë pozicione drejtuese krahasuar me meshkujt.

Politikat e Burimeve Njerëzore

Drejtimi i burimeve njerëzore në AMF realizohet në përputhje me misionin dhe objektivat strategjike të tij. Qëllimi kryesor në fushën e burimeve njerëzore edhe për vitin 2017, është zhvillimi i profesionalizmit të punonjësve, motivimi i tyre për arritjen e objektivave, si dhe punësimi i burimeve njerëzore gjithnjë e më cilësore.

Punësimi i burimeve sa më të afta njerëzore vazhdoi të jetë përparësi në kuadrin e politikave të burimeve njerëzore. Për vitin 2017, nëpërmjet procedurave transparente të punësimit, u mundësua punësimi i 22 punonjësve që zotërojnë aftësi të mira profesionale, me kërkesë për vetëzhvillim profesional dhe integritet të lartë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar punësimit të të rinjve që janë diplomuar apo kualifikuar me rezultate të larta dhe me dëshirë për dedikim në punë.

Politika e punësimit ka parim bazë ndërthurjen e drejtë të brezave dhe harmonizimin e natyrshëm të përvojave. Nëpërmjet nxitjes dhe motivimit të punonjësve synohet rritja e cilësisë së punës. Në funksion të kësaj politike, AMF ka përdorur mjete dhe mekanizmat nxitës për tërheqjen dhe mbajtjen e kapaciteteve profesionale. Në këtë aspekt, përmendim sistemin e ndihmave ekonomike, sistemin e diferencuar të shpërblimeve për arritjen e rezultateve në punë, zbatimin e planit profesional të pensionit suplementar për punonjësit e Autoriteti, si dhe sigurimin e shëndetit dhe jetës për punonjësit e saj.

Kualifikimi profesional

Në drejtim të kualifikimit profesional, me qëllim rritjen e ekspertizës profesionale, edhe gjatë vitit 2017 u ruajt përgjithësisht linja e specializimit të punonjësve në profilin ku ata punojnë. Programi i trajnimeve është ndërtuar në përshtatje me objektivat e institucionit dhe objektivat individualë për punonjësit. Procesi i trajnimit mundëson:

- Trajnimin bazë për punonjësit e punësuar rishtazi në Autoritet;
- Trajnimin e specializuar të punonjësve të tjerë.

Aktivitetet e realizuara për vitin 2017, brenda dhe jashtë vendit, kanë konsistuar në pjesëmarrje në trajnime, seminare, konferenca, takime, si dhe vizita në shkëmbimin e përvojave me të mira profesionale, mbështetur në asistencën e institucioneve prestigjioze ndërkombëtare në fushën financiare si: Banka Botërore (BB), Këshilli i Evropës, *USAID* nëpërmjet Programit të Zhvillimit të Sektorit Financiar në Shqipëri, si edhe shoqatave ndërkombëtare të rregullatorëve, Shoqata Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (*IAIS*); Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë (*IOSCO*); Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrjes së Pensioneve (*IOPS*); Shoqata Kombëtare e Komisionerëve të Sigurimeve e SHBA-së (*NAIC*), etj.

Aktivitetet dhe trajnime të rëndësishme kanë vijuar përgjatë vitit 2017. Pjesëmarrja në trajnime të specializuara të organizuara nga autoritetet homologe apo dhe institucionet financiare ndërkombëtare përveç rritjes së njohurive profesionale i shërben stafit të Autoritetit edhe për shkëmbimin e përvojave profesionale dhe menaxheriale me përfaqësuesit e autoriteteve homologe nga vendet e tjera.

Me rëndësi të veçantë në forcimin e kapaciteteve në fushën e tregut të letrave me vlerë është programi i *SECO*.

Po ashtu në kuadër të asistencës për tregun e sigurimeve dhe pensioneve, AMF në bashkëpunim me BB ka zhvilluar disa projekte të rëndësishme që lidhen drejtpërsëdrejti me funksionet mbikëqyrëse dhe rregulluese të tregjeve nën mbikëqyrje.

II.3 Sistemet e Teknologjisë së informacionit

Viti 2017 është karakterizuar nga një zhvillim cilësor në infrastrukturën e brendshme të sistemeve informatike. Janë ndërtuar dhe zhvilluar metodat më të fundit dhe bashkëkohore në ndërtimin e sistemeve të virtualizimit me disponueshmëri të lartë.

Sistemi In-Reg

AMF *In-Reg* përbëhet nga një sërë komponentësh aplikativë që bashkëpunojnë për të realizuar aktivitetin primar për të cilin është krijuar ky sistem. Sistemi është një platformë raportimi *web*, nëpërmjet të cilës operatorët e subjekteve të mbikëqyrura raportojnë të dhënat e kërkuara nga Autoriteti në mënyrë elektronike nëpërmjet internetit.

Format raportuese janë një tjetër komponent i tërësisë së sistemit AMF *In-Reg Firms* (ndërfaqja që mundëson procedurën e raportimit të operatorëve në mbikëqyrje të AMF-së). Ato janë projektuar, ndërtuar dhe zbatuar në përshtatje me aplikacionin *Vizor Builder*.

Sistemi Qendror në dhomën e serverave


Teknologjia e Informacionit (TI) në AMF është zhvilluar në përputhje me strategjinë kombëtare të informatizimit, si pjesë e pandarë e institucionit duke pasur si objekt pune zhvillimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e strukturës informatike.

Gjatë vitit 2017, sistemet kryesore të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TI) në AMF kanë funksionuar në mënyrë të vazhdueshme duke siguruar mbështetjen e funksioneve bazë të Autoritetit. Sistemet e TI-së në Autoritet kanë siguruar edhe koordinimin e punës me institucionet me të cilat Autoriteti ka bashkëpunim për shkëmbimin e informacionit, si DPSHTRR, AKSHI dhe Ministria e Brendshme.

II.4 Auditimi i Brendshëm

Aktiviteti i Njesisë së Auditimit është bazuar mbi zbatimin e lanit Vjetor të miratuar nga Bordi i Autoritetit për vitin 2017. Njësia e auditimit të brendshëm ka funksionuar me një auditues të profilit të përgjithshëm financiar, i pajisur me certifikatën e audituesit të brendshëm në sektorin publik dhe një auditues i teknologjisë së informacionit dhe vlerësimit të riskut. Veprimtaria audituese është bazuar në procedurat e auditimit të rregulluara në aktet ligjore në fuqi dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm. Me qëllim garantimin e një efience sa më të lartë, i është kushtuar vëmendje procesit të vlerësimit paraprak të riskut, në përputhje me fushën për auditim. Nga analiza e treguesve më specifik të auditimit rezulton se ato kanë ndryshuar në vite, të ndikuara si nga numri i auditimeve, ashtu dhe nga specifikat e objekteve apo fushat e nën audituara. Natyra e 19 gjetjeve të auditimit i referohet kryesisht parregullsive në zbatimin e procedurave, ndërsa 57 rekomandime kanë synim përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, uljen e nivelit të riskut në këto sisteme dhe dhënien e këshillave për zgjedhje që mundësojnë parandalimin e rasteve të shkeljeve në të ardhmen. Gjetjet dhe rekomandimet janë raportuar te Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe te Bordi i Autoritetit.

Grafik 36: Zbatimi i Rekomandimeve për vitin 2017



II.5 Transparenca dhe marrëdhëniet me publikun

Një ndër prioritetet e punës së Autoritetit, gjatë vitit 2017 ka qenë komunikimi me publikun e gjerë dhe grupet e veçanta të popullsisë, me synim rritjen e transparencës dhe informacionit cilësor për tregjet financiare nën mbikëqyrje të ofruar nga AMF, si dhe zgjerimi gjithnjë më i madh i publikut të interesuar për aktivitetin e tij. Autoriteti i zgjeroi më tej format e

komunikimit publik si bashkëpunim me median e shkruar dhe elektronike, komunikimet elektronike nëpërmjet faqes *online* të AMF-së, takimet e drejtpërdrejta me grupe të veçanta të interesit dhe takime tematike për tregjet financiare nën mbikëqyrje. Pasqyrimi në median tradicionale i informacioneve për aktivitetet e AMF-së dhe tregjet financiare ka vazhduar të rritet gradualisht nga viti në vit.

Për t'i shërbyer sa më shumë thithjes së audiencave të reja AMF ndërtoi edhe faqen e saj në *Facebook*. Që nga krijimi deri në fund të muajin dhjetor 2017, në faqe janë hedhur 77 postime të ndryshme, lajme të shkurtra me foto, albume fotografike, grafikë shoqëruar me përshkrime të shkurtra, video, njoftime të ndryshme, shpërndarje linkesh nga faqe të tjera, etj. Që prej hapjes së saj më 10 tetor faqja e AMF-së në *Facebook* ka patur një rritje të vazhdueshme të audiencës, duke marrë rreth 760 pëlqime deri në fund të vitit.

Rritje në mënyrë progresive ka patur edhe leximi i postimeve të vendosura në *Facebook*, respektivisht në muajin tetor janë lexuar rreth 2621 postime. Gjatë nëntorit ka patur 9282 lexime të postimeve, ndërsa në muajin dhjetor ka patur 8817 postime.

Gjatë vitit 2017 tematikat më të shpeshta të pasqyruara në media lidhen me tregun e sigurimeve. Sigurimet motorike dhe sigurimi i pronës kanë qenë dy nga tematikat më të shpeshta të pasqyruara në media. Luhatjet e tarifave të sigurimit të detyrueshëm motorik, ecuria dhe mundësitë që ofron zbatimi i sistemit *Bonus-Malus*, mundësitë e mbulimit të pronës nga katastrofat natyrore kanë qenë disa nga temat që kanë zënë më tepër vend në media. Media pasqyroi në mënyrë më specifike edhe vendimmarrjen e Bordit të AMF-së për procedurat e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, objekt i Fondit të Kompensimit me rreth 30 raportime në median e shkruar dhe vizive vetëm në tremujorin e fundit të vitit 2017. Mediat i kushtuan vëmendje edhe çështjeve të sigurimit të pronës, referuar edhe zhvillimeve në rajon dhe rëndësisë që po merr mbrojtja e pasurisë nga katastrofat natyrore, si zjarri, përmbytjet.

Mediat i kushtuan interes pasqyrimin të komunikimeve publike të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Kryetarit të Bordit të Autoritetit.


Një tjetër çështje e pasqyruar në media lidhej me investimet në fondet e investimeve dhe tregtimin e letrave me vlerë. Licencimi i "Bursës Shqiptare e Titujve, ALSE" sh.a. gjeti një pasqyrim të gjerë në median e shkruar dhe vizive me 38 raportime si me artikuj në ditën e licencimit edhe me intervista të zgjeruara në revistat e specializuara ekonomike.

Autoriteti u përgjigj me prononcime publike edhe për format e reja të investimeve, platformat e tregtimit *online* si edhe investimet në monedhat virtuale. Nëpërmjet faqes së *online* dhe rrjetit social *Facebook*, AMF i këshilloi investitorët të jenë të kujdesshëm kur të vendosin të investojnë në platformat *online*, në monedhat virtuale duke njohur më parë risqet dhe duke patur një kulturë të nevojshme financiare për të marrë vendime të tilla investimi.

Në faqen *online* të AMF-së janë pasqyruar edhe zhvillimet e tregut të fondeve të pensioneve, megjithatë ky treg ka patur një mbulim mediatik më rastësor krahasuar me dy tregjet e tjera nën mbikëqyrjen e AMF-së, edhe sepse ky treg është ende mjaft i vogël krahasuar me dy tregjet e tjera. Mbulimet janë lidhur më së shumti me aktivitetin dhe publikimet që Autoriteti bën për këtë treg. Kështu, mediat sidomos ato të specializuara në çështjet ekonomike kanë pasqyruar publikimet tremujore të të dhënave për tregun e pensioneve.

Tendenca rritëse e pasqyrimin mediatik të veprimtarisë së AMF-së vihet re edhe në numrin e pasqyrimeve në shtypin e shkruar, televizione dhe mediat *online* si më poshtë:

Grafik 37: Pasqyrimi mediatik i aktiviteteve të AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje në vite




Edhe gjatë vitit 2017 tendenca rritëse e numrit të klikimeve në faqen *online* të AMF-së ka shkuar paralel me zhvillimet e tanishme të medias në vend, ku komunikimet dixhitale po zëvendësojnë gradualisht komunikimet me mediat tradicionale duke u shndërruar në formën prioritare të komunikimit.

Gjatë vitit 2017, në faqen *online* të AMF-së ka patur 416,068 klikime me shtim të numrit edhe të vizitorëve të rinj, ata që hynin për herë të parë në faqe, të cilët zinin rreth 75% të numrit total të vizitorëve. Duke ju referuar informacioneve të publikuara në faqen *online*, pjesa më e madhe e përdoruesve kërkojnë informacione lidhur me kuadrin ligjor, rregulloret, vendimet e miratuara nga AMF, si edhe direktivat e ndryshme. Mbi 44% e klikimeve në faqen *online* janë kryer për leximin e lajmeve e publikimet e ndryshme të bëra *online*. Një pjesë e rëndësishme

klikimeve, rreth 21% është e interesuar për publikimet e informacione statistikore për tregjet nën mbikëqyrje.

Grafik 38: Struktura e klikimeve në faqen online të AMF-së, 2017

(Në %)



Faqja është e organizuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht dhe në këtë mënyrë ajo i shërben edhe investitorëve apo analistëve të huaj si burim informacioni për strukturën dhe zhvillimin e tregjeve financiare të sigurimeve, pensioneve private dhe letrave me vlerë në Shqipëri. Faqja vizitohet edhe nga vizitorë jashtë vendit dhe pjesa më e madhe e tyre janë nga vende si Italia, Kosova, SHBA, dhe Anglia.

Në faqen zyrtare *online* jepen edhe publikimet mujore informuese për tregjet e mbikëqyrura, botime periodike vjetore, lajme dhe informacione kujdesi për investitorët dhe konsumatorët në tregjet financiare. Informacionet e pasqyruara i shërbejnë si shoqërive të sigurimit, fondeve të investimit dhe fondeve të pensionit, ashtu edhe për publikun si konsumator e investitor në këto tregje.

Botimet e AMF-së

- Raporti Vjetor
- Raporti i Mbikëqyrjes
- Gjeografia e Sigurimeve
- Buletini Zyrtar
- Fletëpalosjet për tre tregjet nën mbikëqyrje
- Libërthi Statistikor
- Manuali i Mbikëqyrjes me Bazë Rreziku të Fondeve të Pensioneve Vullnetare
- Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave

Publikime elektronike të AMF-së

- Periodiku mujor informativ
- Buletini Statistikor i tregut të sigurimeve
- Buletini Statistikor i tregut të letrave me vlerë
- Buletini Statistikor i tregut të pensioneve private vullnetare

III. SFIDAT E AUTORITETIT

Prioritete, Strategji të Autoritetit

Tregjet financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së, përkatësisht tregu i sigurimeve, i titujve dhe fondeve të investimeve, si dhe i fondeve të pensioneve private vullnetare, në vite kanë përjetuar zgjerim gradual të veprimtarisë së tyre, por mbeten relativisht të kufizuara në raport me tregun bankar dhe në krahasim me tregjet e rajonit, si dhe me kontribut modest në ndërmjetësimin financiar.

Viti 2014 mund të konsiderohet si viti i forcimit të pavarësisë së AMF-së, me ndryshimet ligjore, të cilat pothuajse e barazuan këtë autoritet me Bankën e Shqipërisë. Por, pavarësisht këtyre përpjekjeve, si dhe mbështetjes së konsiderueshme të BB-së dhe FMN-së, forcimi dhe efektiviteti i procesit mbikëqyrës dhe rregullator nuk paralelizoi dot zgjerimin që po merrnin tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së dhe nevojat e rritjes së transparencës për produktet e ofruara, duke mos u shndërruar në faktor nxitës për zgjerimin e mëtejshëm të këtyre tregjeve dhe forcimin e mbrojtjes së konsumatorit. Për rrjedhojë, edhe sot AMF vijon të përballet me mjaft sfida, një pjesë e të cilave mbeten të paadresuara prej disa vitesh.

Për rrjedhojë, viti 2018 është përcaktuar si viti i zhvillimit strategjik për AMF-në dhe njëherësh për tregjet. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendimin e Bordit nr. 84, datë 19.06.2017, ka ngritur Komitetin Këshillimor për hartimin e strategjisë 5-vjeçare të zhvillimit të tregjeve financiare nën mbikëqyrje. Bordi i Autoritetit miratoi *“Strategjinë 5-vjeçare për zhvillimin e AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje”*, e cila u hartua nëpërmjet një procesi të gjerë konsultimesh me aktorët e tregjeve dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Në funksion të kësaj Strategjie po hartohet Plani i Veprimit për 5 vitet e ardhshme. Edhe pse një pjesë e elementëve të theksuar në këtë strategji mund të kenë qenë në agjendën e autoritetit rregullator, edhe më parë, u vërejtën mungesa në zbatimin e tyre, si rrjedhojë e një vullneti të paqëndrueshëm për zbatim dhe tranzicionit problematik me të cilin institucioni u përball dy vitet e fundit. Për rrjedhojë, u bë e nevojshme hartimi i një strategjie të qartë, me theks të fortë në stabilizimin e tregjeve dhe rritjes së besueshmërisë së konsumatorit (në veçanti në tregun e sigurimeve), duke i ritheksuar këto elementë si parakusht për të projektuar më tej shtyllat e zhvillimit dhe promovimit të tregjeve financiare dhe mbrojtjes konsumatore.

Ky kuadër strategjik do të mbështetet nga një plan i detajuar zbatimi me objektiva vjetore, gjë që do ta bëjë atë lehtësisht të kuptueshëm për palët e interesit dhe aktorët e tregut, si dhe do të mundësonte monitorimin e kësaj strategjie dhe rishikim e saj sipas nevojave.

Vizioni në thelb udhëhiqet nga mbrojtja e konsumatorit, në drejtim të nxitjes së qëndrueshmërisë financiare dhe të zhvillimit të sigurt të tregjeve financiare nën mbikëqyrje.

Ky vizion i ri pesëvjeçar i përcaktuar në këtë dokument, kërkon mbështetje me kapacitetet e nevojshme njerëzore, mbështetje nga partnerët strategjikë, si dhe me buxhete të mjaftueshme.

Janë përcaktuar disa drejtime të rëndësishme për zhvillim për periudhën afatmesme (2018-2022). Nisur nga madhësia dhe niveli jo i njëjtë i zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje, kjo

strategji është konceptuar, duke marrë në konsideratë nivelin e zhvillimit, nevojat për mbështetje të ndara sipas tregjeve, dhe në veçanti problematikat akute që shfaq secili treg.

Kapërcimi i këtyre sfidave dikton përcaktimin e disa drejtimeve të rëndësishme për zhvillim për periudhën afatmesme (2018-2022), si dhe identifikimin e disa projekteve, me anë të të cilave synohet përmbushja e misionit të AMF-së, në drejtim të nxitjes së qëndrueshmërisë financiare dhe të zhvillimit të sigurt të tregjeve financiare nën mbikëqyrje.

Objektiva dhe Sfida të Ardhshme

Në tregun e sigurimeve, këto drejtime zhvillimi i përkasin: (i) nxitjes së besueshmërisë së konsumatorit, nëpërmjet stabilizimit të tregut; (ii) përmirësimit të cilësisë dhe efektivitetit të mbikëqyrjes dhe rregullimit; (iii) nxitjes së zhvillimit të tregut; si dhe (iv) nxitjes së stabilitetit afatgjatë.

AMF e konsideron cilësinë e shërbimeve të ofruara nga operatorët dhe transparencën ndaj publikut, si shtyllën kryesore nga ku do projektohet zhvillimi i tregut. Nxitja e një tregu sigurimesh të shëndetshëm financiarisht, që përmbush detyrimet kundrejt konsumatorëve, përbën objektivin kryesor të kësaj strategjie, duke u fokusuar në:

(i) forcimin e zbatueshmërisë së produkteve të sigurimeve të detyrueshme; (ii) koordinimin e veprimeve me Ministrinë e Financave me qëllim përmirësimin dhe stabilizimin e regjimit fiskal që zbatohet në industrinë e sigurimeve; (iii) nxitjen e një tregu sigurimesh konkurrent dhe eficient; si dhe (iv) krijimin e lehtësirave për zhvillimin e kanaleve të tjera të shpërndarjes dhe produkteve të reja.

Në tregun e letrave me vlerë, disa drejtime ku AMF do të fokusohet në mënyrë që të ndihmojë zhvillimin e qëndrueshëm të këtij tregu, janë:

eliminimi i kufizimeve që pengojnë zhvillimin e tregut; (ii) forcimi i funksionit të mbikëqyrjes; (iii) përshtatja dhe rregullorja e politikave të AMF-së në mënyrë që të lejohet krijimi i llojeve të tjera të fondeve; (iv) promovimi i tregjeve; (v) edukimi financiar; (vi) teknologjia.

Në tregun e pensioneve private vullnetare, AMF do të fokusohet në disa drejtime:

(i) optimizimi i kuadrit fiskal që rregullon fondet e pensioneve; (ii) rritja e ndërgjegjësimit mbi avantazhet e pensioneve suplementare private; (iii) komunikimi i vazhdueshëm me palët e interesuara; (iv) edukimi financiar.

Bazuar në rëndësinë që ka **qëndrueshmëria financiare** AMF, ka përcaktuar disa drejtime strategjike, në drejtim të (i) administrimit të krizave; (ii) ngritjes së kapaciteteve për mbikëqyrjen e grupeve financiare dhe zhvillimin e mbikëqyrjes së konsoliduar; si dhe (iii) ndërtimin e një mekanizmi për mbrojtjen e konsumatorëve ndaj falimenteve dhe daljeve nga tregu të operatorëve. **Gjatë vitit 2018** vëmendja do të përqendrohet në objektivat e mëposhtme:

Mbikëqyrja dhe monitorimi i tregjeve

Ky objektiv garanton zhvillimin e kuadrit ligjor dhe rregullator dhe zbatimin efikas dhe të duhur të këtij kuadri për të tre tregjet nën mbikëqyrje duke pasur synim ruajtjen e shëndetit financiar të tyre dhe duke garantuar qëndrueshmërinë në funksion të mbrojtjes së konsumatorit.

Mbrojtja e konsumatorit dhe investitorit

Mbrojtja e konsumatorit dhe investitorit është një ndër objektivat më të rëndësishme të AMF, objektivi mbi të cilin është vënë theksi edhe gjatë vitit 2017. Për këtë qëllim gjatë vitit 2017, me ndryshimet strukturore, u ngrit në nivel drejtorie njësi për mbrojtjen e konsumatorëve dhe u miratua Strategjia tre-vjeçare “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje 2017-2020”. Për të realizuar këtë objektivi gjatë vitit 2018 AMF do të vijojë me aktivitetet e planifikuara në zbatim të kësaj Strategjie me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe informacionit në funksion të mbrojtjes më të mirë të konsumatorit, por edhe zhvillimit të mëtejshëm të këtyre tregjeve.

Edukimi financiar

Në mbështetje të këtij objektivi për rritjen e edukimit financiar mbi tregjet financiare, në vitin 2018 janë parashikuar një sërë procedurash monitorimi për shoqëritë që veprojnë në tregjet nën mbikëqyrje në lidhje me sjelljen e tyre ndaj konsumatorit dhe disa aktiviteteve edukative në nivelet e ndryshme arsimore në vend dhe veçanërisht në universitetet publike dhe private për të prezantuar dhe bashkëpunuar me ta në kuadër të rritjes dhe forcimit të njohurive të tregjeve financiare jobankare. Në mbështetje të këtij objektivi AMF gjithashtu synon për 2018 përgatitjen e një sërë artikujsh e emisionesh informuese me qëllim nxitjen e publikut dhe institucioneve të tjera për pjesëmarrje në këto tregje dhe zhvillimin e aktivitetit të tyre në këto tregje.

Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator

Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator vijon të jetë një objektivi i rëndësishëm, me synim rritjen e shkallës së përafrimit me direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare, si dhe rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes. Në tregun e sigurimeve, AMF do vijojë punën për ndjekjen e procesit të miratimit të ligjit të ri për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, me synim adresimin e problematikave që kanë shoqëruar prej gati dy dekadash këtë treg si dhe përfundimin e procesit të hartimit të rregulloreve në zbatim të Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Për sa i takon tregut të pensioneve vullnetare, AMF do të ndjekë procesin e miratimit të ndryshimeve në ligjin për pensionet. Ndërsa në sektorin e titujve gjatë 2018 do të vazhdojë puna e përmirësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet hartimit të ligjeve të reja “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe “Për titujt” në kuadër të projektit SECO.

Administrimi i Fondit të Kompensimit

Ky objektivi mbetet një nga prioritetet kryesorë të veprimtarisë të AMF-së, pasi brenda vitit 2018 synohet të përfundojë procesi i pagesave të prapambetura që i përkasin periudhës 2001-31.12.2013, zbutjen e detyrimeve të prapambetura që i përkasin periudhës 1.1.2014-

31.12.2017, si dhe frenimi i fenomenit të akumulimit të moskryerjes së pagesave brenda afateve kohore të ngjarjes së ndodhur. Krahës ndjekjes së pagesave që do të kryhen në vazhdimësi nga Byroja Shqiptare e Sigurimeve do të monitorohet në vazhdimësi edhe zbatimi i vendimeve të Bordit për shlyerjen e detyrimeve të Fondit të Kompensimit. Deficiti i Fondit të Kompensimit, për dëmet e papaguara në vite, sipas rekomandimeve të FSAP, duhet të shlyhet brenda periudhës 2014-2016. Negocimi i afatit trevjeçar lidhet me situatën e vështirë financiare dhe të likuiditetit të tregut në vitin 2013, nisur nga zbatimi i tarifave nën kosto të sigurimit të detyrueshëm motorik. Edhe pse tarifat u stabilizuan një vit më pas, ky detyrim mbetet edhe sot në nivele të përafërta me ato të vitit 2013. Kujtojmë që në periudhën e monitorimit të zbatimit të kësaj mase stabilizimi, përkatësisht 2014-2016, ka pasur një keqinformim të Kuvendit dhe publikut në lidhje me masën e shlyerjes së këtij detyrimi, ndërkohë që kjo masë nuk u zbatua me efektivitet duke krijuar një ngërç, i cili vendos nën presion zhvillimin dhe shëndetin financiar të tregut.

Forcimi i kapaciteteve administrative të AMF-së

Ky objektivi ka qenë në fokus të punës së AMF edhe gjatë vitit 2017 dhe do vazhdojë të jetë i tillë dhe gjatë vitit 2018. Me qëllim plotësimin e strukturës dhe rekrutimin e një personeli sa më të kualifikuar do të punohet për thithjen dhe punësimin e specialistëve me eksperiencë në fushën financiare si dhe rritjen e mëtejshme të kapaciteteve të stafit ekzistues. Në funksion të këtij objektivi do të vazhdohet me zbatimin e fazës së tretë të projektit “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare” ku në bashkëpunim me ekspertët e SECO-s është hartuar një plan i detajuar trajnimesh që do të financohet nga projekti. Ky objektivi pritet të realizohet përmes (i) plotësimit të vendeve të lira sipas strukturës organizative të AMF-së në përputhje me zhvillimet e tregut dhe punësimin e burimeve njerëzore sa më cilësore; (ii) kualifikimi profesional i stafit të AMF-së, me qëllim rritjen e ekspertizës profesionale në punë; (iii) trajtimi i punonjësve të AMF-së, për të mbështetur rritjen e cilësisë së tyre.

Përmbushja e detyrimeve për zbatimin e projekteve të asistencës teknike

Edhe gjatë 2018 AMF do të vazhdojë ndjekjen, përmbushjen dhe realizimin e të gjitha projekteve dhe asistencave teknike në proces, me qëllim rritjen e standardeve dhe ekspertizës së AMF-së, përmirësimin në raportimin financiar në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe harmonizimin e kuadrit ligjor dhe institucional të vendit me direktivat e Bashkimit Evropian, menaxhimin e krizave, etj.


Modernizimi i infrastrukturës TIK

Ky objektivi lidhet me një nga fushat kryesore të përpunimit të informacionit në AMF dhe do të fokusohet në fuqizimin e rritjen e kapaciteteve përkatëse, zhvillimin e mëtejshëm të Qendrës së Informacionit, modernizimin e platformave dhe programeve aktuale drejt një zgjidhje inteligjente të integruar dhe të sigurtë, rritjen e sigurtë në rrjetet e informacionit dhe rritjen e nivelit të njohurive, aftësive dhe kapaciteteve për ekspertizë.

Rritja dhe forcimi i bashkëpunimit institucional me organizatat ndërkombëtare, autoritetet homologe si dhe institucionet brenda dhe jashtë vendit.

Ky objektiv synon forcimin e marrëdhënieve mes institucioneve brenda vendit dhe institucioneve homologe jashtë. Qëllimi është që të realizojmë marrëveshjen dypalëshe që të na shërbejnë për punën dhe për shkëmbimin e eksperiencave.

IV. Struktura Organizative e AMF-së



Departamenti i Çështjeve Juridike është përgjegjës për përputhshmërinë ligjore të veprimtarisë së Autoritetit, nëpërmjet hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore të nevojshme, dhënies së opinioneve juridike dhe mbështetjes ligjore për veprimtarinë e tregjeve nën mbikëqyrje, si dhe veprimtarinë e Autoritetit; kryen mbrojtjen ligjore të Autoritetit, përpara organeve gjyqësore dhe koordinon marrëdhënien e bashkëpunimit me institucionet ligj zbatues; siguron mbrojtjen e konsumatorit/investitorit, duke u kujdesur që veprimtaria e subjekteve nën mbikëqyrje të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe në mënyrë transparente e në mirëbesim siguron përmbushjen e proceseve integruese, përafrimin e legjislacionit vendas me atë të BE-së, si dhe përafrimin e parimeve dhe standardeve ndërkombëtare.

Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve është përgjegjës për mbikëqyrjen efektive të shoqërive të sigurimit/ risigurimit, Byrosë Shqiptare të Sigurimit dhe ndërmjetësve në sigurime, nëpërmjet mbikëqyrjes *off-site*, *on-site* dhe shërbimeve aktuariale; licencon dhe monitoron shoqëritë e sigurimit dhe subjektet e tjera që operojnë në tregun e sigurimeve në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve është përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut të titujve, fondeve të pensioneve vullnetare dhe të fondeve të investimeve si dhe realizon mbikëqyrjen e subjekteve të licencuara në këto tregje; licencon subjektet që ushtrojnë veprimtari në tregun e titujve, tregun e fondeve të investimit dhe të pensioneve, si dhe monitoron ushtrimin e veprimtarisë së tyre në përputhje me kuadrin ligjor;

Departamenti i Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve është përgjegjës për zhvillimin e metodologjive dhe strategjive në funksion të mbikëqyrjes, ndjek zbatimin dhe ecurinë e projekteve të Autoritetit, kryen analiza të ecurisë dhe tendencave në zhvillim të tregjeve nën mbikëqyrje; administron Qendrën e Informacionit të Sigurimeve të Detyrueshme, zhvillon platforma të reja raportimi si dhe harton dhe zbaton politika efektive të menaxhimit të burimeve financiare dhe njerëzore të Autoritetit në funksion të përmirësimit të veprimtarisë së tij.